

Kur vepra e njeriut, që konsiderohet si themeluesi i letërsisë moderne shqipe, gjendet në zemër të një operacioni të gjerë piraterie, vendi dridhet. Dhe botuesit e vendit, aq më shumë. Sepse pirateria e librave të Ismail Kadaresë po bëhet e patolerueshme.

SHTYPI FRANCEZ PËR RASTIN E KOMUNËS SË TETOVËS

<https://actualitte.com/article/124194/international/des-livres-pirates-avec-la-complicite-de-bibliotheques-crise-dans-les-balkans>

Libra të piratuar të Kadaresë me bashkëpunimin e bibliotekave: Kriza në Ballkan

Nga Clément Solym, cs@actualitte.com



Pas një vizite në qytetin e Vaçes, Vathit, Faslliut, Visarit

Për Lushnjën dhe krijuesit e saj

Nga Agim Vinca

(fq. 3)

Kam qenë në këtë qytet për herë të parë në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, si pedagog i ri i Universitetit të Prishtinës, bashkë me kolegë të tjerë, dhe vij këtu, në një moshë tjetër për mua dhe në një kontekst tjetër politik, shoqëror e kulturor për Lushnjën dhe për gjithë Shqipërinë.



Suksese Panairit të 25^{të} të Librit në Prishtinë 11-15 QERSHOR 2025

SHËNIME MBI LIBRAT

100-vjetori i lindjes (1925-1992)

Martin Camaj: “Unë jam i jueji e ju jeni të mijt...”

Nga Ymer Çiraku (fq. 6)

Absurdi i diktaturës në romanin

“Mossanga” të Fate Velajt

Nga Lindita Arapi (fq. 7)

Ylli Pango, kronikë e papërfunduar për familjen dhe dashurinë njerëzore

Nga Çerçiz Loloçi (fq. 10)

“Brirët”, satira që zbërthen realitetin shqiptar me një humor therës

Nga Tom Gjokhilaj (fq. 11)

Analizë e romanit “Lakimi” të Durim Taçit

Letërsi që i bën shërbim të madh opinionit

Nga Lekë Tasi (fq. 12)

Lindja prometeiane e fotografisë në fokusin e Bodlerit


Nga Xhyher Cani PhD (fq. 22)

Shkrimtari i shquar qipriot ditën e hënë në Tiranë

Dritaret e prozës së Jorgos Moleskis

përkthyer nga Petro Çerkezi

Nga Enver Kushi (fq. 4)



BIBLIOTEKË

Skënder Buçpapaj (fq. 14)

Hënisti dhe kitaristi

Langston Hughes (fq. 15)

Shpëtimi

Aristotel Spiro (fq. 15)

Rreth nesh festonin

Demë Topalli (fq. 16)

Një urdhër i lashtë

Lucille Clifton (fq. 18)

Brenda meje është një vajzë

Përktheu nga origjinali: Roland Gjoza

Arben Meksi (fq. 17)

Karikatura e së shtunës

“Toroboti” një roman për fëmijë që vështrohet në të ardhmen

Prof. Dr. Klara Kodra (fq. 9)

Djali që rriti dragonj – një aventurë mes imagjinatës dhe realitetit

Nga Anila Bisha (fq. 8)

MBRETI LIR, TOLSTOI DHE LOLOJA

Nga George Orwell (fq. 19)

Përktheu nga origjinali Granit Zela

Kur vepra e njeriut që konsiderohet si themeluesi i letërsisë moderne shqipe gjendet në zemër të një operacioni të gjerë piraterie, vendi dridhet. Dhe botuesit e vendit, aq më shumë. Sepse pirateria e librave të Ismail Kadaresë po bëhet e patolerueshme.

Libra të piratuar të Kadaresë me bashkëpunimin e bibliotekave: kriza në Ballkan

Nga Clément Solym, cs@actualitte.com

<https://actualitte.com/article/124194/international/des-livres-pirates-avec-la-complicite-de-bibliotheques-krise-dans-les-balkans>

Pirateria e librave, një plagë e vazhdueshme në Ballkan, sapo ka kaluar një vijë të kuqe të re: edhe veprat e Ismail Kadaresë, një shkrimtar emblematic i letërsisë shqipe (i cili vdiq në korrik 2024w), tani po falsifikohen masivisht. Alarmi u lëshua nga Shoqata e Botuesve të Shqipërisë, e cila denoncon *përvetësimin sistematik të paligjshëm* nga disa bashki dhe struktura publike, raporton Gazeta Express .

Në fakt, disa shtëpi botuese në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut (veçanërisht në Tetovë) riprodhojnë dhe shpërndajnë vepra të mbrojtura pa autorizim, shpesh në partneritet me autoritetet lokale.

Midis viktimave është botuesi i Kadaresë, Bujar Hudhri, i cili thekson një paradoks tronditës: “ Qyteti i Tetovës, i cili e nderoi Kadarenë duke e emëruar atë qytetar nderi, tani po promovon veprat e tij të piratuara, madje duke i shpërndarë ato në bibliotekat publike. « Ai shton: « Ata prodhuan libra të piratuar në marrëveshje me komunat dhe

i shpërndanë ato direkt në biblioteka. Vetë shteti, përmes kryetarëve të komunave, blen këto produkte të vjedhura. “

Pirateria strukturore dhe e zakonshme

Problemi shkon përtej falsifikimit artizanal. Sipas Petrit Ymerit, president i Shoqatës së Botuesve, kopjet e paligjshme shpesh sponsorizohen

nga institucionet publike, gjë që i shndërron aktet e piraterisë në politika zyrtare të shpërndarjes: “ Këto nuk janë thjesht falsifikime të lira, ato janë shkelje të qëllimshme të të drejtave të autorit, të përdorura për qëllime edukative, ndonjëherë të shitura me gjysmë çmimi për studentët .»

Praktika, sigurisht, shtrihet edhe në formatet dixhitale. Shumë libra shqip skanohen, shpërndahen në portale të paligjshme dhe më pas shiten elektronikisht, pa respekt për të drejtat e autorëve ose përkthyesve. “ Tregu i librave elektronikë në Shqipëri është një xhungël pa ligj “, vëren Ymeri.

Lexueshmëria është gjithashtu në rrezik

Botuesit theksojnë se kjo formë piraterie dëmton edhe publikun. Veprat e piratuara shpesh shfaqin cilësi të dobët editoriale: tekste të gabuara, përkthime të përafërta dhe mungesë të një paraqitjeje profesionale. “ Fenomeni nuk është i izoluar vetëm në Shqipëri. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, pirateria po ndikon në industrinë e librit në një shkallë shqetësuese. Sipas Deutsche Welle, fushatat kundër piraterisë janë nisur tashmë në Kosovë dhe Serbi, por sanksionet mbeten të rralla dhe legjislacioni zbatohet dobët.

Thirrje për një zgjim politik

Botuesit shqiptarë po i bëjnë thirrje qeverisë të mbajë një qëndrim të qartë kundër piraterisë, veçanërisht duke bërë dallimin midis mbështetjes publike për botimet ligjore dhe vetëkënaqësisë ndaj botimeve të piratuara. Ata gjithashtu po kërkojnë bashkëpunim rajonal për të luftuar këtë fenomen ndërkuftar.

Situata ngre pyetje themelore: çfarë të ardhmeje i pret botuesit e pavarur në një treg ku edhe institucionet marrin pjesë në falsifikim? Dhe si mund ta garantojmë transmetimin e një trashëgimie letrare si ajo e Kadaresë nëse veprat e tij bëhen kopje të degraduara dhe të paligjshme?



Ndërsa kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Kasami, e konsideroi ditën e sotme një ditë të veçantë për qytetin. “Ditë e veçantë për tetovarët, jemi të nderuar dhe krenarë që sot shpallim qytetar nderi shkrimtarin e madh, Ismail Kadare. Jemi me fat që jetojmë në kohën e Ismail Kadare”, u shpreh Kasami.

25 Nëntor 2022, 14:32

Është pikërisht po zoti Kasami, kryetari i komunës që me fondet e shtetit bleu mijëra libra të piratuar të Kadaresë dhe ua shpërndau me ceremoni pesë shkollave të mesme në Tetovë, javën e shkuar.

Kur më erdhi ftesa për të qenë pjesë e Jurisë për vlerësimin e punimeve të arritura në Konkursin letrar të krijuesve lushnjarë, pranova pa hezitim, sepse vinte nga Lushnja, nga ky qytet me traditë të pasur letrare, kulturore dhe historike.

Kam qenë në këtë qytet për herë të parë në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, si pedagog i ri i Universitetit të Prishtinës, bashkë me kolegë të tjerë, dhe vij këtu, në një moshë tjetër për mua dhe në një kontekst tjetër politik, shoqëror e kulturor për Lushnjën dhe për gjithë Shqipërinë.

Vij në qytetin e Kongresit Kombëtar të vitit 1920, ngjarje me rëndësi historike për shtetin dhe kombin shqiptar.

Kongresi i Lushnjës, i mbajtur njëqind e pesë vjet më parë, luajti rol vendimtar në konsolidimin e shtetit shqiptar pas katrahurës së Luftërave Ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore. Pavarësia e Shqipërisë u shpall më 1912, por rimëkëmbja e Shqipërisë si shtet filloi më 1920. Kongresi i Lushnjës, i mbajtur në zemër të Myzeqesë, mbrojti tërësinë territoriale të Shqipërisë së ’13-s, vendosi rendin në vend dhe caktoi Tiranën kryeqytet.

Vij këtu për respekt ndaj krijuesve lushnjarë, disa prej të cilëve kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë miq të mi.

Në këtë qytet lindi diva e muzikës shqiptare, e madhja Vaçe Zela. Me këngët e saj janë rritur breza të tërë artdashësish jo vetëm brenda kufijve politikë të Shqipërisë, por edhe në viset shqiptare të mbetura padrejtësisht jashtë “shtetit amë”, Shqipërisë londineze. E pata vizituar në vitin 2005 në Bazel të Zvicrës, ku i kaloi vitet e fundit të jetës. Ia dhurova librin tim me poezi “Kohë e keqe për lirikën” dhe një tufë lule. Kërkoj t’ia lexoja përkushtimin. Kur ia lexova u prek, më përqafoi dhe qau. Ndenjëm një kohë të gjatë në tarracën me lule, për të cilën kujdesej vetë Vaça, sepse pasioni për këngën i kishte kaluar te pasioni për lulet... Unë isha me mikun tim Naim Kryeziu, përkthyes i njohur, që më shoqëronte, ndërsa Vaça me bashkëshortin e saj, Pjetër Rodiqin (një burrë zotni, shkodran) dhe të bijën, Irmën, e cila na shërbente me kafe e pije freskuese.

Me t’u kthyer në Prishtinë, shkova në Ministrinë e Kulturës dhe kërkova që t’i bënin një ftesë Vaçe Zelës, e cila kishte qenë vetëm një herë në Kosovë, në vitin 1980, me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve. Ua dhashë adresën e krejt çka duhej tjetër dhe prita gjashtë muaj, në mos më shumë, por Ministria e Kulturës nuk bëri asgjë. Në shenjë revolte bëra një shkrim, në të cilin kritikojja jeniçerllëkun e zyrtarëve të MKRSCJ-së, si quhej atëherë Ministira e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente e Kosovës, me në krye ministrin me vath në vesh. Shkrimi me titull “Një ftesë për Vaçen” u botua në shtypin e Prishtinës dhe të Tiranës. (Tani, pas kaq vitesh, puna e parë që bëra pas arritjes në Lushnjë, ishte “vizita” te monumenti i Vaçes në qendër të qytetit, ku ish-studenti im, Fitimi, tani “doktor në letërsi”, më bëri disa fotografi).

Nga Lushnja është edhe primadona e teatrit dhe filmit shqiptar, aktorja Margarita Xhepa, e cila kohë më parë u nda nga jeta. Aktive gjatë gjithë jetës dhe e pranishme në tërë hapësirën shqiptare, Margarita ishte vizitore e shpeshtë në viset shqiptare në Maqedoni dhe sidomos në Strugë, ku qe nderuar me titullin “qytetare nderi” nga kryetari i komunës.

Lushnja ka dhënë shkrimtarë të shquar, si poeti Faslli Haliti dhe prozatori Vath Koreshi. Faslliu, që nga libri i tij i parë, “Sot” (1969), i vlerësuar qysh në dalje nga Kadareja, mbante qëndrim kritik ndaj dukurive negative në shoqëri. Ende kujtohet ajo vjersha e tij e hershme mbi njeriun që pret të fryjë era që t’i shihet koburja. (Edhe në fshatin tim kishte njerëz të tillë, komunistë primitivë e fodullë, që të

Pas një vizite në qytetin e Vaçes, Vathit, Faslliut, Visarit...

Për Lushnjën dhe krijuesit e saj

Nga Agim Vinca

Poezia që fitoi çmimin e parë në konkursin letrar të Shoqatës së Shkrimtarëve të Lushnjës

Edlira Gorreja

mes tokës dhe qiellit

Midis tokës dhe qiellit lindem unë dhe e vërteta ime e shkruar në hieroglifë piramidash dhe lapidare me ëndrra prej balte dhe me plot gabime ... në një vallëzim planetësh pa nisje dhe pa ndalje, një pikë uji në univers pa fund, por me ego të madhe.

Midis tokës dhe qiellit frymoj unë dhe një mijë dilema duke ngritur avione ... duke marrë trena në një fushëbetejë me ardhje dhe me ikje shtegtar i viseve të ngrohta ... krahë ... trup dhe gjoks i mbushur plot me pritje...

Midis tokës dhe qiellit kotitem unë duke ndarë kufij, duke valvitur flamuj ... duke ngritur një urë me harqe dhe me drita, me dashuri të mrrolura, me inate të kripura... ... në një lojë luftërash i zhbërë nga një pikëpyetje i prerë gjer në kërthizë... fitues dhe në humbje.

Midis tokës dhe qiellit nënshkruaj po unë një paqe të nëmur, diktuar me forcë dhe me dhunë... me fije të padukshme, lidhur fatin me ngjyrën e lëkurës i ikur prej vetes, i mbytur prej zhurmës, në një rrotullim pas rrotullimi, ngecur rreth njëri-tjetrit në bark të sheshtë ngjizur jetën në tokë dorëzoi të vdekurit.

Midis tokës dhe qiellit endem unë me ëndrra, shpresë dhe dëshira shumë, duke prishur një pakt të bërë me veten duke u grindur me Zotin që fshehur më mban të vërtetën në një endje të gjatë pa fund dhe pa fillim me mollën e Adamit në fyt ... me gurin e Sizifit mbi shpinë.

jashtë skemave të kohës. Kjo bëri që ai të binte në burg. “Më kishin arrestuar për një libër që, besoj, ishte më se modest”, rrëfen poeti dhe shton se poezia qe prostituta që e tradhtoi, por edhe Virgjëresha që e shpëtoi (parafrazim i lirë). Kur u arrestua (u dënua me dhjetë vjet burg, prej të cilave i mbajti shtatë) ishte mësues në Kukës. Pas daljes nga burgu (1986), punoi si punëtor fizik në fabrikën e tullave në Lushnjë. (Miku i tij, Bujar Xhaferri, thotë se ai ishte i vetmi që rrinte me Visarin në atë kohë). I biri i aktorit Hekuran Zhiti, i cili gjatë Luftës Antifashiste shkroi një poemë për pajtimin kombëtar (Përqaftimi i dy kundërshtarëve), Visari si njeri dhe shkrimtar nuk dha kurrë mesazhe revanshi e urrejtjeje, por dashurie dhe paqeje. Jam i lumtur që ndër të parët kam shkruar për poezinë e Visarit, qysh në vitet 1993-94, kur dolën në dritë dy librat e tij të parë: “Kujtesa e ajrit” dhe “Hedh një kafkë te këmbët tuaja”, prej të cilëve i dyti është një libër i jashtëzakonshëm, si për nga përmbajtja, ashtu edhe në planin artistik dhe gjuhësor. Autor edhe i shumë veprave në prozë, veçanërisht nga ato të zhanrit “burgologji”, Visar Zhiti është një nga visaret e letërsisë shqipe.

Brezit të Visarit i takojnë edhe Bujar Xhaferri dhe Fatbardh Rustemi (alias Amursi), që të dy poetë, por edhe prozatorë e publicistë të talentuar e me kulturë. Fatbardhi, autor edhe i një libri për Kadarenë, tani jeton në Amerikë, kurse Bujari, si shumica e shkrimtarëve të gjallë shqiptarë, në Tiranë.

Por është një krijues që vazhdon të jetojë e krijojë në Lushnjë, një poet i veçantë, të cilin unë e dua dhe e pëlqej për lirizmin, konkretësinë dhe humorin e tij brilant. Ky është Sherif Bali, autori i përmbledhjeve “Koncert sipas

(vijon në faqen 5)

Poeti dhe studiuesi Agim Vinca pranë monumentit të artistes Vaçe Zela, në qendër të Lushnjës



SHIU I TIRANËS

Rrallë më ka ndodhur, që kur lexoj Rnjë shkrimtar të panjohur, të më shoqërojnë gjatë këtij leximi emocione të veçanta. Doja të përdorja fjalët “zbulim, zbuloj”, që në gjuhën shqipe, mes shumë kuptimeve, ka edhe kuptimin si zbulim i një thesari të fshehur nën tokë. Ky zbulim i shkrimtarit Jorgos Moleskis, është i Petro Çerkezit, i cili në intervistën ose bisedën e tij me shkrimtarin dhe botuesin Jani Malo, botuar një vit më parë në “Exlibris”, mes të tjerash flet për letërsinë e Qipros, si letërsi e dhimbjes, e trishtimit, e lëndimit dhe e mallit, si në poezi, edhe në prozë dhe ka profilin e saj, pavarësisht se shkruhet në gjuhën greke. Këtu ai përmend emra, si Mihalis Pjeris, Emilio Solomu, Kristos Haxhipapas, Jorgos Moleskis, Haxhipain, poetin turko-qipriot, Mehmet Jasin. Pastaj shton se ka në proces përkthimi romanin e Kosta Limpurit dhe tregimet e Jorgos Moleskis. Emrat e sipërpërmendur i shënova në një nga blloqet e shënimeve dhe bleva dy prej tyre: “Metamorfozë qytetesh”, të Mihalis Pieris dhe “Engjëj hakmarrës”, të Mehmet Jasin. U mrekullova kur i lexova dhe prisja të lexoja diçka në prozë nga krijuesit ishullorë të Qipros. Dhe prapë u mrekullova me prozën e shkurtër të Jorgos Moleskis, leximi i të cilit më shoqëroi me emocione të veçanta. Më vjen keq që këtë prozator të mrekullueshëm e njoha kaq vonë, në pasditen e jetës sime.

Mbaj mend, mund të ketë qenë mesviti 2001, kur takova rastësisht në Tiranë, pas Pallatit të Kulturës, shkrimtarin dhe regjisorin Gjergj Vlashi, një nga fisnikët e Durrësit, këtij qyteti hijerëndë, siç do ta quante Ciceroni. Ai nxori nga çanta një libër të vogël, me rreth 112 faqe, që titullohej “Tregim për ishullin e panjohur”. Lexova emrin e autorit, që ishte José Saramago. E kam përkthyer nga portugalishtja, tha Gjergji. Kaq tha dhe u ndamë për t’u mos u takuar më. Kur i lexova tregimet, u trondita nga proza e tij, por edhe u trishtova që po e njihja kaq vonë, falë zbulimit dhe përkthimit në shqip të Gjergj Vlashit. Atëherë sapo i kisha kaluar vitet e mesditës së jetës time dhe në Shqipëri po botoheshin shumë nga kryeveprat e letërsisë botërore.

Nuk e di se ku kam lexuar një thënie të një njeriu të mençur të globit tonë, ku ai shkruan se të lexosh një shkrimtar të mirë, është si të zbulosh një yll. Ky i mençur nuk thotë se ke zbuluar diçka në tokë, por në qiell, pra e lidh krijimtarinë me hapësirat qiellore. Ai ka të drejtë, sepse shkrimtarët kanë diçka si prej magmë meteorike, jo të atyre që shkërmoqen para se të bien në tokë.

Po sjell edhe një fakt tjetër, lidhur me librin “Kur dielli hyri në dhomë” të Moleskis: atë e lexova gjatë ditëve ose pasditeve me shi të Tiranës. Kështu ishte muaji që lamë pas, ose moji, siç thotë Thanasi Dino. Maji ishte i lagësht, me shira të qetë dhe të butë, jo inatçorë, siç ndodh në vjeshtë. Mendoj se leximi i këtij libri, shoqëruar me shira, nuk është rastësi. Jo se në këto tregime bie vazhdimisht shi, si te Heminguei ose Kadareja ynë. Dhe në një nga këto pasdite, kur i kisha lexuar tregimet, dola nga shtëpia. Në Tiranë binte shi, teksa kalova në rrugën e Kavajës, pastaj mes lulishtes “Rinia”, te rruga e Elbasanit dhe te Fakulteti i Filologjisë, mora rrugën djathtas, atje ku ngjitesh dhe diku më lart, është godina e Fakultetit të Gjeologjisë. Vazhdoja të binte shi i qetë dhe nanuritës. Ecja në një rrugë, ku qiparisat e gjatë dhe të hollë, bashkojnë majat e tyre. Ishte pragmuzgu dhe duke ecur mes këtyre qiparisave, që më dukeshin si dervishë ose më saktë si murgjër të përkorë, qëndrova. Nga majat e qiparisave, që tundeshin lehtë dhe binin pikat e shiut, m’u bë se dëgjova zëra. Mendova mos ishin cicërimat e fundit të zogjve të ditës ose të atyre të natës... Ishin ca zëra të tjerë, si zëra shpirttrash. Vinin nga libri i Jorgos. Dhe mes këtyre zërave, më i qarti, por edhe më i dhimbshmi ishte ai i Sergeit. Pashë orën. Ishte shtatë. Rastësi? Jo, mendova. Edhe tregimi “Miku im Sergei”, më i gjati i librit, nis kështu “kur i telefonova për herë të parë, nga dhoma e hotelit, ishte rreth orës shtatë

Dritaret e prozës së Jorgos Moleskis


Nga Enver Kushi

të mbrëmjes”. Nga majat e qiparisave, si përmes shiut, më vinte zëri i Sergeit: “Kush është? Kush është? Kush është?”.

Ju lutem mos më pyesni se si është shiu, mjegullat, erërat, borërat, dielli në prozën e Jorgos Moleskis, sepse do shkruaj më pas për to.

Mos më pyesni për shiun te Homeri. As për shiun e Eskilit, Sofokliut, Euripidit. Mos më pyesni për shiun në poezitë e Seferis, të shkruara prej tij, kur ishte konsull i Greqisë në Korçë, në kohët e mbretërisë. As për shiun e Elitis, kur ngjitej bokërrimave dhe maleve të frikshëm të Tepelenës, gjatë luftës italo-greke dhe tek shihte nëntogërin

grek, që jepte shpirt nga plagët, shkruante vargun “Ashtu si shkundet lisi nëpër shi”. Mos më pyesni as për shiun e Kazanzaqit... As atë që bie në baladat e bukura greke. Jemi këtu për të folur për prozën e shkurtër të Jorgos Moleskis, të bukura dhe origjinale, ku personazhet e tij lëvizin jo vetëm në Qipro, por edhe në hapësira të tjera gjeografike, shoqëruar me ankthe, vdekje, lindje fëmijësh, drama. Këtu do keni edhe diej, qiej me re dhe shira, muzgje, mjegulla, netë të pagjuma, ëndrra, ndarje në stacione trenash, largime dhe kthime pranë familjes në muzgje jete.



TË LINDËSH, JETOSH DHE KRIJOSH NË ISHULL

Në jetëshkrimin e shkurtër, që i paraprin librit “Kur dielli hyri në dhomë”, mësojmë se Moleskis lindi në vitin 1946 në fshatin Lysi të Qipros. Studioi në kolegjin anglez të Nikosisë, kryeqytet të Republikës së Qipros dhe në Universitetin Lomonosov të Moskës, ku u diplomua për gjuhë dhe letërsi ruse. Në Qipro punoi në shërbimet kulturore të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës dhe Fondacionin e Orkestrës së Qipros. Ka qenë kryetar i komisionit për çmimet Shtetërore të Letërsisë, i Komitetit Kombëtar të Qipros për çmimin Evropian të Letërsisë dhe Unionit të Shkrimtarëve të Qipros. Pra autori i këtij libri, por edhe i librave të tjerë, është ishullor. Ç’do të thotë për një shkrimtar apo krijues tjetër të lindësh, madhohesh dhe të shkruash, pikturosh, kompozosh muzikë? Për këtë duhet pyetur Jorgos Moleskis, por nëse e lexojmë me vëmendje prozën e tij, pavarësisht hapësirave të tjera gjeografike dhe kohore, ku zhvendosen ngjarjet e disa prej tregimeve, ti ndjen dhe prek një realitet tjetër ose më saktë një shpirt tjetër: atë të ishullorit. Seferis, në një nga esetë e tij shkruan për Greqinë Kontinentale dhe atë Ishullore, se në një periudhë të caktuar historike “niveli kulturor i Ishujve Jonianë ishte asokohe, shumë më i lartë se ai i Greqisë Kontinentale”. Ai përmend një ishull tjetër, Kretën, hidhërimet mbi fatin e kësaj toke greke, njerëzit e të cilit do të farkëtojnë përherë një përtëritje, që ka për t’u shpërndarë nga suferinat e historisë.

Dhe nga ky ishull mistik dhe mitik kemi Kazanzaqis apo ishullorë të tjerë, si Andreas Kalvos, Dionis Sollomos, poeti i parë i madh i Greqisë moderne. Dhe mbi të gjithë kretanin e famshëm, Odiseas Elitis.

Qipro, shkruan Petro Çerkezi, është një vend i vogël, që lufton të mbijetojë. Një ishull që gjendet në udhëkryq mes lindjes dhe perëndimit, pranë Lindjes së Mesme, atje ku sot zhvillohet teatri më i ashpër i luftës, ku fryjnë erëra të rrezikshme interesash. Ai e krahason Qipron me “një gjethë të gjelbër”, e puthur nga deti më i kaltër në botë, me bukuri të rralla, por e pushtuar, e ndarë më dysh dhe me drama të mëdha politike-shoqërore. Në vitin 1974, kur isha i ri, mbaj mend kronikat që jepeshin në të vetmin kanal televiziv shqiptar, për zbarkimin e ushtrisë turke atje, pamjet e dhimbshme të luftës, të vrarët nga radhët e popullsisë civile, të moshuar, gra e fëmijë, që qanin, arritjen e marrëveshjes dhe vendosjen e telave me gjemba, që e ndanin ishullin në dy pjesë.

Vitin e shkruar u mbushën 50 vite nga kjo ndarje, pre e nacionalizmit ekstrem dhe e lojërave të Fuqive të Mëdha. Ata që kanë lindur në vitin 1974, janë prindër 50 vjeçarë, kanë fëmijë dhe në psikologjinë e tyre e të pasardhësve, janë traumat, rrëfimet e ndarjes, gërmadhat e fshatrave dhe shtëpive gërmadha të braktitura. Kjo është traumatike dhe ka lënë gjurmën e saj në letërsi, prozë e poezi, shoqëruar me dhimbje, plagë, trishtim.

Në kuptimin metaforik, çdo shkrimtar ka ishullin e vet. Ose më saktë veprat e tij janë ishuj shpirtërorë. Mund të jesh poet i tokës, steresë, mund të jesh prozator i lindur jo në ishull, por ajo që krijon është ishulli yt shpirtëror. E megjithatë ishullorët kanë më shumë diell, më shumë kaltërsi dhe

Ftesë

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme në promovimin e librit
"Kur dielli hyri në dhomë" të autorit qipriot
JORGOS MOLESKIS

Me praninë e autorit
JORGOS MOLESKIS
dhe të përkthyesit
PETRO ÇERKEZI

JORGOS MOLESKIS
Kur dielli
hyri në dhomë
Tregime

Përkthyer:
PETRO ÇERKEZI

"18 tregime,
një mozaik ngjarjesh reale dhe fiction,
ku njerëzit e thjeshtë marrin
një rëndësi universale
dhe që janë vrage
në ndërgjegje."

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE

Neraida

E HËNË, 09 QERSHOR 2025, ORA 11.00
Salla Franceze, Qendra "Sotir Kolea", Rruga George W. Bush,
(Pranë Urës së Tabakëve), Tiranë

atyre të Qipros, u shtohen fate njerëzore, ankthe, ëndrra, makthe, që lidhen me ekzistencën e tyre, jetën e përditshme dhe marrëdhëniet njerëzore. Lexoni me vëmendje këto tregime dhe herë direkt, herë indirekt do t'i ndjeni dhe prekni ato që nënvizova më lart. Jo vetëm kaq, Qipro, pavarësisht se është shtet i pavarur dhe që prej 20 vitesh, pjesë e Unionit Evropian, i ndjen ankthet e së shkuarës dhe telat me gjemba të ndarjes.

Kulturalisht dhe shpirtërisht, atje gjallon kultura e madhe greke, vinë dhe ikin drita dhe hijet homerike, mitologjia greke apo ndoshta, ardhur nga Kreta ca vargje që Seferis i citon si vegime. Ndoshta në rininë e tij Jorgos Moleskis, i ka dëgjuar të vinë me erërat e Egjeut:

Unë për hatrin tënd kisha vënë tri roje.
Kisha diellin në male dhe shkabën nëpër fusha,
Dhe murrninin e freskët e kisha në anije.
Por dielli perëndoi, shkabën e zuri gjumi,
dhe murrninin e freskët e morën anijet.
Dhe gjeti kohë, kështu, vdekja e mori.

PROZA E VEÇANTË E MOLESKIS

Mes tri fjalëve: stil, origjinalitet dhe veçanti, zgjodha këtë të fundit. Në gjuhën shqipe fjala stil ka kuptimin si tërësi e veçorive themelore artistike, i mjeteve dhe mënyrave të shprehjes, që bie në sy të krijimtaria e një shkrimtari a artisti, ndërsa origjinal, ka kuptimin që shkruan a krijon në një mënyrë të vetën. Fjala i veçantë, në shumës, veçantitë ka kuptimin që nuk është si të tjerët ose të qenët ndryshe. Këtu po shmang fjalën stil, ose atë që përdoret rëndom, se stili është vetë njeriu.

Po. Proza e Jorgos Moleskis është e veçantë në veçantitë e veta. Janë disa faktorë, që e bëjnë të veçantë prozën e tij. Më sipër u ndala se çdo të thotë të lindësh dhe të krijosh në ishull, siç është Qipro, që duket sikur miliona vite më parë, u shkëput nga stereja, duke u zhvendosur larg, shumë larg tokës amë, mes detit Egje dhe qiellit. Ai fsheh në thellësi mistere dhe enigma. Ai ka gjuhën e tij të komunikimit me token nga është shkëputur, si dhe me detin, atin e tij të dytë, dhe qiellin. Ata që kanë shkruar poezi për Qipron, Qipron e të gjitha kohërave, janë përpjekur të sjellin ose më saktë, të deshifrojnë këtë gjuhë komunikimi. Të tjerë sjellin atë që është e padukshme ose që fshihet dhe njeriu i zakonshëm nuk e sheh. Sepse krijuesit, ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, kanë edhe një shqisë tjetër: syrin e tretë. Nëse do t'i lexoni me vëmendje tregimin “Kur dielli hyri në dhomë”, do vini re një nënshtresë tjetër, që herë duket e qartë dhe herë si e megjullt, por kur shfaqet mes rreshtave, të befason me të vërtetat. Kjo është një nga veçantitë e këtyre tregimeve. Ka të drejtë Petro Çerkezi, që në parathënien e këtij libri shkruan se shkrimi i Moleskit është i thjeshtë dhe plot simbolikë ose Leonidhas Galazis se ato “ndezin imagjinatën dhe rrëmbejnë lexuesit”, duke shtuar se “autori e siguron interesin e tyre në mënyra të tjera, si lirshmëria narrative, shprehja e përkorë, disponimi rrëfimtari, si dhe lëkundjet e vazhdueshme midis pamjes dhe qënies, fjalës dhe mitit, ëndrrës dhe realitetit”.

Tregimi është nga zhanret më të vështira të prozës. Akoma më i vështirë është tregimi i shkurtër. Ai është nazik dhe delikat, si një adoleshent. I qelqtë si një vajzë, kur kalon nga fëmijëria në adoleshencë. Ai është zevzek gjithashtu, siç janë mëzat që nuk durojnë asnjë mizë mbi trupin e tyre të njomë. Lum ai prozator që di ta vërë atë nën komandën e tij. Mendoj se Moleskis, me thjeshtësinë e tij të rrëfimit, sensin e masës dhe përdorimin e fjalës dhe fjalisë edhe si rrëfim, edhe si emocion, edhe me të papritura befasuese në fund, zotëron atë që Markesi e quan kod letrar, mjete stilistike të mjaftueshme, që rrëfimi të jetë i besueshëm. Dhe Markesi shton: “Vështirësia ime kryesore ishte të gjeja tonalitetin dhe stilin e duhur, që lexuesi t'i besonte rrëfimit tim”.

Ne si lexues i besojmë rrëfimet e Moleskis. Ato janë të thjeshta në dukje. Duket sikur i ke përjetuar edhe ti si lexues. Dhe këtu më vinë ndërmend fjalët e Hemingueit, një nga mjeshtrit e mëdhenj të prozës: “Gjëja më e vështirë në botë është të shkruash një prozë të sinqertë e të ndershme për qeniet njerëzore. Së pari, të duhet t'i njohësh ata për të cilët do shkruash; pastaj të duhet të dish se si të shkruash. Për të dyja këto të duhet një jetë e tërë që t'i mësosh”.

Proza e shkurtër e Moleskis i ka të gjitha këto, për të cilat shkruan Heminguej.

Ai me thjeshtësinë e rrëfimit, natyrshmërinë e dialogut, gjetjet, detajet, personazhet nga më të ndryshmit e që vinë nga shtresa të ndryshme shoqërore, përshkrimet e natyrës si pjesë e natyrshme e rrëfimeve, hapësirat gjeografike të tyre, mbylljet befasuese etj., e ka vënë veten në radhën e prozatorëve të mëdhenj jo vetëm të Qipros, Greqisë apo Ballkanit, por edhe në rrafshin evropian. Këtu është zëri dhe vetëm zëri i tij, që siç do të thoshte Borhesi: “Gjëja më e rëndësishme e një shkrimtari është toni i tij, ndërsa gjëja më e rëndësishme e një libri është zëri i shkrimtarit, ky zë që mbërrin deri te ne”.

Ky zë është ai i gruas nëntëdhjetë vjeçare, që kur nga thellësitë e një miniere të braktisur, nxjerrin kufomën e një djaloshi, ajo thirri: “Ai është i fejuari im. Humbi gjashtëdhjetë e pesë vjet më parë, në prag të dasmës sonë”. Është edhe zëri i një zonje tjetër të moshuar, që kur sheh një djalë në kulmin e moshës e të rinisë, dëshiron që vetëm për një moment, të bëhej edhe nëna, edhe grua, edhe dashuria e tij. Më pas, në një hotel, ndërtuar rreth tre

shekuj më parë, rikthehet ajo kohë, mbushur me aroma epokash të tjera. Dhe nëse do rrugëtojmë në rrëfimet e Moleskis, do të dëgjojmë, kur dielli hyn në dhomën e një burgu grash, klithmat e dhimbjes së një të burgosure të re dhe të bukur, që tenton të bëjë vetëvrasje. Dhe për të vazhduar me tregimin “Bie shi... Por unë dua të vdes”, “Kafe-librari “Llamba”, “Miku im, Sergei”, më i gjati tregim, por edhe më i dhimbshmi, ku shpaloset drama e krijuesit në diktaturat komuniste, etj., etj., apo zërin e babait te trgimi “Ullinj të tim eti”, që duket sikur njih dhe flet me ullinj të, një gjuhën e tyre, apo zbërthen edhe kumtet e ëndrrave të ullinjve.

Do të zgjatesha, nëse do të zbërtheja kohën në këto tregime të shkurtër, jo kohën në kuptimin e motit. Rrëfimet të gjitha janë në vetën e parë. E veçantë e këtyre tregimeve, është mënyra sesi ai e sjell të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Në tregimin e parë, “Kur koha ndaloj”, lexuesi kur lexon pas frazës së parë, frazën: “Zhvillohej një konferencë ministrore për kulturën dhe secili ministër kishte shoqëruesit e vet. Unë, si punonjës i ministrisë shoqëroja timin”, ti pret çdo të ndodhë më pas. Koha vazhdon rrjedhën e vet, por befas ndodh e papritura. Koha e ngrirë për gjashtëdhjetë e pesë vite, rikthehet në të sotmen: në galeritë e një miniere të braktisur, ose të mbyllur përfundimisht, gjendet kufoma e një djaloshi. Fillojnë hamendjet, thashethemet. Dhe në këtë atmosferë çudie, që pushton qytetin dhe banorët e tij kalojnë para kësaj kufome, si të ishte e një shenjtori, vjen zëri i kohës së sotme, që të shkuarën prej aq vitesh, e rikthen vetëm me një frazë, në të sotmen. Edhe në tregimin tjetër, “Në një hotel të vjetër”, në një nga dhomat e tij, rikthehet historia treqind vjeçare, personazhet e ndodhitë në “të. Mjafton një frazë si kjo: “U ndërtua rreth tre shekuj më parë dhe për gati treqind vjet njihej në të gjithë vendin dhe në ato fqinje, madje si një bordello autetentike, e vizituar nga tregëtarë dhe sundimtarë, madje dhe nga poetë”, për të rikthyer tre shekuj.

Të tetëmbëdhjetë tregimet e këtij libri janë një dritare në botë, shkruan Petro Çerkezi, që duhet falënderuar për punën e madhe që bën, duke sjellë në gjuhën shqipe, poezinë dhe prozën e shkrimtarëve ishullorë të Qipros, duke ndërtuar një urë komunikimi mes Qipros dhe Shqipërisë. Duhet falënderuar edhe shkrimtari dhe botuesi Jani Malo, për botimin cilësor të këtij libri.

Jorgos Moleskis me librin “Kur dielli hyn në dhomë” hap një nga një tetëmbëdhjetë dritare, nga ku shpaloset jeta jo vetëm në Qipro, por edhe përtej hapësirave gjeografike të këtij ishulli. Këtu hapësirat gjeografike dhe ato shpirtërore rrugëtojnë bashkë dhe janë të pandara. Në botën e sotme të zhvillimit galopant të teknologjisë, rreken të na thonë, se në një të ardhme jo të largët, inteligjenca artificiale, do zëvendësojë trurin njerëzor, se edhe prozën, poezinë, dramën, filmin, pikturën, këngën, do të na e bëjë ky tru jo human. Etërit e mëdhenj të letërsisë dhe kulturës botërore, që nga Homerit dhe gjithë vdekatarët e mëdhenj, do ngrihen nga varret, për t'i thënë ndal kësaj marrëzie globale. Inteligjenca artificiale le të veprojë në fusha të tjera të jetës. Letërsia, arti dhe kultura janë shpirt, një shpirt sublim, përtej sublimes njerëzore. Këtë shpirt do ta gjeni edhe në këtë libër të Jorgo Moleskis. Ai, si shumë krijues të Qipros, është shpirti i këtij ishulli, i lidhur ngushtë me shpirtin helen. Në vitin 2004 Jorgos Moleskis shkruan:

Dita që iku, koha që shkoi,
Njerëzit që ikën, jeta ime...
jeta ime u bë mit.

Nuk kanë nevojë për komente këto vargje kuptimplote, që flasin shumë. Dhe kur fjalët dalin nga shpirti, ato janë të shenjta siç është e shenjtë toka, ku ke lindur.

Kretani i madh, Nikos Kazanzaqis, diku flet për “vargmalet e shpirtit tim”. Në letër El Grekos, ai shkruan: “Mes duarve shtrëngoj lehtësisht me dhimbshuri, një copë tokë kretane. Gjithmonë e kam mbajtur me vete këtë, gjatë shtegtimeve, në brengat e mëdha, e shtrëngoja mes duarve e duart merrnin forcë, një forcë e madhe, sikur mbaja midis pëllëmbëve dorën e një miku të dashur”.

Edhe Jorgos Moleskit, jeta e të cilit u bë mit, falë edhe nga një cope toke qipriote, që kudo e ka mbajtur dhe e mban me vete, i jep dhe vazhdon t'i japë forcë dhe energji shpirtërore.

Tiranë-Nikosia, maj 2025

(vijon nga faqja 3)

kërkesave të dëgjuesve”, “Hënë, përkthema këtë libër në qiell”, “Autoportreti im në pjepër” etj., që sjell në poezinë shqipe përmbajtje dhe motive autentike, myzeqare, por edhe kombëtare e universale. (Ia kam lexuar librat që më kanë rënë në dorë dhe e kam takuar në Prishtinë vite më parë Sherif Balin, kurse ai erdhi të më takonte posa mori vesh se jam në Lushnjë). Është një autor që meriton më shumë vëmendje dhe një zë që e vlen të dëgjohet në “koncertin” shumë herë kakofonik të kohës sonë.

Në drekë ra fjala te Kapllani Resuli, i cili ka jetuar një kohë në Lushnjë, ku ka punuar si mësues. (Bujarit i ka dhënë mësim në klasë të gjashtë, si thotë, dhe ka dobësi për të). U flas për degradimin e tij moral e intelektual pas daljes nga burgu dhe pas azilit në Zvicër. Autori i romanit “Tradhtia”, të vetmes vepër që vlen diçka, nëse ai është vërtet autor i saj, e mohoi përkatësinë e vet kombëtare (“Jam malazias i besimit mysliman”), mohoi origjinën ilire të shqiptarëve, mbështeti regjimin e Millosheviqit në kulmin e terrorit serb në Kosovë, duke thënë se shqiptarët e Kosovës “i kanë të gjitha të drejtat”, por “nuk duan t'i shfrytëzojnë”; shkroi një paçavure kundër Kadaresë, ku thoshte se “vepra e tij ishte më e rëndësishme se vepra e Kadaresë”; mohoi gjuhën letrare shqipe me mëtimin qesharak se ai duhej të ishte krijues i shqipes letrare etj. etj. Në ndarje nga ekipi i TV Beogradit, që shkoi ta intervistonte në vitin 1995, në stacionin e trenit në Gjenevë shqiptoi në serbisht fjalët: “Ma përqaftoni Beogradin!”, duke hapur krahët pash më pash. E ndërroi emrin, në fillim nga Resuli në Resulbegoviq, pastaj në Buroviq dhe doli me “tezën” se origjina e tij rridhte nga Njegoshi! “Ka vuajtur shumë”, thotë ish-nxënësi i tij. “Kanë vuajtur edhe të tjerë, por kjo nuk mund të jetë arsye për veprime si këto”, them unë. Bujari prapë përmend vuajtjet dhe burgun. Fatbardhi, ndryshe nga ai, evokon një ngjarje që tregon fytyrën e vërtetë të Kapllan Resulit. Kur u diskutua libri me poezi i Fasli Halitit në vitin 1969, thotë Bardhi, Kapllani e mori fjalën, u ngrit në këmbë, e ngriti librin lart dhe tha: “Ky është një libër reaksionar!”. Pas kësaj pasoi masa e “riedukimit” shumëvjeçar të Fasliut.

Nga një ese e shkurtër e Amursit me titull “Zemërimi është ndjenjë, inati patologji”, po shkëpus një paragraf. “Kur njerëzit e edukuar kanë kurajo pa patur drejtësi, ata bëhen rebelë. Kur njerëzit e vegjël kanë kurajo pa patur drejtësi, ata bëhen banditë (Konfuçi). Rebelë dhe banditë të armatosur me inat, që ‘kanë kurajo pa patur drejtësi’ i sheh të bëjnë eksperimentin apo të ushtrojnë dhunë psikologjike gjithandej, pavarësisht se një derr me zile duket mjeran para dashit me këmborë”.

Në konkursin anonim letrar “Ngjyra në fjalë” me çmim të parë u nderua poezia “Mes tokës dhe qiellit”. Është një poezi e organizuar mirë, me një mesazh universal, ku subjekti lirik artikulon dilemat e veta ekzistenciale në formë paradoksale. Autore e saj është një vajzë e re, njëzet e sa vjeçare, e cila e prezanton me dinjitet brezin e ri të krijuesve lushnjarë.

Tradita vazhdon.

(Lushnjë, 24 maj 2025)



Të tetëmbëdhjetë tregimet e këtij libri janë një dritare në botë, shkruan **PETRO ÇERKEZI**, që duhet falënderuar për punën e madhe që bën, duke sjellë në gjuhën shqipe, poezinë dhe prozën e shkrimtarëve ishullorë të Qipros, duke ndërtuar një urë komunikimi mes të dy vendeve tona.

Te libri “Kohë barbare”, që përmbledh dhjetë biseda të realizuara përmes një intervistimi të Ismail Kadaresë me një gazetar të huaj, diku, ai shpreh pikëpamjen se një shkrimtar me veprën e tij, është më tepër se një parti, ai është një Atdhe më vete. Dikur më herët, në një nga studimet e tij, Ernest Koliqi, po në këtë trajektore vlerësimi, theksonte se kemi të bëjmë me një rast, kur mund të pohojmë pa mëdyshje se Shqipërinë e bëri letërsia. Pra, e bënë Buzuku, Bogdani, Variboba, De Rada, Naimi, Fishta, Konica, Lasgushi dhe të tjerë Etër e Misionarë të këtij formacioni shpirtëror. Që do të thotë se ishte para së gjithash Shqipëria e ëndërrt në veprën e tyre, ajo që do të kthehej përmes një kalvari të gjatë përpjekjesh – në Shqipërinë reale.

Këtu mund të kujtojmë Martin Camajn, shkrimtarin e shquar, që edhe pse në rrethana të vështira të ekzilit politik dhe të përjashtimit nga komunikimi letrar, ai asnjëherë nuk e humbi besimin dhe betejën se dikur do t'i takonte patjetër të “vetët”, të cilëve, edhe iu përkushtua me veprën e tij letrare, sepse siç do të theksonte në fjalët testamentare: “...unë jam i jueji e ju jeni të mijt...”

Receptimi i veprës së Camajt, për arsyt tashmë të njohura, është i vonshëm – krahasuar me kohën e shkrimit të saj. Për disa dekada vitesh, ajo mbeti një vepër e ndaluar dhe ishte e ndaluar jo për shkaqe letrare. Njohja e lexuesit me të, u realizua kryesisht pas viteve '90-të. Dhe ishte një njohje, që vinte me “goditje”, sidomos poezia e tij, e cila, shfaqej si një ligjërim i munguar, por tashmë edhe si vlerë e shtuar për letërsinë shqipe. Pra, vjen si një teksturë poetike moderne, me shkallë të lartë abstraksioni, ku lexuesi implikohet (i bëhet ftesë) që të jetë njëherazi edhe interpretues i brendshëm/aktiv i saj e për pasojë, ai merr kështu autoritetin e një lloji “bashkëkrijuesi” të atyre teksteve poetike. Sigurisht, këto janë cilësi të poezisë me estetikë mirëfilli moderniste.

Kësaj duhet t'i shtojmë edhe përcaktimin e bërë nga vet Camaj për këtë model krijimtarie, si poezi jo e “mikrofonit”, pra, jo e angazhimeve imediate, por e vetmjaftueshme brenda funksionit të kanoneve të pastra estetike.

Pa praninë e ndikimit të “pushtetit” autorial (kujtojmë se Camaj ndahet nga jeta më 1992), vepra e këtij shkrimtari arrin pa vonesë që ta gjejë veten denjësisht në kornizat reale të historisë së letërsisë shqipe. Madje vet një nga të shquarit e kësaj letërsie, Ismail Kadare, e konsideron atë tashmë të përfshirë në rrethin e ngushtë të poetëve të shquar, që hyri nga porta e madhe në panteonin e letërsisë shqipe. I.K. shkruan se: “Në ngrehinën e përkorë të letrave shqipe, atje ku është duke zënë vendin e vet Martin Camaj, ashtu si në çdo panteon, hyhet vetëm prej një porte, asaj të madhes. E ajo portë, siç e tregon emri, nuk njeh veçse arsyet e mëdha. Siç është thënë dikur, De Rada i paharrueshëm, në një përshkrim të natës së pashkëve, ka rrëfyer për engjëjt që e bëjnë veç gostinë e tyre. Në tryezën e epërme, ku kanë zënë vend krenajat e letërsisë, nuk ngjiten zhurmat e vogla e as afrohen profilet e rëndomta. Atje ka përherë mirëkuptim e harmoni, ndaj e kremtja vazhdon përherë dhe ndriçimi i shandanëve nuk sos”.

Shkrimet e shumta kritike, studimet monografike e tezatat doktorale mbi këtë krijimtarie, referimet në konferenca shkencore, e kanë kapërcyer atë kohë pezull, kur ky autor ishte i përjashtuar nga komunikimi me lexuesit e vet.

Kujtojmë se bibliografia e shkrimeve mbi veprën e tij, arrin në mbi 100 zëra, ku hyjnë shkrime e analiza kritike, studime monografike, të formatit këto akademik apo shkollor. Ai tashmë është nga autorët kryesorë të programeve e teksteve mësimore, qofshin të nivelit parauniversitar, apo universitar. Vrehet se janë jo të pakët studentët, që e kanë M. Camajn ndër autorët e preferuar për ta bërë objekt temash të studimeve të tyre diplomike.

Pra, brenda afër 3-4 dekada vitesh, nga autor i ndaluar, apo i panjohur, Camaj bëhet gradualisht ndër personalitetet më të spikatur të letërsisë shqipe. Kjo sigurisht, që dëshmon cilësitë e një arti konsistent në vlerat e veta

Kujtojmë disa shkrime të Ernest Koliqit, i

100-vjetori i lindjes (1925-1992)

Martin Camaj: “Unë jam i jueji e ju jeni të mijt...”

Nga Ymer Çiraku

cili, e vlerëson aq lart, kur shprehet se Camaj do të mbetet nga ata krijues, që e nisi parabolën e vet krijuese atje ku të tjerët “dëshirojnë me e sosë”. Vlerëson kulturën e pasur librare, të fituar me punë të madhe dhe njëkohësisht, të kombinuar e të harmonizuar me kulturën mitologjiko-primitive të vendlindjes. Dhe këtu, gjen rastin të sjellë në vëmendje metaforën e kontrastit harmonik mes malit e fushës, ku malet hedhin hijen, por edhe hiret e tyre identitare mbi fushë...

Sipas Arshi Pipës, vepra “Dranja”, për nga poetika e universalitetit që mbart, mund të krahasohet me “Këngë të Milosaos”. Në trajektoren e ecjes/rrugëtimit të personazhit të kësaj poeme, identifikohet mbartja e qenësisë identitare. Por këtu kryqëzohen

në sens polifonik - edhe mjaft kumte domethëniesh të tjera. Gjarpri mbi zhguall të breshkës, projekton harmoninë mes qiellit e tokës, por edhe shenjën e erosit universal, që garanton pjellorinë dhe vazhdimësinë e jetës. Vet modeli i personazhit breshkë, një kafshë e ndërmjetme dhe atavike (nga aspekti zoologjik), është domethënie e tërë atyre të pakryerave dot në rrugën e fateve historike të etnosit.

Camaj është poeti që prirret nga pasqyrimi më shumë “pankronik” (tërëkohësh) se sa historik dhe kësaj i vjen për shtat edhe prirja e dukshme universale e kësaj poezie (Antonio Guxeta). Sigurisht, ai lexues që është mësuar me poezinë rrafsh, të drejtpërdrejtë, nuk mund që ta shijojë aq lehtë këtë poezi. Poeti

është si një i Urtë, që flet me enigma. Poezitë e tij ngjajnë si rebuse imazhesh dhe kur arrin të ambientohesh me to dhe t'i shijosh, atëherë kupton se nuk mund të ndahesh dot lehtë prej tyre (Ardian Klosi).

Përmes pranisë së dëndur të parabolave, poeti përcjell te lexuesi gjendje mjaft shprehëse. P.sh. në një poezi (“Mospërfillje”), qëllimshëm mjegullohen sekuencat kohore e logjike formale, për të dëshmuar moskryerjen dot të misionit, si dhe “mundimin sizifian” të njeriut, i projektuar/konceptuar si dështim prej destinit fatal.

Mbas mjesnate hana derdhi rrezet
prej majes së shkambit deri në lumë.
Mbasi që u ngi me gjumë
këndon qokthi ndër rreze;
sytë, dy pika uji, ndrisin dhe kanga
pikon në luginë, në terr.

Dikush buzë lumit n' agim gjeti
sqepin e thyem të qokthit e tha:
dam! Kyqre këtë tingull që ra
e plasi në gur.

Pra, poeti i largohet kohës reale sociale, madje edhe homo sapiensit, duke e transferuar përsiatjen në botën e shpendëve (Sqepi i qokthit plasi në gur e vajti dëm ai tingull) dhe prej këtej, gjen rastin për të rrëfyer katastrofën me përmasa kozmike – kur rrëzohen edhe krijesat e lartësive. Pra, kur bëhen ployë elitat, nëpër ato muzgje do të thotë sociale, ku “edhe dëbora nuk zbardh...” Këtë larghedhje parabolike, e ndjek edhe te poezia tjetër, kur kujtohen ato ngjarje katastrofike, që vijnë prej dhunës së tiranive:

Libri i besimit të shpendve thotë:
çdo zog shtrin krahët e vdes mbi bar,
ndëshkim pse preku kufijtë e ndaluem
mes qiellit e dheut.

Nji zog lëngon për vdekje mbi bar
gjethet ndër lisa janë zogj e shokë
të pambërrishëm
e losin me dritë e diell

larg dy gurë mullinjsh që bien
si mbas ligjit njeni mbi tjetrin
pa za.

(“Nji zog lëngon”)

Camaj e ka evidente në poezinë e tij një “ala aristokratizëm” të brendshëm njerëzor e le ta themi konceptual, që duket se buron prej asaj fisnikërie shqiptare, blatur natyrshëm qysh kryherit - jo aq prej sigurisë së pasurive materiale - se sa prej pasurisë së vrytuteve të trashëguara e pothuaj të shenjtëruara prej atyre njerëzve. Pra, është njeriu i paqtë me veten, që nuk synon të përçojë kurrfarë urrejtje përmes artit të tij, megjithëse kishte mjaft llogari të hapura me sistemin e kohës. E konfirmon këtë qëndrim arti apolitik qysh herët, në fillimet e krijimtarisë së tij letrare. Madje edhe të shpallur haptazi në parathënieën e veprës “Diella” (botuar në Itali më 1958). Këtu parashtron në trajtë kredoje e premtimi të prerë dhe sigurisht të mbajtur prej tij, se:

CAMAJ

VEPRA



Onufri

“nga palca e urrejtjes dua të dal, sikur bima nga fara e saj në pranverë...”

Vepra letrare e M. Camajt, qoftë proza, drama, por sidomos poezia, nuk mund të klasifikohen dot lehtëazi nga pikëpamja zhanrore. Dhe kjo vlerësohet si cilësi e veprave të shquara e novatore, të cilat, i kapërcejnë mes tyre (sigurisht me tendencë estetike) kornizat e zhanreve, duke i funksionalizuar ato në atë mënyrë, me qëllimin për t’i tretur mes tyre e për t’i fuqizuar me epërsitë e seicilit zhanër. Prandaj po prej A. Pipës, një vepër mjaft e njohur si “Dranja”, është përcaktuar për nga poetika zhanrore: “prozë e mbarsur me poezi”.

Ish studenti dhe dishepulli i tij, Hans J. Lankch, e ka përcaktuar profilin e Camajt si shtegtari mes gjinive, si udhëtari mes dy botëve: mes letërsisë e shkencës së letërsisë, mes poezisë e prozës. Por me gjithë “kërcimin” mes gjinive, ai gjykon se Camaj mbetet në fund të fundit poet i lindur.

Duke qenë një poet me identitetin e vet të spikatur, ai ka ndërkaq edhe të ngjajshmit e vet, sidomos për sa i përket punës aq të kujdesur/ të ngulët me gjuhën, të kumbimit të melodive të brendshme ritimike, të lojës me valencat e dendura abstraktive. Këta të ngjajshëm të tij, besojmë se janë sidomos: Jeronim De Rada, Ndre Mjeda e Lasgush Poradeci.

Klasifikimet në fushë të letërsisë, sigurisht që janë konvencionale, si shenja marrëveshjeje mes studiuesish. Por përcaktimi i Camajt si “shkrimtari i diasporës”, sikundër artikulohet ndonjëherë nëpër media, pajtohem i me mendimin e hedhur se nuk është i gjeturi. Ai mbetet shkrimtari që tashmë ka mbërritur në qendër të letërsisë shqipe. Ekzili politik, endja nëpër Evropë larg atdheut, larg lexuesit, është një rrethanë e njohur e jetës së tij, por ai pati aftësinë që në mënyrë substanciale, me tërë aktivitetin që realizoi, ta kapërcejë këtë rrethanë - aspak të zgjedhur, por të imponuar prej rrethanash jashtëletrare.

Sigurisht, e arriti këtë falë talentit të tij të madh, falë punës së madhe. Ndonëse e përjetuar virtualisht, por Camaj arrinte që të ndihej shpirtërisht në vendin e vet, sado larg e i ndarë të ishte prej tij - duke i funksionalizuar tërë shenjat e atij vendi, e sidomos raportet/ marrëdhëniet me gjuhën amtare, të cilën, e studioi dhe e sublimoi si ai. “Jam zhytë në gjuhë si prifti n’ zanat të vet”, i shkruante dikur një mikut të vet në Amerikë dhe përmes këtij imazhi, merret me mend gjithë ai përkushtim prej oshënari të përbetuar - mbi të shenjtat e fisit të vet. Prandaj edhe letërsia e tij, ka aq shumë gjuhë, aq shumë stilizime e “ojna” stilistike me pasuritë e kësaj gjuhe.

Duhet mbajtur parasysh se M. Camaj, zuri vend dhe pikërisht zuri vendin e tij në letërsinë shqipe, që i ishte mohuar prej afër gjysëm shekulli. Pra, ai nuk zuri kursesi vendin e dikujt tjetër, veçse vendin e tij të merituar. Ndonjë autor tjetër, i cili u sfumua apo u harrua prej lexuesit dhe prej historisë së letërsisë shqipe në kohët e sotme, kjo ndodhi jo prej faktit se në qarkun letrar shqiptar hynë autorë të tjerë si Camaj e ndonjë tjetër. Ai u “ndëshkua” veçse estetikisht, pikërisht prej veprës së tij – që nuk arriti të komunikojë dot më me lexuesin e pritshëm, të atij lexuesi tashmë të pamanipuluar dhe të paorientuar ideologjikisht në shijet e tij për lexim.

Vepra letrare e Camajt, ku siç e vumë në dukje kreun e vendit e zë poezia, shfaqet polifonike: në zhanret, në stilet dhe në modelet ligjërimore që aplikoi. Ai shkroi e botoi disa libra me poezi, poema, romane, novela, drama. Pjesë e veprës së tij janë edhe kontributet e vyera në gjuhësi, filologji, kritikë letrare, kulturologji. Prej mjaft vitesh, drejtoi katedrën e Mynihut për gjuhën shqipe, ku përgatiteshin specialistë, që më pas do të rrezatonin dije albanologjike. Me “Mesharin” e Gjon Buzukut, mbrojti me sukses tezën për doktoraturë në “La Sapienca” të Romës. Mori pjesë aktivisht në shumë konferenca shkencore ndërkombëtare, ku dha kontribut të pakursyer në fushë të albanologjisë. Paraqitej atje me dinjitet shkencor, si një zë i shtuar, pa ia penguar dot punën mëria, që mund t’i krijohej nga pezmi i mënjanimet prej vendit të vet.

Bashkëpunimi në revistën “Shëjzat”,

mbetet sigurisht një nga kontributet mjaft të rëndësishme të këtij personaliteti. Këtu ai pati rastin që të bashkëpunojë me mikun dhe mentorin e tij, Ernest Koliqin. Kjo është një revistë emërmadhe, e cila, mund të krahasohet për nga misioni që luajti me “Albania”-n e Konicës. Ajo nisi të botohej qysh më 1957, në 18 vjetarë vijues dhe u projektua si një rezistencë kulturore, në rrethanat e njohura të sistemit politik në Shqipëri. Pra, tek ajo revistë, gjeti vend tërë gjeografia e letërsisë dhe kulturës shqiptare, pa muret ndarës ideologjike.

Camaj pati rastin që të botojë këtu mjaft nga krijimet e veta kryesisht në poezi, por edhe një varg shkrimesh filologjike dhe kritikë letrare. Mund të thuhet se ky personalitet nuk rreshti së punuari, i endur mes krijimtarisë, filologjisë dhe kritikës letrare. Ndonëse vet krijues, në kritikën e tij letrare nuk imponohej me shijet e veta në gjykimet për të tjerët.. Ishte një vrojtues i vëmendshëm i letërsisë të botuar në Shqipëri, në Kosovë dhe në diasporë. Në disa shkrime mbi poezinë dhe prozën e pasluftës, vë në dukje jo pak vlere në to, por vë theksin edhe te tonet zbukuruese të saj, kur vren se në disa vepra mungon vështirimi filozofik, mungojnë hije-drita e jetës, që i sheh të ardhura prej politizimit të saj, i cili, krijon për pasojë një efekt gërryes e asfiksues mbi të, në rrafshin estetik e stilistik.

Letërsinë e kësaj kohe e përcakton nga pikëpamja terminologjike si “letërsi të pasluftës”, një emërtim ky, që do të gjente stabilizim disa dekada më vonë. Ky emërtim i hedhur prej tij në shkrime e studime për letërsinë shqipe, mbetej një përcaktim i drejtë, pasi e ashtuqajtura “letërsia e realizmit socialist”, sikundër emërtohej gjithë procesi letrar i pas vitit 1945, nuk mund që t’i kishte dot kursesi potencialet, apo ca më tepër të kishte aftësitë dhe të drejtat për ta konceptuar e gjykuar të homogjenizuar tërë procesin letrar shqiptar - brenda kanoneve të njohura estetike të socrealizmit Sepse në këtë pikëvështrim të politizuar, veç të tjerash, nuk konsiderohet dhe mbetej si e tëhuajtësuar prej sistemit letrar shqiptar krijimtaria letrare në Kosovë, ajo arbëreshe dhe e diasporës, të cilat, dihet se nuk realizoheshin përmes kanoneve të soc-realizmit.

M. Camaj tregoi gjithashtu vëmendje të posaçme ndaj autorëve arbëreshë, duke i vlerësuar veprat e tyre për pasurinë estetike që sillnin në letërsinë shqipe. Është me interes të kujtohet se qysh në numrat e parë të revistës “Shëjzat”, përkthen e boton një cikël me poezi të G. Ungaretti-t. Kjo dëshmon simpati për këtë poet hermetist italian, që besojmë se në një mënyrë ose tjetër, sigurisht vetiake/origjinale, (siç është theksuar ndonjëherë dhe nga kritika letrare), këtë prirje ndofta do ta reflektojë edhe në poetikën e krijimtarisë së vet.

Në vargun e veprës së tij, Camaj ka një përmbledhje poetike të titulluar “Njeriu më vete e me tjerë” (1978), libër i botuar në Gjermani, shoqëruar me një kopertinë nga piktori i njohur Gjelosh Gjokaj, tek e cila, përthyeret në mënyrë mjaft të qëlluar tharmi mitologjiko-modernist i kësaj poezie. Në një prerje metaforike, te ky titull, mund të nënkuptohet individualiteti, origjinaliteti, “unikumi” letrar - përballë “të vetëve” e përballë “të tjerëve”. Ose edhe më tej, mund të perceptohet edhe ai i vetmuari (njeriu më vete...), pra i veçuari, prej arsyes, që s’ kishin të bënin kurrfare me letërsinë. Por pas `90-ës, u bë kapërcimi dhe atëhere ai (poeti), gjendet “mes të vetëve”. Gjithsesi, duhet thënë se gjendet mes atyre jo aq të shumtë të kësaj letërsie. Pra, gjendet natyrshëm e me meritë të plotë mes më të shquarve. Për të qendruar njëherazi dinjitoz, përballë “të tjerëve”, poetë të njohur të gjuhëve të tjera.

Këtë situatë tjetër (të re), si drita që vjen në fund të atij tuneli të kalvareve aq të rënda, pra të moskomunikimeve, keqkuptimeve e përjashtimeve, e shpjegojnë më së miri vet fjalët testamentare dhe aq prekëse të Poetit drejtuar bashkëatdhetarëve, të artikuluar vetëm pak ditë para shuarjes së tij (7 mars 1992): “Të dashun miq e vllazën Shqiptarë... Gëzohem pa masë se keni vendosë të vlerësoni veprën time: ky vlerësim na afron. Batë burrninë të më shtini në rreshtin tuej. Ndonëse të ndamë për gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijt. Martin Camaj”.



Me befasoi pozitivisht romani i ri i Fate Velaj “Mossanga”, një hop i ri, krejt ndryshe nga romani “Kreuztanne” që e kisha lexuar vite më parë. Është historia e trishtë dhe prekëse e fëmijëve nga Kongo që u sollën në Vlorë në vitet 60-të. Me kronologjinë e jetës së fëmijëve kongoleze në Vlorë, Fate Velaj njëkohësisht shkruan edhe një kronologji të diktaturës.

Kapitulli i diktaturës mund të quhet prej disave i mbyllur, por diktatura ende është brenda nesh, gjurmët që ka lënë regjimi më i egër stalinist në Europë në shoqërinë shqiptare nuk janë shuar. Letërsisë nuk i vë kush detyra, ajo ia vë vetë vetes duke dashur, siç thotë shkrimtari irlandez, Paul Lynch të krijojë “pasqyra të së vërtetës”, ose të zhbijojë e “të sjellë në gjuhë thellësitë e errëta” brenda nesh, siç thotë shkrimtari gjerman, Daniel Kehlmann. Letërsia shqipe duhet të vazhdojë të depërtojë me romane të tillë si “Mossanga” deri në skutat më të errëta të diktaturës, të reflektojë për këtë të kaluar që nuk është ende e shkuar, e kështu të na ndihmojë të kuptojmë veten, shoqërinë pse është sot ashtu siç është.

Kurba e rrëfimit në “Mossanga” vjen gjithnjë në ngjitje. Ajo shenjohej me duartrokitje, si u pritën fillimisht fëmijët kongolezë në Vlorë, megjithëse fillimisht lajmi ishte sekret. “Sado që porosia kishte qenë “heshtje e plotë”, lajmi i ardhjes së kongolezëve në qytet u hap me një shpejtësi të pamatë.” Strehimi i kongolezëve të vegjël të ardhur nga lufta i shërbeu autoriteteve të qytetit si mjet i fuqishëm propagande për të theksuar jo vetëm fuqinë po edhe sa miresi kishte shteti komunist që u hapi derën e u dha strehë këtyre fëmijëve të rrezikuar të shokëve të idealit. Po entuziazmi bie shpejt. Kongolezët vuajnë të njëjtin fat si edhe miqtë mikpritës shqiptarë në Vlorë. Ata vihen në survejim, dëshirat e dlira fëmijërore ndezin dyshime absurde tek autoritetet që aktivizohen dhe nisin përgjimet. Kurba e ngjarjeve shënon një kulm të saj sa tragjik po edhe absurd tek përgjimet që shoqërojnë kongolezët.

Komikja e paranoja e të zellshmëve të regjimit përplasen me mprehtësinë e autenticitetin e kongolezëve. Fate Velaj e sjell këtë absurd kafkaesk pa tone të bujshme stilistike, po me një gjuhë të thjeshtë e direkte për lexuesin pa shkrehje metaforike dhimbjeje. E veçanta e Velajt është se godet me të thjeshtën, rrëfimin pa poza letrare. Por pas së thjeshtës fshihen shumë orë pune në vetmi të atij që shkruan.

Romani nxjerr në pah edhe një element që rrallë i kushtohet vëmendje në letrat shqipe. Racizmin që kemi ndoshta thellë, që nuk e pranojmë, që rri i fshehur diku, e herë shfaqet brutalisht me fyerje ndaj atyre që janë ndryshe, po më shpesh është i maskuar nën petkun e mirësisë. Kongolezët përballen me këtë racizëm megjithë dashamirësinë e mikpritjen në përditshmëri. Edhe nën petkun e solidaritetit komunist të autoriteteve fshihet racizmi.

Ndihma që u ofrohet e ka një kusht: fëmijët kongolezë duhet të bëhen një ditë komunistë të bindur në shërbim të diktaturës. Autoritetet e diktaturës në Vlorë e harrojnë shpejt “dhembshurinë” ndaj fëmijëve kongolezë, kur vërejnë se ata nuk vihen kaq shpejt në rresht si shumica e nxënësve e studentëve të tjerë, më vonë kur kongolezët jetojnë në Tiranë. E kur ata fillojnë me talentin e miqësitë me djemtë e vajzat shqiptare t’i sfidojnë autoritetet duke kënduar publikisht këngët e ndaluara në Vlorë shpata e diktaturës është njësoj e mprehtë edhe për ta. Ka një episod sa të bukur edhe të trishtë në romanin “Mossanga”. Kur djem e vajza, të rinj shqiptarë e kongolezë mblidhen te Plazhi i Kingave të Vlorës dhe Joseph Mossanga këndon italisht. Autoritetet që kishin kohë që i ndiqnin ndërhyjnë duke i marrë për flokësh dhe i çojnë drejt burgut të Vlorës. „Nuk ju pëlqeu „Një bahçe me portokalle“ që nisët të këndonit në italisht?“ iu drejtohet pak para arrestimit të rinjve një burrë trupmadh, që kishte detyrën e survejimit të grupit.

Episode të tilla ku absurdi i diktaturës përziehet edhe me komiken gjenden shpesh në roman. Megjithatë kur i lexon sot episode të tilla buzëqeshja të ngrin në buzë po të rikujtohet se në çfarë çmendine jetoi një popull i gjithë në diktaturë. Velaj di ta përshkojë me letërsinë e tij këtë çmendinë të rrezikshme, ku i çmenduri nuk ishte Tol francezi, që këndonte nëpër rrugët e Vlorës e jetonte në bunker. E megjithë atmosferën e rëndë të një regjimi të errët që krijon “Mossanga”, xixëllojnë herë pas here momente shprese, një strategji për të tejkaluar përdishmërinë mbytëse në izolim. Njerëzit dashuronin, donin e dinin edhe të gëzonin, të dilnin në xhiro. Të mbijetonin! Dhe kongolezi Mossanga “vlonjati” që këndonte me kitarë këngët e dashurisë”, “shqiptari që recitonte plot ndjenjë vjershat e Naimit” me këngët e talentin e tij ndoshta i bëri të buzëqeshnin pak më shumë vlonjatët.





“Ndonjëherë magjinë e ke përpara dhe se sheh, ka edhe raste kur duhet ta kërkoh, por herë-herë duhet ta duash që ta shohësh”.

Imagjinata e shkrimtares Andy Shepherd sjell serinë e mrekullueshme të dragonjve të ilustruar nga piktorja Sara Ogylvie. Seria është klasike bashkëkohore, e përkthyer në 24 gjuhë.

Kjo seri është e duhura për të gjithë fëmijët që pëlqejnë aventurat! Moshë e sugjeruar 7 deri në 12 vjeç.

Shumë fëmijë ëndërrojnë ta shohin nga afër një dragua. Kuptohet ata që nuk tremben nga flaka e tij e zjarrtë, apo ata që stërviten se si të jetojnë me një dragua, si personazhi ynë, Tomasi. Më së shumti dragonjtë i hasim në rrëfenja mitologjike, si personazhe të egër apo mizorë, apo nga njohuritë që fëmijët marrin përmes enciklopedive, përmes historisë, apo biologjisë, apo edhe si lodër. Por mes tyre ka edhe shumë shkrimtarë që dragonjtë i kanë bërë pjesë të historive magjike për fëmijë. Një prej tyre është shkrimtarja angleze Andy Shepherd, e cila përmes imagjinatës së saj i ka sjellë dragonjtë si krijesa besnike, guximtare dhe shumë zbatitës, në një seri me gjashtë libra, të sjellë në shqip nga përkthyesi Artan Miraka.

Tomasi, personazhi që e duan shumë lexuesit

Historia nis me Tomasin, që ndihmon gjyshin e tij, të cilin e do shumë, për të punuar kopshtin pranë shtëpisë ku banojnë. Por ndërsa punonte Tomas ndjente vështirësi të rrënjët e një peme, që gjyshi e quante pemë kacavjerrëse. Ishte bima më e çuditshme që i kishin zënë sytë ndonjëherë. Ngjante si një kokë gjigante fshese, por e gjelbër dhe me gjemba e gunga. Në krahët e kaktusit kishin mbirë ca dredhëza me ngjyra të verdha e portokalli dhe në secilën prej tyre kishte nga një frut që quqëlonte. Ishte Pitaja – Fruta dragua. Nëse kjo frutë preket, ajo ndriçon dhe kthehet në një dragua të vogël dhe të magjishëm. Këtë bëri edhe Tomasi, e preku dhe e vendosi në komodinë në dhomën e tij, por në mbrëmje papritmas vuri re se para tij kish një dragua të vogël...

Fantastike apo jo?! Imagjinoni të keni një dragua të vërtetë në duar si personazhi ynë, Tomasi, me të cilin mund të luash dhe të kujdesesh për të. Ai kishte flatra vezulluese, luspa me ngjyrë të kuqe, sy si diamantë, frymë si zjarr, kthetra të mprehta, bishtin si majë shigjete dhe dy brirë të vegjël. Por në të vërtetë duket se nuk është kaq e lehtë, sepse duhet të dish si të kujdesesh. Nuk është si të kesh një qenush të cilit i mjaftojnë pak ushqim e përkëdhelira apo shëtitje

Djali që rriti dragonj – një aventurë mes imagjinatës dhe realitetit

Nga Anila Bisha

në natyrë. Jo! Dragonjtë lëshojnë flakë e mund të të djegin bluzën apo të të gërvishin, rriten shpejt e nuk i nxe streha e vogël, bëjnë zhurmë e nuk i fsheh dot, sidomos nga prindërit që nuk duan andrralla të tilla. E natyrisht për personazhin tonë më e lehtë është t’u rrëfejë shokëve, me ta mund të ndajë sekrete dhe aventura. Sepse pema ka shumë fruta të tillë dhe secili mund të ketë dragoin e tij. Por, Tomasi dhe shokët e tij nuk duhet vetëm të kujdesen për edukimin e dragonjve, por edhe të përballen me situata të ndërkuara dhe të rrezikshme, sepse dy prej dragonjve kanë rënë në duart e gabuara. Problem nuk janë vetëm rrëmuja, flakët, gjurmët e këmbëve të tyre apo fryma prej shtëllunge flake. Por vjen dita kur ata duhet t’i lënë të lirë, sepse dragonjtë nuk janë kafshë shtëpiake, janë krijesa të vështira për t’u rritur në shtëpi. Fëmijët mahnitën prej tyre ndërsa i shohin të fluturojnë netëve me yje që rrëzëllejnë nga shpërthimi i ngjyrave. Ndaj Tomasi i premton gjyshit që do t’i lërë të lirë të ikin. Por e ka të vështirë t’ua kërkojë këtë shokëve. Edhe ai vetë është i shqetësuar se si do të jetojnë dragonjtë larg tyre, a do të mund t’ia dalin.

Të gjitha këto gjejnë përgjigje përgjatë serisë. Tomasi pasi arrin të zbulojë sekretin se dragonjtë mund të rriten edhe në pemë vendos t’ua mësojë jo vetëm shokëve të tij, por edhe lexuesve se si të rritin dragonj. Një udhëzues për të cilin do të mësoni edhe më shumë në librin e gjashtë, ku Tomasi na rrëfen legjendën e frutës së dragoit, ku ta mbani dragoin tuaj, rregullat se si t’i stërvitni, por më e mrekullueshme është të zbuloni se si të bisedoni me dragonjtë.

Mes imagjinatës dhe realitetit

Shkrimtarja Andy Shepherd ka arritur të ndërthurë natyrshëm përmes letërsisë njohuri dhe fakte mjaft interesante për personazhet e saj në libër. Origjinën e dragonjve, historinë e tyre, faktet historike, detaje të aspektit gjeografik apo njohuri nga biologjia duke arritur ta bëj shumë të besueshme ngjarjen dhe seria bëhet edhe një udhërrëfyes njohës i një bote imagjinare, por të krijuar me dashuri, ndaj dhe është kaq tërheqës sa lexohet me një frymë.



Në takimet e saj me lexuesit autorja tregon se për të shkruar këtë seri është frymëzuar nga kujtimet e fëmijërisë saj, koha që kalonte me gjyshin në kopshtin e tij, lidhja që ajo vetë ka me natyrën. Për të seria nuk ka qenë e lehtë për t’u shkruar dhe librat, i kanë marrë shumë kohë. “Disa libra janë pa dyshim më të vështirë për t’u shkruar se të tjerët. Tre librat e parë i kisha të shkruar në mendje ndërsa libri i katërt m’u duk i vështirë dhe e kam kaluar shpesh përmes ndryshimesh”, - shprehet ajo. Por është e gëzuar që më në fund fëmijët mund të lexojnë histori të bukura, të veçanta dhe për më tepër të gjithë adhuruesit e dragonjve do t’i njohin dragonjtë që kanë luspa, që valëzojnë e shndritin si pasqyrimi i diellit në det, sy të shndritshëm, frymë të nxehtë që të ngroh zemrën dhe shumë e shumë histori befasuese për fëmijët.

Seria është shkruar me një gjuhë të thjeshtë, por shumë të pasur me shprehje të figurshme, me përshkrime të mrekullueshme, me ndjenjë dhe me humor si dhe përcjell mesazhe që natyrshëm ndikojnë te fëmijët përmes leximit.

Me një fund shumë të bukur – lexuesit do të përjetojnë një aventurë sa magjike aq edhe reale. Dragonjtë në libër janë vërtet fantastikë, të papërmbytshëm dhe verbues!

Lexim të këndshëm për të gjithë – fëmijë dhe dragoj!

Disa sekrete që duhet t’i dini para se ta lexoni librin

1. Të rritësh një dragua është më e vështirë se mbjellja e kastravecëve. Sepse një dragua nuk është një bimë.
2. Sekret i vështirë për t’u mbajtur sepse nuk mund ta fshehësh një krijesë që fluturon, që lëshon flakë nga goja dhe që ka luspa vezulluese.
3. Kanë një bisht të gjatë, i cili mund të të godasë pa e kuptuar.
4. Mbaj gjithnjë një palë doreza dhe një pistoletë uji – I vlejnë çdonjërit që do të jetë prind dragoi.
5. Edhe pse është sfiduese rritja e një dragoi sërish të jep shumë kanaqësi! Ata vezullojnë dhe të magjepsin me trupin e tyre. Shikimi i tyre të depërton në zemër.

Janë miq të përjetshëm!



Letërsia për fëmijë - për një kohë të gjatë e nënvleftësuar - nuk qëndron më poshtë nga vlera estetike se letërsia për të rritur, përveç vlerës njohëse dhe edukative që qëndron në bazë të ekzistencës së saj. Kjo letërsi, për të depërtuar në shpirtin e lexuesve të vegjël, duhet të zhvishet gjithnjë e më tepër nga fryma didaktike që e bën të mërzitshme dhe të gjejë çelësat për të komunikuar me fëmijët.

Raimonda Belli Gjençaj, e njohur tashmë si romanciere për të rritur, ka edhe një prirje të shkruari për fëmijë, që e ka treguar me veprat:

“Duduqi që kërkonte kushërinj”, “Kukulla Blerta udhëton drejt detit”, “Taku rrumbullaku, Tiku thataniku dhe Roboti Tik-Tak” dhe “Një çudi në zoopark”.

Sot, kjo autore na befason me romanin e ri me titullin intrigues “Toroboti”. Në këtë roman ajo ka gjetur dy nga çelësat për të depërtuar me lexuesin fëmijë, humorin dhe aftësinë për të qëmtuar në një subjekt të pasur me të papritura. Në këtë roman krahas me dy protagonistët fëmijë gjejmë një të tretë, njeriun mekanik, robotin, personazh i sa e sa veprave të fantashkencës.

Ky lloj i veprave për fëmijë ka njohur zhvillimin e vet edhe në letërsinë shqiptare, po në shumë vepra teknologjia mbizotëron mbi estetikën, krijimin e personazheve të gjallë.

Si antipod i këtij realiteti, në këtë vepër krahas personazheve njerëzorë të goditur, dy fëmijët dhe një plakë simpatike, gjejmë një makinë të njerëzuar.

Autorja nuk e sheh këtë personazh të çuditshëm prej roboti që evolon deri te njeriu si kërcënim për njerëzit, si në disa vepra fantastike-shkencore ku flitet për rrezikun e një kryengritjeje nga ana e robotëve, e sheh përkundrazi me miratim dhe simpati. “Toroboti”, ky robot, fryt i fantazisë dhe teknologjisë së krijuar nga njerëzit, ndihmës i tyre që pasqyron ecjen e vrullshme përpara të shkencës dhe është në këtë kuptim, aktual, arrin të fitojë disa tipare njerëzore, ndjenjën e dashurisë dhe mirënjohjes për fëmijët që kujdesen për të, madje edhe diçka tjetër karakteristike vetëm për njerëzit, ndjenjën kombëtare.

Ky robot del jashtë programit të paracaktuar, fiton disa tipare shpirtërore, mishëron një mesazh solidariteti dhe identiteti. Përmes transmetimit nga ana e protagonistëve të dashurisë së tyre për atdheun, krijesës së njerëzuar, autorja shpreh patriotizmin e vet, një vlerë tradicionale që rrezikohet në këtë kohë kozmopolitizmi.

Autorja shqetësohet me të drejtë për gjuhën shqipe, të ruajtur për shekuj me mjaft sakrifica dhe së cilës i duhet t'i bëjë ballë sulmit të gjuhëve të huaja, veçanërisht të një gjuhe që quhet ndërkombëtare, si anglishtja. Në të vërtetë gjatë përdorimit të gjerë të gjuhëve të huaja, dukuri e përhapur sot, harrohet se përpara se të jetë qytetar i botës, njeriu duhet të jetë qytetar i vendit të vet, të zbulojë ngjyrat e veçanta të kombit të vet që pasurojnë spektrin botëror.

Autorja shpreh edhe shqetësimin që ka një bazë reale se përhapja e mjeteve teknologjike që propagandojnë botën virtuale mund t'i largojë fëmijët, njerëzit e së ardhmes, nga natyra dhe bota e gjallë dhe e shpreh këtë, duke pasqyruar pasionin e Takut, njerit prej fëmijëve protagonistë, për *tabletën*.

Nëna e tij, e shqetësuar me të drejtë për këtë çështje, përpiket ta largojë të birin nga ky pasion që kthehet në *mani*. Djali reagon në fillim në mënyrë kundërshtuese. Gjatë konfliktit prind-

“TOROBOTI” NJË ROMAN PËR FËMIJË QË VËSHTRON NË TË ARDHMEN

Prof. Dr. Klara Kodra

fëmijë që djali i vogël do ta zgjidhë me naivitet në mënyrën e vet, fëmijës i ndodh një aksident që ka një pasojë të papritur: në vend që ta largojë prej veprimtarisë aktive pikërisht ky aksident bëhet shkak që ai të njihet me natyrën dhe botën e gjallë, madje të zbulojë shokë të rinj, njerëz të rinj.

Autorja e ka shndërruar subjektin në një zinzhir aventurash të këndshme dhe zbavitëse që të befasojnë dhe të bëjnë për të qeshur. Romani “Toroboti” është pra një vepër e shëndetshme, optimiste dhe “diellore”.

Në roman zbulojmë edhe vlerat e traditës përmes figurës së një të moshuarë, të mençur dhe aktive, Stërnenesë.

Ky personazh, bartës vlerash tradicionale është i aftë edhe të përqafojë të renë duke u njohur dhe miqësuar me

Torobotin. Stërneneja komunikon me fëmijët protagonistë, po përpiket të komunikojë edhe me robotin si me një njeri në miniaturë që e befason, po edhe i zgjon ndjenja dhembshurie prej gjysheje.

Përmes figurës së Stërnenesë, plakës njëqindvjeçare, jepet ideja e komunikimit midis brezave si një dialog të së tashmes me të kaluarën për të synuar drejt së ardhmes.

Pikërisht kjo ide, ideja e një dialogu të afërt e zëvendëson konfliktin midis brezave dhe është fjala për breza që i ndan një humnerë e gjatë kohe.

Pra, mesazhi i këtij romani është një mesazh veçanërisht i pasur që ka kërkuar formën e përshtatshme dhe e ka gjetur përmes humorit që e gjallëron veprën si një përrua i rrëmbyer i brendshëm.

Romanin e përshkon tejprtej një e



qeshur e shëndetshme, një patos komik që nënvizon kërkimin e arritjeve të reja nga ana e personazheve, një patos komik, befases, jo shkatërrues; në fakt është fjala për humor, jo për sarkazëm, një humor që çdramatizon edhe ndonjë ndodhi të pakëndshme si aksidenti që i ndodhi Takut, njerit prej protagonistëve, një aksident që e shtyn të njohë anë të reja të jetës ose momenti kur Stërnenesë i ngjan se Toroboti ka mbetur pa frymë, moment që bëhet pikënisje për miqësimin e saj me njeriun mekanik.

Në romanet e saj për të rritur Raimonda kishte ditur të pasqyronte anët dramatike, madje tragjike të jetës; përkundrazi në këtë roman sheh më tepër aspektet më të bukura e të gëzuara të realitetit. Po nuk është fjala për idealizëm, për teprim në përdorimin e ngjyrave rozë, po më tepër për optimizëm, për besim në jetë, në triumfin e së mirës.

Romani “Toroboti” vështron në të ardhmen ku shkenca dhe teknologjia do të pasurohen dhe të thellohen, po uron që këto fitore të ardhshme të bashkohen me vlerat e ruajtura me shekuj të traditave popullore, identitetit kombëtar pjesë e së cilës është gjuha shqipe, veçanërisht origjinale dhe e pasur në forma fonetike dhe leksikore.

Edhe poezia do të bëjë pjesë në këto tradita, gjë që shprehet në personazhin komik, po edhe simpatik të Çun rimaxhiut që sajon vjersha bejte, po që ndofta në të ardhmen do të bëhet poet i vërtetë.

Është kuptimplotë ky shqetësim i autores për fatin e poezisë, në një kohë kur librat, sidomos vëllimet poetike përleshën me internetin.


Në roman përveç figurës dinjitoze dhe të dashur të Stërnenesë, ka edhe tipa të tjerë femërorë të brezave të ndryshme si teta Dita dhe binjakja e Çunit, Nora, që derdhin ëmbëlsi dhe butësi në vepër.

Romani është strukturuar në bazë të naracionit nga ana e një rrëfimtari në vetë të tretë, çka jep idenë për një objektivitet dhe ka shumë dialogë të gjallë dhe karakterizues.

Veprimi rrjedh në mënyrë dinamike, ngjarjet pasojnë njëra-tjetrën, duke mbajtur të gjallë interesin e lexuesit gjer në fund. Dhe fundi është optimist, jo një vepër “happy ending” i sforcuar, po diçka që rrjedh bindshëm nga karakteri i personazheve, njerëz apo madje edhe krijesës mekanike që i jep emrin veprës.

Të gjitha këto personazhe kanë evokuar, kanë zhvilluar edhe më cilësitë e tyre pozitive, në përputhje me dialektikën e natyrshme të shpirtit dhe janë përpjekur të zhvishen nga të metat e tyre.

Kjo vepër zbulon një aspekt të ri të individualitetit krijues të autores së tij dhe besojmë se do të zërë vendin e vet të spikatur në letërsinë e sotme për fëmijë.



1.

Sapo është publikuar libri më i fundit Si Ylli Pangos, botuar një vit më parë anglisht në Amazon nën titullin “My little ones” dhe në shqip në version më të zgjeruar disa muaj më vonë me titullin “Të vegjlit e mi”, me shënimin ‘Rrëfenja – për fëmijë dhe të rritur’. Në përcjelljen e librit në anglisht, botuesit me pak rreshta japin në mënyrë të sintetizuar se çfarë është ky libër:

“Narrativa rrëfen udhëtimin e autorit përmes momenteve të rëndësishme personale dhe emocionale, duke filluar me një orë anglishteje në Universitetin e Bostonit, ku studentëve nga prejardhje të ndryshme iu kërkua të shkruanin një ese mbi një përvojë të paharrueshme. Një shok klase nga Argjentina fitoi konkursin e eseve me një rrëfim prekës të dëshmisë së lindjes së fëmijës së tij, i cili rezonoi thellë me autorin dhe të tjerët për përshkrimin universal të emocioneve njerëzore.

I frymëzuar nga kjo, autori ndan historinë e tij të të bërit baba në moshën 68 vjeç pas vitesh luftë me infertilitetin. Udhëtimi përfshinte vizita të panumërta mjekësore dhe zhgënjime, duke përfshirë një takim me një mjek indiferent parizien, përpara se më në fund të merrte lajmin e gëzueshëm në Tiranë. Lindja e djalit të tij, Daniel, në Ditën e Shën Valentinit 2020, mes hijes së pandemisë Covid-19, solli dashuri dhe ripërtëritje të thellë në jetën e tij. Teksti reflekton mbi udhëtimin e butë dhe transformues të prindërimit, duke u përqendruar te Danja, një fëmijë i vogël plot pafajësi, kuriozitet dhe potencial. Danja rritet, kurioziteti dhe dëshira e tij e pakufishme për të mësuar shkëlqejnë. Ai përparon me shpejtësi, nga numërimi deri në 100 në arritjen e 1000, duke bërë vazhdimisht pyetje dhe duke eksploruar botën përreth tij. Prindërit meditojnë

Shënime për librin e Ylli Pangos “My little ones”, përkthyer në anglisht nga Carrie Hooper, botuar nga Amazon në nëntor 2024 dhe në shqip me titullin “Të vegjlit e mi”, botimet Onufri 2025

Ylli Pango, kronikë e papërfunduar për familjen dhe dashurinë njerëzore

Nga Çerçiz Loloçi

mbi të ardhmen e tij, duke parashikuar mundësi të pakufizuara – një studiues, një eksplorues ose thjesht një individ me shpirt të lirë. Siguria qëndron në ritmin e shpejtë të rritjes së tij dhe në lidhjen e qëndrueshme që ai ndan me nënën e tij, e cila e sheh atë si kryeveprën e saj përfundimtare. Autori reflekton mbi mrekullinë universale të prindërimit dhe fuqinë transformuese të dashurisë, duke i nxitur të tjerët të përqafojnë gëzimet e rritjes së një fëmije pavarësisht nga mosha ose rrethanat”.

2.

Kuptohet se është një histori familjare, Kajo e vetë autorit, lidhja dashurore me një vajzë ukrainase nga Odesa që pas shumë peripecish dhe për gati dhjetë vjet kurorëzohet me lindjen e një fëmije. Kështu kanë qenë pak a shumë dhe librat e Mamin-Sybiryak, Andersen, Rouling, Caroll, Ekzyperi e të tjera me zanafillë familjare, por me kumte të mëdha universale; ato u lexuan masivisht në gjallje të autorëve dhe ende më shumë kur ata nuk jetonin më dhe ishin bërë tekste të detyrueshëm për miliona e miliona



lexues. Në një etyd, Pango shkruan “Ai vë kokën e vogël, faqet, buzët mbi faqen e saj dhe ashtu fle pastaj. Bëmë baba të të ngjaj. Unë bëja pothuaj të njëjtën gjë me mamin e Danjës, këtu e 10 vjet më parë, kur u dashuroam dhe shkuam në një hotel në Budva. Ngjisja buzët pas të sajave dhe besoni nuk besoni, ashtu na zinte gjumi për orë të tëra. Sikur të ngjiteshim. Flinin dhe shihnim ëndrra bashkë për orë të tëra, buzëbashkë, duke marrë frymën e njeri-tjetrit. Edhe ëndrrat i shihnim bashkë”. Ndërsa në një kapitull më poshtë, ai shkruan “A e vini re që e gjithë kjo që ngritëm ne të tre - gruaja, unë dhe bebi, që tashmë po u afrohet të tre vjetëve – është një mrekulli? E ngritëm të tre. Po! Edhe bebi ishte pjesë e asaj që u ngrit. Ende pa lindur. Se ishte pjesë e ëndrrës së të dyve. Ekzistonte. Në mendje. Dhe ëndrra është e para. Jo fjala”.

Tri personazhe, burri, bashkëshortja dhe djali i tyre janë në fokusin e pesëdhjetë e gjashtë kapitujve e edyteve duke zbuluar hap pas hapi përjetimet e secilit, në mosha të ndryshme dhe në një periudhë të pazakontë kur pandemia e Covid-19 detyroi miliarda njerëz të mbylleshin brenda katër mureve.

Historitë familjare, qoftë edhe ato në rrethana të jashtëzakonshme, kanë gjithherë kurthin e rënies në vogëlsira, në zgjatje dhe stërzgjatje, por autori i ka shpëtuar mjeshtërisht duke dhënë së pari një manual se si mund të rritësh një fëmijë, si ta edukosh atë qysh në belbëzimet e para, pa i kufizuar lirinë, tekat, gabimet foshnjore që e rritin me minuta dhe me orë.

Libri të emocionon nga fillimi në fund, me gjetje dhe befasi të këndshme, me një lloj ankthi nga kapitulli në kapitull, duke krijuar kështu një përmendore për familjen, për dashurinë e pakushtëzuar si për të nënvizuar se gjërat e mëdha vijnë e konsolidohen nga disa gjëra të brendshme të jetës së përditshme njerëzore.

Në fund të librit autori shkruan: “Ç’do të bëhet me të? Ku ta dish? Mund të bëhet një njeri i zakonshëm si të gjithë ne? Një dijedashës e aq? Një eksplorator i Antarktidës që e kishte aq në qejf kur ishte ende tre-katër vjeç? Një qytetar i lirë a globtrotter, siç patëm ëndërruar dikur ne, të izoluarit nga absurdi. Apo studiues? E përsëri, ku ta dish? Një gjë është e sigurt. Danja po rritet e rritet me shpejtësi. Unë po vazhdoj të rritem bashkë me të dhe për sa kohë të jem gjallë, ky libër do të vazhdojë të shkruhet e të shkruhet”.

Duke lexuar romanin *Brirët, botimet “Fishta” 2024*, të shkrimtarit dhe poetit të mirënjohur Marash Mirashi, lexuesit i shpaloset një alegori e thellë dhe tronditëse mbi realitetin shqiptar, një pasqyrim grotesk i jetës sonë shoqërore ndër dekada ,madje edhe më gjatë, për të mos thënë ndër shekuj. Në mënyrë simbolike dhe mjeshtërore, autori paraqet një shtet të trilluar me emrin kuptimplotë **Babziland**, vendi i të babëziturve. Edhe monedha vendase, **babzinda**, nuk është thjesht shpikje letrare, por mbart në vetvete një satirë të hollë gjuhësore mbi etjen për pushtet dhe pasuri.

Qysh në faqet e para, romani zë fill me një skanim të thellë të jetës shqiptare ,nga qytetari më i thjeshtë deri tek majat e pushtetit, e në mënyrë të veçantë, tek këto të fundit. Autori përdor simbolika dhe metafora të ndryshme për të skalitur një tablo shumëdimensionale të një shoqërie të ndarë mes servilizmit, harresës dhe revoltës së shtypur. Narrativa e tij është e mbushur me tipizime që pasqyrojnë figura kolektive e individuale të politikës, mediave, institucioneve dhe vetë popullit.

Në qendër të romanit qëndron **Kryebariu**, një figurë groteske dhe alegorike që përmbledh në vete tiparet më negative dhe më të njohura të udhëheqësve shqiptarë, si të epokës së diktaturës, ashtu edhe të tranzicionit demokratik. Despotizmi i tij, arroganca, brutaliteti dhe narcisizmi shpërfaqen jo vetëm në veprime, por edhe në detajet më të imta të sjelljes dhe gjuhës së tij ,nga veshja me pantallona të çuditshme, tek fjalori vulgar dhe i dhunshëm, apo në mimikën dhe gjestet tipike që lexuesi i vëmendshëm do t’i njohë lehtësisht.

Në këtë realitet alegorik, ngjarjet zhvillohen në mënyrë të ngjeshur, duke krijuar një pasqyrë tronditëse të realitetit shqiptar. Arrestimi absurd i të ashtuquajturve “sabotatorë të ribrirëzimit”, burgosja e Atë Faustit, emërimi grotesk i Samantës fshatare në Këshillin e Lartë të Barinjve ,të gjitha këto ngjarje janë reminishenca të hidhura të diktaturës komuniste dhe pasqyrim satirik i skenës politike të sotme.

Figura të tjera, si gazetari **Tim David**, paraqiten si zëra kritikë që shfaqin pamjen e vërtetë të shtetit baritor të Babzilandit. Artikulli i tij në gazetën “*Imperial*”, që irriton në kulm Kryebariun ,është një kritikë e hapur ndaj korrupsionit dhe absurditetit institucional, ndërsa reagimi i Kryebariut ,duke e shpallur gazetën “letër higjienike”, përforcon anën e egër e paranojake të këtij lideri autoritar.

Autori nuk ndalet vetëm në sarkazmën politike. Në mënyrë shumë të natyrshme, ai kontraston turmat e servilëve me qytetarë të zakonshëm e të ndershëm. Romi farkëtar që ndihmon gazetarin pa interes, apo fshatari që ther pulën për mikun e huaj, janë shembuj të virtyteve që ende ekzistojnë në shoqërinë shqiptare, ndonëse të mbytura në zhurmën e korrupsionit dhe hipokrizisë.

Një galeri e gjerë personazhesh përshkon romanin: barinj, bareshka, zyrtarë, gazetarë, analistë, politikanë, të burgosur politikë dhe oportunistë të të gjitha niveleve. Emrat e tyre shpesh janë simbolikë, si *Blind Kuk*, drejtuesi i emisionit televiziv që kërkon sensacion me çdo kusht, apo *Fill Bobi* dhe *Kristinë Pamshira*, gazetarë kritikë që përballen me sulme dhe etiketime brutale si “horr” dhe “lavire bulevardit”.

Ngjarjet në roman janë të ngarkuara me simbolikë. Procesi i “ribrirëzimit” vjen si njw sarkazwm pwr zyrtarwt e lartw tw cilwt janw tw gatshwm tw shndwrrohen



“BRIRËT”, SATIRA QË ZBËRTHEN REALITETIN SHQIPTAR ME NJË HUMOR THERËS

Nga Tom Gjokhilaj

vullnetarisht nw kafshwt e bindura tw liderit Kryebari, duke i dhwnw romanit njw atmosferw grotske qw tw kujton George Orwell. Aksioni për pastrimin e lumit Brajt i ngjan nismave për ruajtjen e lumit Vjosa. Referenca të drejtpërdrejta bëhen ndaj grabitjes së pronave, burgosjes pa gjyq të kundërshtarëve, manipulimit të votave, përndjekjes së klerit, gjithçka e njohur për realitetin tonë të përditshëm.

Gjuha që përdor Mirashi është e thukët, me ritëm dhe humor të hollë, shpesh therës, që e bën leximin një përvojë të gjallë e emocionale. Ai nuk e zvarrit rrëfimin, por lëviz natyrshëm nga një episod në tjetrin, duke ruajtur gjithmonë koherencën dhe intensitetin e tregimit. Romani është i pasur me shprehje idiomatike dhe figura letrare që e shndërrojnë në një pamflet letrar ndaj sistemit të kalbur që ai përshkruan.

Shumë emra simbolikë si *Tirrvuli*,

Kilmondi, apo republikat përreth si *Ibretisatani*, *Kismetistani* dhe *Tallavaland* janë metafora të vendeve reale që shqiptarët i njohin mirë, duke përfuruar më tej karakterin alegorik të veprës.

Në përfundim, *Brirët* është më shumë se një roman: është një manifest artistik, një kritikë e ashpër dhe e drejtëpërdrejtë ndaj realitetit shqiptar. Me një qasje të guximshme stilistike dhe me një mjeshtëri të padiskutueshme, Marash Mirashi ka realizuar një vepër që të bën të qeshësh me trishtim dhe të mendohesh me dhimbje. Kjo vepër është dëshmi e fuqisë së letërsisë për të ndriçuar errësirën e shoqërisë dhe për të zgjuar ndërgjegjen kolektive.

Nuk është rastësi që ky roman është vlerësuar me çmimin “**Atë Gjergj Fishta**” si romani më i mirë i vitit 2024. Ai është një përkufizim i saktë i asaj që letërsia duhet të jetë: pasqyrë, alarm dhe shpresë.



Analizë e romanit “Lakimi” të Durim Taçit, “Living”

Letërsi që i bën shërbim të madh opinionit

Nga Lekë Tasi

Durim Taçi në romanin e tij më të ri “Lakimi” (Botimet “Living”), dëshmon një aftësi kompozimi që nuk habit lexuesit e tij të librave më të hershëm. Përvoja e tij nga jeta në emigracion dhe përgatitja teorike e nisur në Tiranë me fakultetin e filologjisë dhe me studimet për kinematografi, vazhduar më tej në Milano me filozofi, e kanë aftësuar Durimin të ndërtojë letërsi me marrëdhënie jetësore, personazhe, karaktere, situata që të bindin me vërtetësinë e tyre pulsuese, dhe ta përfytyrojnë hedhjen e tyre në letër si fryt kryesisht të talentit (improvizim vrojtim) dhe pastaj të aparatit profesional të tij.

Kush e njeh Durimin romancier prej produktit të tij më të hershëm, të mbushur me përpjekje e dhimbje në vitet e mëkëmbjes së emigracionit, veçon te romani “Lakimi” një fjalë të fortë shqiptuar përmjet Elirës, personazh shqiptar dhe evropian njëherazi, e cila gjen rast të shkundë në lirinë e atjeshme qoftë mykun tonë shqiptar në familje, ashtu dhe egërsinë mashkullore të mesjetës europiane, që mbijeton çuditërisht me gjakftohtësi cinike dhe e pandëshkuar ende falë solidaritetit midis sadistëve modernë.

Pasqyrimi i këtyre episodeve me një ritëm të ngjeshur në libër të bën të kuptosh çmimin *Montefiore* që iu dha Durimit në vitin 2016 për librin e tij *Codice Kanun*, një arritje e paekuivok atje në Italinë editoriale të mbushur me autorë niveli. Jurive duhet tu ketë rënë në sy të folurit e tij pa doreza brenda raportit të vështirë që jeta ka vendosur atje me emigrantët, objektivisht por edhe subjektivisht sipas rastit, pra ngjan ta kenë përzgjedhur ndër kaq kandidatë, një ofrues gjërash të vlefshme dhe të dallushme në atë mes. Kjo arritje gëzon ambjentet letrare e artistike në atdhe, por nuk dihet nëse kjo kënaqësi e grupeve të emancipuara do të ketë forcën të shkundë modën e vjetër që reziston me shkëmbime çmimesh rregullisht brenda jurive këtu...


Titulli “Lakimi” ka të bëjë me lakimin e emrit: emnore, gjinore etj., dhe është një gjetje e autorit për të artikuluar episode të ndryshme në të cilat pasqyrohet lufta që i bëhet femrës që guxon të jetë e lirë. Kështu, në rastin konkret, edhe përpjekja e saj për t’ia kthyer fjalën mashkullit të përhershëm baraz, do përfundojë me tragjedi, në mos të njerës, të tjetrës prej femrave të përfshira.

“Furnizuesi” i këtyre episodeve online, Roberto, një beqar që ofrohet veç pak për dialog të hapur, e refuzon sugjerimin e Elirës në këtë drejtim. Profiloheh kështu gati pa dashur edhe natyra e dy figurave në tipiken e tyre më të thellë historike psikologjike, megjithse të afërta: ajo e zvarritjes që karakterizon vendin më të qytetëruar të Evropës, të mbërritur sot në një udhëkryq pritjeje të pa nerv nga njera anë, dhe ajo e vrullshmja e një shoqërie të shtypur me një fund që kërkon rrugëdalje në çdo por të saj, dmth tek çdo kërkues fati me skaf o në shtigje malore.

Historia nis pikërisht me këtë lloj dialogu të shkruar siç e propozon Italiani i sofistikuar, të cilin Elira, me temperament aspak të sofistikuar, por të vendosur, e do të folur troç, për ta deshifruar aty për aty mesazhin në funksion të kërkesave të saj jetësore, që pastaj të vështrojë përpara. Robertoja mbetet i papërfshirë, kështu që lexuesi ka raste të regjistrojë episode pa fund që ai i rendit gati me cinizëm, histori të trishta që kanë në qendër femrën viktimë. Natyrisht, ky fill nuk është përjashtim i papërfillshëm në kronikat e atij vendi të njohur për humanizmin e tij të shquar. Në nivele më të larta, paligjësia ka tronditur rendin politik deri sa u fol *republiکہ prokurorësh*, por me rezultate dramatike. Gjithsesi e keqja duhet luftuar sado të rrallë të jenë bartësit e saj.

Një vlerë e dukshme e librit qëndron te fakti që episodet janë nxjerrë nga arkivat, pra bazohen te vërtetësia, gjë që koston punë kërkimore, kurse paraqitja e tyre si pjesë e thurjes së jetës, me Elirën dhe personazhet e tjerë në qendër, merr formën e një trame thuaje policore me dyshime, rreziqe, zhgënjime dhe konkluzione përfundimtare, që e mbajnë gjallë tensionin tek lexuesi dhe i japin, falë profesionalizmit të sprovuar të autorit, një kënaqësi si në çdo roman modern të aksionit, ku ndeshemi me emocionet intensive që ka sot jeta në metropolet e botës, nëpër xhepat e fshehura të kronikës së zezë, me plagët që mund të mos shfaqen veçse një herë në jetë ose fare te shtresat e pasura.

Prandaj letërsia, kjo lloj letërsie, i bën një shërbim të madh opinionit. Parathënia e shkurtër e Victor Hugo tek “Të Mjerët” mbetet përherë në fuqi...



Pak vepra të shkaktojnë kënaqësi leximi, por edhe më pak, përpos kënaqësisë, të shkaktojnë habi, tronditje konceptuale, dhe rishikim të mendimeve për një gjë apo për shumë gjëra. Kur them habi e kam fjalën për habinë filozofike në kuptimin e asaj që e shpjegon Zhan Hirsh kur i interpreton mendimet e klasikëve të filozofisë botërore. Një vepër që hyn në grupin e dytë të përmendur më sipër është romani “Portreti i artistit në rini” i shkrimtarit ikonik botëror, Xhejms Xhojs, njërit nga mendjet dhe penat e mëdha të modernizmit në letërsinë e përbotshme.

“Portreti i artistit në rini” është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe edhe më parë, meqë jam lexues i dy përkthimeve të mëparshme të tij, por përkthimi i tij nga Krenar Hajdëri dhe botimi nga Sh. B. “Albas” më ka lënë një përshtypje të veçantë për gjuhën e shqipërimin dhe për shpjegimet e nevojshme që mund t’i duhen një lexuesi të romaneve të ikonikut Xhejms Xhojs. Kuptimi i romaneve të këtij shkrimtari ka nevojë për disa shenjëza shpjeguese, meqë gjuhën e tij, gërshetimi mes ambientit lokal (Dublini, Corkut, Konglavee, Irlandës etj) me konceptimet dhe rrëfimin universal mund të shkaktojë moskuptim te lexuesi i pastërvitur me këtë tip letërsie, siç është ajo e shkrimtarit për të cilin jam duke shkruar. Po ashtu, gjuha dhe fjalët e zgjedhura nga përkthyesi i shkojnë shumë për shtati natyrës së ligjërimit artistik dhe mendimtar në këtë roman. Nga kjo mësojmë se përkthyesi ka njohje të kënaqshme, përpos në gjuhën origjinale të romanit, edhe në dijet humane dhe në mendimin filozofik, por edhe ka dije të mirë mbi estetikën. Kjo gjë e bën përkthimin të jetë i mirëqenë në aspektin e vlerave kulturore dhe diturore.

Romani “Portreti i artistit në rini” e lexova, gjegjësisht e rilexova, me një nxitje për ta parë se si mund ta përjetoj leximin e një kryevepre pas disa viteve të leximit të parë të saj. Nuk e mbaj mend saktë vitin e leximit të parë dhe të dytë, por habinë dhe kërsërinë më të madhe e përjetova në leximin e tretë të këtij romani. Ndoshta do të kenë ndikuar rrethanat dhe kushtet e leximit, por leximi i tretë i përkthimit të Krenar Hajdërit dhe botimit të “Albasit” ishte më sfiduesi për mua si lexues i rregullt i letërsisë së madhe dhe synimtar për të qenë romancier i natyrshëm.

Lexonjësi i “Portretit...” për t’u kuptuar më së miri dhe më së lehti është mirë që të ketë sadopak njohuri biografike për jetën e shkrimtarit irlandez, Xhejms Xhojs, i cili në tryezën e madhe të letërsisë së përbotshme është i ulur në pjesën ballore dhe atë në mesin e saj, duke u bërë i tejpranishëm dhe i pacënueshëm në raport me të gjithë zhvillimin e artit të bukur që nga fillimi dhe deri më sot. Pra, një njohje e jetës së autorit mundëson kapjen më të mirë të rrëfimit, duke qenë se ky roman ka ngjyresa të tejdukshme autobiografike dhe ata që e njohin edhe jetën, përpos veprën e Xhojsit, mund t’i vërejnë lehtësisht ato.

Ky roman ka filluar të shkruhet në vitin 1904 dhe është përfunduar në 1914. Jo që ka shumë rëndësi për lexuesin data e fillimit dhe mbarimit të shkrimit të një romani, por këtë shkarje nga interpretimi bazë e bëjmë për të dhënë një shenjë të një ndërmarrje letrare të shkrimtarit që ka zgjatur për dhjetë vjet, duke filluar në Dublin të Irlandës dhe përfunduar në Trieste të Italisë, që në atëbotë i takonte Perandorisë Austro-Hungareze. Ky shënjim i kohëzgjatjes së shkrimit të një romani vlen edhe për ta interpretuar të dhënë se sot vështirë gjejmë ndonjë rast të tillë, në letërsinë shqipe aq më pak, të një pune kaq të gjatë në krijimin e një bote narrative. Shkrimtarët e profilit të Xhojsit e kanë pasur dhe durimin dhe mosngutinë për ta bërë veprën më të plotë dhe më shumëdimensionale në aspektin formal dhe ideor.

Ky roman u botua për herë të parë në faqet e revistës letrare “The egoist” në Londër. Në bazë të informatave tona, botimi në seri në këtë revistë u bë me insistimin e shkrimtarit të vlershëm amerikan, Ezra Pound, të cilit Xhojsi ia kishte dhuruar disa kapituj të këtij romani. Kështu që, për një periudhë gati dyvjeçare (fillimi i 1914 dhe fundi i 1915) u botuan disa pjesë të këtij romani, gjë që i dha irlandezit të madh të letërsisë një peshë dhe një emër në botën e shkrimtarëve të atëbotshëm.

Përkthimi në shqip i “Portreti i artistit në rini”

Portreti i Xhojsit

Nga Adil Olluri

Gjithashtu, është e udhës ta cekim se botimet e para u bën jo me emrin e autorit, por me pseudonimin Stefan Dedulas, ashtu siç e kishte emrin personazhi kryesor i këtij romani, gjegjësisht alteregoja e Xhojsit.

“Portreti i artistit në rini” na rrëfen për etapat jetësore të një të riu me emrin Stefan Dedulas, që nga fëmijëria shkollore deri në fazën pas adoleshente, rinisë. Na jep një përshkrim i vëmendshëm i botës shpirtërore të një të riu, duke shfaqur para lexuesit të tij një tip personazhi që shpreh shumë, që vrojton shumë, që mendon shumë dhe imagjinoon shumë. Xhojsi hyn në thellësinë e imagjinatës së një personazhi, në botën e tejbrendshme të një të riu, duke na dhënë një karakter të fuqishëm dhe njërin nga personazhet më të arrira që deri më sot ka prodhuar letërsia e përbotshme. Hyrja në thellësinë shpirtërore dhe në imagjinatën e një të riu është njëri nga aspektet më qenësore të teknikës së rrëfimit që në teoritë letrare tashmë njihet si *përroi i ndërgjegjes*.

Stefan Dedulasi është i rritur në një ambient konservator, në një familje tradicionale irlandeze, me një nënë që është besimtare e devotshme dhe me një baba respektues të tejskajshëm të normave shoqërore. Nëna dhe babai kanë të vetmin synim për ta rritur dhe edukuar të birin



sipas një projekcioni të normëzuar shoqëror, në këtë rast irlandez. Ata e dërgojnë në një shkollë me një orientim të dukshëm fetar, gjegjësisht katolik të vendit të tyre. I riu Stefan merr mësim të mira nga kjo shkollë, por nuk mund t’i përballojë dot ngurtësimet normative që i aplikon kjo shkollë dhe profesorët e tij. Ai është një tip skofiar, i dhënë pas artit dhe mendimit, që nuk mund ta përballojë as mënyrën se si funksionojnë bashkëmoshatarët e tij, të cilët lidhën mes vete përmes klisheve dhe lojërave tashmë të mirëmesuara, që kanë një peshë për orientimin në kohë dhe hapësirë në vendin ku


ata dhe Dedulasi i ri shkollohen dhe jetojnë. Ai nuk mund ta durojë këtë “rregullësi” të mirëqenë dhe shpeshherë pëson nga shokët dhe profesorët për shkak se është ndryshe dhe dëshiron të jetojë ndryshe. Stefan Dedulasin nuk e tërheq zbatimi i “parimësisë” së pranuar botërisht, por mendimi, pyetjet dhe dilemat rreth saj. Ai më shumë i dëshiron pyetjen, psetë e panumërta se sa përgjigjet e pakta dhe të shkurtra. Duke qenë i tillë, i ndryshëm prej të tjerëve, shokët synojnë ta poshtërojnë, ta fyejnë dhe ta nxjerrin keq para botës. Zaten, ky është fati i njerëzve të ndryshëm në një shoqëri uniforme.

Një nga dilemat që Stefan Dedulasi në moshën e tij rinore është ai për religjionin, për mënyrën se si funksionon dhe se si i trajton gjërat. Ai flet zëshëm dhe diskuton me bashkëmoshatarët për mënyrën se si religjioni, gjegjësisht kisha katolike irlandeze. Diskuton vazhdimisht për mënyrën se si e trajton mëkatën, të mirën, të drejtën, të ndershtmen dhe të bukurën në art dhe natyrë. Dedulasi i ri është një shpirt artisti, një krijues arti, dhe vazhdimisht i shtron për bisedë këto çështje që janë probleme të estetikës dhe filozofisë, por duke qenë në një koleg me natyrë religjioze i përflet prej një pikëvështrimi se si kisha dhe kleri i trajton aspektet e tilla që lidhën me artin. Ai dëshiron ta dijë psenë e një trajtimi të tillë nga ana e kishës për çështjet e tilla. Në bisedat diturore që i bën me moshatarë, profesorë dhe klerikë, ai gjithnjë shfaq një dyshim për mënyrën e interpretimit tradicional dhe konservator të artit, duke synuar që gjithnjë të ikë nga një mendësi e tillë që ka kufizime në qasje dhe ide.

Një aspekt mjaft i rëndësishëm, ndoshta edhe më i rëndësishmi në këtë roman, është shkuarja e Dedulasit të ri me prostituta të qytetit të tij. Për shkollën, kishën dhe klerin, një gjë e tillë ishte tejet e papranueshme dhe burim i shumë fatkeqësive në jetën e një të riu, që për këta të fundit, duhet të edukohet mbi bazën e normave që dërgojnë në moslejimin e një raporti të pavirtytshëm, gjegjësisht të pamoralshëm, në mes të një burri dhe të një gruaje. Stefani e sfidon veten dhe njohjen e tij të deritashme pikërisht duke ngarendur pas prostitutave, gjë që i bëhet shprehi dhe përkundër pendimit, prapë nuk mund të ndalojë veten drejt trupit dhe hireve femërore të një gruaje. Është pikërisht marrëdhënia seksuale që bëhet një shkas që ia ndryshon botëkonceptimin e tij për shumë gjëra dhe shumë norma të tabuizuar, në të cilat besonte ai, duke e ndërtuar jetën dhe mënyrën e veprimit dhe gjallimit sipas tyre. Pra, trupi i një gruaje përpos që e josh, ia sfidon, ia vë në krizë mendimin dhe besimin e deritashëm. Në këtë aspekt, gruaja këtu na shfaqet si një shënjeshtë më i fuqishëm se sa kleri dhe mësimet kishtare, që edhe pas shumë viteve shkollore dhe udhëzuese, nuk mund ta kenë ndikimin aq të shpejtë dhe aq të fuqishëm se sa marrëdhënia e dy trupave, e dy të rinjve të gjinive të ndryshme, që deri në atë kohë as nuk janë njohur mes vete.

Romani përfundon me ikjen e Stefan Dedulasit në një tokë dhe në një ambient tjetër, ku shpreson se do ta mirëkuptojnë shkaku i ndryshimësisë së tij në raport me të tjerët dhe bashkëmoshatarët e tij. Kjo ikje është më shumë si një rebelim i një riu ndaj normave, shkollës, kishës dhe klerit, politikës dhe botëkuptimësisë nacionale irlandeze, që të vërtetat i ka të gatshme dhe nuk pranon dilemë, pyetje e diskutim për to. Ikja e tij mund të lexohet edhe si një shenjë guximi rinor për ta braktisur njëmendësinë, për të gjetur shtigje dhe mundësi të reja për zhvillimin e vetes dhe mendimeve që nuk gjenin pranueshmëri në ambientin e mëparshëm.

“Portreti i artistit në rini” është mirë të lexohet sa herë që në gjuhën tonë shqipe mund të dalë një botim i ri, për shkak se çdoherë mund të mësojmë më shumë prej tij, duke qenë se kemi të bëjmë me një vepër të madhe, përpos në planin artistik, po ashtu edhe në atë mendimtar. Është një vepër që pa hezitim mund ta cilësojmë si një roman për rininë, artin dhe dijen. “Portreti...” është një roman që na bën të mendojmë dhe të pyesim se deri në çfarë shkallë mund dhe duhet ta sfidojmë njëmendësinë.



“Dhe pastaj ajo u bë pemë” është një roman nga autori Loer Kume, i cili trazon mendimet dhe ndjesitë e lexuesit. Një roman që nis me një epilog dhe ku na zbulohet fundi tragjik i personazhit kryesor apo heroinës së tij sikurse përcaktohet nga rrëfimtari. Lexuesi duke u njohur me fatin e heroinës së romanit, me vdekjen e saj “*Marta vdes në një skutë të botës të quajtur Shqipëri...*”, i lind kureshtja për të zbuluar se cilat ishin arsyet dhe rrugët që e çuan Martën drejt këtij fundi tragjik, por edhe për të kuptuar në kishte ndonjë moment kur ajo mund të shpëtonte.

Rrëfyesi, fillimisht një rrëfyes i gjithditur që më vonë kthehet në një nga perzonazhet që di po aq sa lexuesi, ndoshta më pak, na siguron se Marta nuk është një grua e zakonshme. Marta është ndryshe. Një grua me energji të pashtershme, guxim, intelekt, pasione e ëndrra për të pushtuar skenat botërore.

Rrëfyesi e lëviz rrëfimin e tij në kohë të ndryshme duke na e shfaqur Martën kur ajo thajse nuk ekzistonte fare, te Marta foshnjë, Marta fëmijë, Marta adoleshente, Marta grua, Marta bashkëshorte dhe Marta nënë. Përkrah Martës vendosen edhe disa personazhe të tjerë, të cilëve po ashtu rrëfyesi u zbërthen gjenealogjinë, spiritualitetin dhe mentalitetin si për të thënë që Marta është edhe pak si ata që vërtiten rreth saj. Në fund të fundit, njeriu merr sjellje, besime, mendësi nga ata me të cilët jeton. Njeriun e krijojnë, e rrit shoqëria, edhe Martën pa dyshim.

Mirëpo, Marta, kjo Marta diellore, Marta e rrëfyesit ballafaqohet gjatë jetës së saj me një krijesë që i frikësohen të gjithë, me atë që njëherë në jetë e takojnë të gjithë, vdekjen. Marta sheh një ëndërr ku një krijesë shumëkëmbëshe, neveritëse synon t'i gllabërojë gjoksin. Kjo ëndërr shndërrohet për Martën në një makth. Ky makth e përndjek çdo natë duke i lënë në lëkurë frikë dhe neveri.

“Ai sheh Martën në sy, përmes buzëqeshjes me gojë hapur del një gjuhë e vogël e verdhë, lëpin buzët ngadalë, qimet e hirta shkëlqejnë nën fashën e diellit, balli i mbushur me mijëra zgjatime shkëlqyese bulëzash djerse, sumbulla ftohtësie.”

“Gjendet tani në fytyrë të Martës dhe, gjithmonë duke kulluar e qeshur, zgjat duart drejt fytyrës së saj. Marta ia kap duart, ndjen ftohtësinë e krahëve të tij, dhe kupton që ai nuk ka erë. Asnjë aromë. Asnjë nxehtësi njerëzore.”

“Gafi i shtrëngon fytyrën, ndërsa me dorën e tij si tullë i prek gjirin e majtë. Marta ndjen ftohtësinë e llahtarshme të dorës që i shtrëngon gjirin.”

Me nxitjen e të shoqit, Martit, Marta kryen një vizitë mjekësore dhe zbulon se Gafuri, siç ajo quan shumëkëmbëshin e makthit të saj i ka lënë një plagë të hapur, serioze, e cila rrezikon t'i marrë jetën (diagnostifikohet me kancer). Qysh nga momenti që Marta diagnostifikohet me kancer duket se gjithë bota e saj shpirtërore merr të tatëpjetën. Ajo nis të presë të gjithë njerëzit me të cilët rrethohet, një e nga një duke u shkëputur nga të gjitha marrëdhëniet sociale dhe njerëzore. Ndërsa, ai, Gafurri herë duket e herë zhduket nga jeta e Martës.

Ky Gafur që i kërcënon ekzistencën, që paraqitet me një simbolikë të dyfishtë, herë është sëmundje, një flamë e trashëguar dhe herë të tjera mishëzohet

Mbi romanin “Dhe pastaj ajo u bë pemë” nga Loer Kume, Martën dhe esencialen

Nga Anxhela Pashaj

në formën e një burri të fuqishëm e brutal që përkthehet përsëri në kërcënim, vdekje e kthen Martën kah mendimi se si dhe çfarë kuptimi ka jeta, e kthen tek ekzistenca, te e përjetshmja, esencialja. Këto gjejnë vend në kokën e Martës dhe e shtynë të nis një udhëtim sa fizik po aq edhe shpirtëror. Ajo e nis këtë udhëtim shpirtëror me mbërritjen në ishullin e Lesbosit, ku sipas udhëzimeve të dy mentorëve, udhëheqësve të saj shpirtëror ajo mëson të jetojë me pak, duke e kufizuar veten fizikisht, por duke u hapur mendërisht dhe shpirtërisht.

Çuditërisht, sa më shumë që Marta e kufizon veten fizikisht dhe forcon anën mendore e shpirtërore aq më shumë njihet me anën brutale të njeriut të së shkuarës. Vrasje, barbarizma, përdhunime, thyerje psikologjike, arratisje, mbijetesë janë gjithë çka vjen nga e shkuara, nga e shkuara e familjes së saj, nga e shkuara e popullit të saj, nga e shkuara e njerëzimit.

Në Lesbosin e Safos, ku narratori na

sugjestionon për ekzistencën e një ane tjetër seksuale të Martës, ajo zbulon përmes disa seancave spirituale se Gafuri ka qenë me të qysh në gjenet e trashëguara nga gjyshja e saj, Arta. Arta është mbatësja e parë e Gafurit, gafurit që kall tmerr, frikë, që përdhunon, që vret e mbjell vdekje kudo. Gafuri nuk ka kombësi, ai është një krijesë e kudogjendur, e neveritshme, të cilin Marta synon ta mposhtë. Duke mposhtur Gafurin Marta mund të arrijë çlirimin nga e shkuara e të tjerëve, që pa dashjen e saj është bërë edhe e shkuara dhe e tashmja për të.

Pas disa muajsh larg familjes së saj dhe e izoluar nga çdo frymë njerëzore, Marta e sheh veten të shpëtuar nga thonjtë e Gafurit dhe të mbushur me dëshirën e madhe për t'u kthyer pranë djalit dhe bashkëshortit të saj.

Rrugës së kthimit Marta piqet me dhunën, të cilën shoqëria njerëzore e ka të trashëguar brez pas brezi, një

befasi që e nxit Martën të veprojë në të njëjtën mënyrë që kanë vepruar të gjitha pararendëset e saja, me dhunë, me thirrje e britma revolte. Marta arrin të shpëtojë viktimën, një grua tjetër, nga duart e dhunuesit, dhunueve dhe për fatin e saj të keq, tragjik, të humbasë mundësinë për të jetuar një jetë më të bukur pranë të dashurve të saj.

Akti i saj heroik i kushton jetën. Ah, heroizmi! A mund të jetë një grua heroinë? A mund të jetë një grua heroinë dhe të jetojë si e tillë? Cila ishte esenca e jetës së Martës? A thua klithma për shpëtimin nga duart e dhunuesit? Çfarë është esenciale në jetën tonë, në jetën e një gruaje? Ç'kuptim ka përjetësia për njeriun, për burrin, për gruan?

Pas gjithë udhëtimit të saj shpirtëror në Lesbos, odisesë së saj nëpër ujërat joniane, përpëlitjeve të fundit të shpirtit të saj në barkun e “Papias”, Marta rikthehet në Itakën e saj pranë Telemakut të saj ku gjen paqe të përjetëshme duke u shndërruar në një pemë. Shndërrimi i saj në pemë, metaforikë, larg metamorfozave të rrëfyera te Ovidi, por edhe në mitet e largëta, duket se sugjestionon për lexuesin nisjen e një jete të re për Martën, në një formë tjetër, e cila është më esenciale, më e përjetëshme ku ajo, sikurse energjia ndryshon formë, por nuk humbet, mbetet përjetësisht mes nesh.


Përveç Martës, çka të mbetet në mendje nga ky rrëfim është lëvizja narrative, se si rrëfimi përthyeret mes të shkuarës dhe të tashmes, të cilat rrotullohen përkrah njëra tjetrës sikurse zinxhiri i ADN-së duke e ruajtur materialin gjenetik dhe duke e përcjellë në momentin pasardhës të rrëfimit. Frazat herë është e thjeshtë, herë zgjatet dhe përumbet me hollësi mbi mendimet, ndjenjat dhe mijëra momente të jetës së një njeriu, këto të fundit shpesh herë marrin një vrull për të arritur në finish, sikur të mos jenë edhe aq të rëndësishme.

“Ankth sikur qielli të bie e të shtyp. Të merr frymën. S'ka ajër. Do heqim urinë, feçe, formulë gjaku, elektrolite, mikroelemente, markatorë, EEG të trurit, një herë, dy, shumë herë, pagjumësi, kthime, rrotullime, pritje, pritje në korridore, bardhësi e ankthshme, heshtje e bardhë.”

Regjistri gjuhësor me të cilin flasin personazhet e rrëfimit është një përzierje e një shqipeje artificiale, sikurse ka në këtë rrëfim disa personazhe artificialë, anglishtes si një lingua franca, por edhe si shfaqje snobiste, po ashtu vihet re edhe përdorimi i zhargonit dhe fjalëve banale, këto të fundit në disa raste dhe situata specifike duke u legjetimuar, fjala vjen në çdo raport intim ku qartazi instiktet kafshërore dalin mbi njeriun e kornizuar nga morali, edukimi etj. pluskojnë fjalë që në traditën letrare shqiptare dhe të huaj narratori shprehej “fjalë që nuk i shkruan dot kalemi” duke ia lënë lexuesit të hamendësonte, hamendësojë ende edhe sot se çfarë mund të ishin ato fjalë.

Mbi këtë roman do të mund të shtoj se, duke mbajtur Martën, një figurë femërore në qendër të tij dhe peripetitë e saj në një realitet të infektuar nga dhuna, maskilizmi, pështirosja nga tjetri në gjini, ngjyrë, besim, mendim përmban mjaft nuanca humanizmi, por edhe feminizmi, një feminizmi të ftohtë, cerebral pa klithma për vëmendje, i cili i shkon për shtat natyrës rrëfimore dhe kompleksitetit femëror të Martës.





SKËNDER BUÇPAPAJ

hënisti dhe kitaristi

Poemë

Ti i bie kitarrës. I bie kitarrës,
Kitarrës, kitarrës së fundit të një dimri besëprerë.
Unë hënës, hënës, hënës
Së fundit të një vere të vesuar.

Kili, druvar i Nerudës, fle me fytyrë nga Paqësori,
E nuk zgjohet, e fle me të dyja duart të bëra nënkresë.
E fle me shpinë nga kontinenti, nga poli në pol, kontinenti
Krokodil me këmbët dhe kokën përjetë në akullanajat.

Natë, mos eja natë mbi Santiago.
Ku nxitojnë tingujt e kitarrës, atje vonojnë yjet.
Ku zënë vend tingujt e hënës nuk ka vend
Për yjet. Yje, vononi, yje. Tinguj, nxitoni, tinguj.

Pinoçetëve hapat iu rendin përpara, (sa shëmti!) mbrapsht
Iu rendin fytyrat e tyre, të pasme shimpanzesh të argasura.
Mbrapsht (sa bukur!) fluturimet zogjve kolibër Amerikës së
Jugut
Iu rendin për t'u ulur në telat e kitarrës sonë, telat e hënës
sonë.

Kalldrëmët e gjakut valviten më bukur
Më kuq se valviten çatitë, se valviten sheshet,
Se valviten shkollat, se valviten turmat lirivrra
Të mbyllura me dry në stadiumet e Kilit.

Kokë sfinksi e pranishme kjo hënë, me veten e vet nën
sqetull.
Trup sfinksi i munguar ky qiell, me veten e vet në krahë.
Dru-rurum. Dru-rurum. Dru-rurum. Mungo, qiell. Mungo.
Mos pusho, hënë. Mos pusho. Drum. Drum. Drum.

*

Kili, kërcim i palakuar, kërcim i qashtër delfini,
Meridian thatim i flegruar pabesisht nga paralelet..
Ndanë kontinentit me Paqësorin varur në qafë thes të
shpresave
Me Atlantikun varur në kurriz kumbonë të fateve.

Klithmë shqerre kjo hënë e zënë e pazënë natasдите, shqyer
Nga këngë gjelash, mbytur me përsëritje në të gjithë
bunarët.

Shqerre të mbetur në fyt ujkone natasдите verasdimri të
Tplânit.
Shqerre të mbetur në fyt ditasnate dimërasvere të
Santjagos.

Hënë e lakuar përvëluese, hënë e bërë me kompasë lotësh,
E pangrënë e sapongrënë me lëkurë e bërthamë,
Mollë e pakafshuar në fyt të Adamit të pamësuar
Me mollë. Hënë e thënë e Tplânit, e pathënë e Santjagos.

Me mollë të pakafshuar në fyt Adam është globi.
Le t'i bëjë dritë vetes errësira e fanitur nga dheu.
Taranten. Taranten. Taranten. Mungo, qiell. Qiell.
Mos pusho, kitarre. Kitarre. Ten. Ten.

Trëndafilët e lëkuqmë qëllojnë me aromë të bardhë
zambakësh
Të gjithë mungesën e yjve, të gjitha mungesat e yjve.
Yjet e munguar, si kokrra breshëri iu ngjiten, iu ngjiten,
Iu ngjiten të gjitha xhameve.

Salvador Alende mos na e lësho kitarren duarsh.
Hëna jonë çan borën e kaltër rrëheve të qiellit,
Sikur malësorja kiliane rrëheve të Patagonisë
Çan borën e rripit të zjarrtë.

Tingujt e kitarrës s'ka sqep korbi që i krrok.
Tingujt e hënës s'ka gushë pëllumbi që i gugat.
Kësaj natasдите të Tplânit, ditasnate të Santjagos
Yje, trusuni, yje. Tingujt, ngutuni, tinguj.

Si çdo vonesë që vetiu shndërrohet në mungesë,
Atëherë ylberët nuk iu kanë frikë njerëzve.
Si çdo vonesë që vetiu shndërrohet në mungesë
Atëherë njerëzit ua kanë frikën ylberëve.

Atëherë bubullimat iu paraprijnë vetëtimave.
Atëherë vetëtimat iu shkojnë pas bubullimave.
Atëherë vetëtimat nuk kanë frikë nga bubullimat.
Atëherë bubullimat kanë frikë nga vetëtimat.

Korale që ëndërrojnë për bletë.
Bletë që ëndërrojnë hoje mjalti koralesh.
Gishtërinjë e mi krongjij të akullt në të dyja
Anët e saj luajnë hënën këtë natasдите shtatori.

Lindja në jetën e njeriut është më e paharrueshmja.
Aq sa është vdekja më e dashura në jetën e njeriut.
Sa shumë vapë. Dhe sa shumë terr.
Sa shumë terr. Dhe sa shumë vapë.

Jargavan Rajnahu që i çel në prill lulet, në maj gjetthet.
Qie ll cinxërash krrokatës livadhesh.
Nëpër to nëse nuk i veson, nuk çelin yjet.
Nëse nuk i yjëzon, nuk bie vesa.

Syth hardhie i paçelur, lot sythi hardhie i papikuar.
Meqë dielli nuk bëhet hënë, hëna le të bëhet diell.
Trupa me jetë vijnë, lënë kudo trupa të pajetë
Rrugëve të përgjakura të Santjagos.

*

I bie hënës me flokët e buta të krojeve.
Me flokët e ngatërruar nëpër pisha të ujvarave.
Me flokët e krehur të gurrave. Me vonesë vese
I bie, me mungesë yjesh.

Salvador Dali ta harrojmë datën tonë të vdekjes.
Ta harrojmë për hir të datës sonë të lindjes.
Kur të lindim sërish nuk do të vijmë nga barku i hënës.
Do të vijmë drejt e nga barku i kitarrës.

*

Ujkonjë shtatori me shqerrë prilli në fyt kjo ditasnatë e
Santjagos.
Me shqerrë prilli në fyt ujkonjë shtatori kjo natasdtë e
Tplanit.
Meqë kitarra nuk bëhet hënë, le të bëhet kitarre hëna.
Yje, vesoni, yje. Tinguj, yjsoni, tinguj.

Presidenti i Kilit e çan me plumb pushke zemrën e vet.
Gjaku i tij gurgullon, gurgullon në zemrën e kombit.
Tanket e grushtshtetit vënë muret nën zinxhirë.
Flakët dhe tymin i ka për çati Santjagoja.

Kush ia luan bukur kitarrës telat, ia luan bukur telat hënës.
Kitarrë qyteti dhe bote. Hënë fshati dhe bote.
Atëherë hëna këndon me zë trimëror kitarre.
Atëherë kitarra këndon me zë baritor hëne.

Ku binin Kordilieret, bien Andet. Ku binin Andet, bien
Kordilieret.
Jehojnë me jehonë meridianesh paralelet. Me jehonë
paralelesh meridianet.
Tash bora e përjetshme nuk do që t'ia dijë për shirat e
përjetshëm.
As shirat e përjetshëm nuk duan t'ia dinë për borën e
përjetshme.

Me të dyja duart e mbaj në Santjago kitarren, e mbaj në
Tplá hënën.
Sa çel e mbyll dritare (irisë të zes vajtoresh) rërë xhami e
thërmon koha botën.
Mos pyet kurrë, mos pyet kurrsesi në jetën tonë sa shumë
na urryen.
Ne e dimë fort mirë, e dimë në jetën tonë sa shumë
dashuruam.

Kili, druvar i Nerudës, fle me fytyrë nga Paqësori,
E nuk zgjohet, e fle me të dyja duart të bëra nënkresë.
E fle me shpinë nga kontinenti, nga poli në pol, kontinenti
Krokodil me këmbët dhe kokën përjetë në akullanajat.

Hënë vendi. Hënë bote. Kitarre vendi dhe bote.
Gjysma hi dhe gjysma shkru mb sokakët e Santjagos.
Tulipanë të çarë mbijnë në sokakë zemrat ku ndalën turrin
plumbat.
Kitarrë vendi dhe bote. Hënë vendi. Hënë bote.

Tplá, shtator 1973 - Reinach, shtator 2023

(Nga libri “Zogu i bjeshtës i riu”, Onufri, 2024)



Langston Hughes

Shpëtimi

Përktheu nga anglishtja Kujtim Morina

Ushpëtova njëherë nga mëkati kur po shkoja në të trembëdhjetat. Por nuk është se u shpëtova vërtet. Ndodhi kështu. Ato ditë mbahej një meshë e madhe ringjalljeje në kishën Auntie Reed. Çdo natë për javë të tëra, kishte shumë predikime, këngë, lutje dhe britma dhe disa mëkatarë të thekur i ishin rikthyer përsëri Krishtit dhe anëtarësia në kishë ishte rritur shumë shpejt. Pastaj sapo përfundoi ringjallja, ata mbajtën një takim të veçantë për fëmijët “për t’i sjellë qingjat e vegjël në tufë”. Tezja ime më foli për këtë disa ditë më parë. Atë natë më çuan në rreshtin e parë dhe më vunë në stolin e përcjellësve të të vdekurit me të gjithë mëkatarët e tjerë të vegjël, që nuk ishin kthyer ende te Krishti.

Tezja më tha që kur të shpëtohem, do të shihja një dritë dhe diçka do të ndodhte brenda meje! Dhe Jezusi do të vinte në jetën time! Zoti do të qëndronte me mua nga ajo ditë e përgjithmonë! Ajo më tha se mund ta shihja, dëgjoja dhe ndieja Jezusin në shpirt. E besova. Kisha dëgjuar shumë njerëz të moshuar të thoshin të njëjtën gjë dhe më dukej se duhej ta dinin. Kështu që u ula qetësisht në kishën e ngjeshur dhe të zhurmshme duke pritur Jezusin të vinte tek unë.

Predikuesi bëri një predikim të mrekullueshëm ritmik, me të gjitha rënkimet, britmat dhe klithmat e vetmuara dhe pamjet e llahtarshme të ferrit dhe më pas këndoi një këngë rreth nëntëdhjetë e nëntë të sigurtë në tufë por një qingj i vogël kishte mbetur në të ftohtë. Pastaj ai tha: “A nuk do të vini? A nuk do të vini tek Jezusi? Qingja të vegjël, a nuk do të vini?” Dhe drejtoi krahët drej nesh, të gjithë mëkatarëve të vegjël në stolin e përcjellësve. Vajzat e vogla klithën. Disa prej tyre kërcyen dhe shkuan tek Jezusi menjëherë. Por shumica prej nesh po qëndronim aty.

Shumë të moshuar erdhën dhe na u ulën në gjunjë dhe po luteshin. Gra të moshuara me fytyra që iu shkëlqenin dhe flokë me gërsheta, burra me duar të plasaritura. Kori i kishës këndonte një këngë për dritat e ulëta që po digjeshin dhe për mëkatarë të mjerë që do të shpëtoheshin. E gjithë ndërtesa u tund me lutje dhe këngë.

Unë ende po prisja të shikoja Jezusin.

Më në fund, të gjithë të vegjlit kishin shkuar në altar dhe ishin shpëtuar përveç meje dhe një djali tjetër. Ai ishte një djalë rrumbullak që quhej Uestli. Uestli dhe unë u rrethuam nga motrat dhe xhakonët duke u lutur. Ishte shumë nxehtë në kishë dhe po bëhej vonë. Më në fund, Uestli më tha duke pëshpëritur: E marrtë dreqi! Jam lodhur i ulur këtu. Le të ngrihemi dhe shpëtohemi.” Kështu ai u ngrit dhe u shpëtua.

Pastaj mbeta vetëm unë në stolin e përcjellësve. Tezja erdhi dhe m’u ul në gjunjë duke britur ndërsa lutjet dhe këngët pështilleshin rreth meje në kishën e vogël. E gjithë grixha lutej vetëm për mua në një vajtim të fuqishëm zërash dhe rënkimesh. Unë qëndroja duke pritur gjakftohtë Jezusin, duke pritur e pritur por ai nuk po vinte. Doja ta shihja por asgjë nuk po ndodhte. Asgjë! Doja të më ndodhte diçka por asgjë nuk po vinte.

Dëgjova këngët dhe meshtarin të thoshte: “Përse nuk vjen? Fëmija im i dashur, përse nuk vjen tek Jezusi? Jezusi po të pret. Ai të do. Përse nuk vjen? Motër Rida, si e ka emrin fëmija?”

“Langston” dënosi tezja ime.

“Langston, përse nuk vjen? Përse nuk vjen dhe të shpëtohesh/ Oh, qinxhi i Zotit. Përse nuk vjen?”

Tani po bëhej vërtet vonë. Fillova të më vinte turp nga vetja, duke qëndruar ashtu për aq gjatë. Fillova të vras mendjen çfarë mendonte Zoti për Uestli, i cili e sigurtë që as ai s’e kishte parë Jezusin por që ishte ulur krenar tani në platformë, duke tundur këmbët e tij në kilota dhe duke u zgërdheshur me mua, që isha rrethuar nga xhakonët dhe gratë e moshuara në gjunjë duke u lutur. Zoti s’e kishte goditur Uestlin për vdekje për keqpërdorjen e emrit të tij apo për për të gënjerit në tempull. Kështu që vendosa që mbase për t’i shpëtuar ndonjë telashi tjetër, më mirë të gënjeja edhe unë, të thoja që Jezusi kishte ardhur, të ngrihesha dhe të shpëtohesha.

Kështu që u ngrita.

Papritur e gjitha dhoma shpërtheu në një det britmash kur më panë që u ngrita. Valë gëzimi pushtuan vendin. Gratë kërcyen përpjetë. Tezja më hodhi krahët. Meshtari më zgjati dorën dhe më çoi në platformë.

Kur gjërat u qetësuan, në një heshtje të papritur, ndërprerë nga disa ekstaza “Amin”, të gjithë qinxhat e vegjël u bekuan në emër të Zotit. Pastaj këngët e tyre të gëzueshme e mbushën dhomën.

Atë natë për herë të fundit në jetën time, veçse njëherë-sepse isha vetëm dymbëdhjetë vjeç, qava. Qava në krevat vetëm dhe nuk dija të ndaloja. Futa kokën mes jorganit por tezja më dëgjoi. Ajo u zgjua dhe i tregoi xhaxhait se unë po qaja sepse Fryma e Shenjtë kishte hyrë në jetën time dhe kisha parë Jezusin. Por unë po qaja në të vërtetë sepse s’kisha guxim t’i tregoja se kisha gënjer dhe i kisha mashtruar të gjithë në kishë, se unë nuk e kisha parë Jezusin dhe që tani nuk besoja më se kishte një Jezus meqë ai nuk erdhi për të më ndihmuar.

ARISTOTEL SPIRO

rreth nesh festonin

*Me duart nënkresë
dhe nënshtresë lëndinën e gjelbër
i ndërkumtojmë njëri-tjetrit
kundrimet e qiellit të virgjër.*

*Ta ndiej dihatjen e ngrohtë,
dhe pse në hemisferën e tejme të globit,*

*Rrotullohu pak dhe nga kjo hemisferë,
të ta përkëdhel trupin
me diminutivët më të bukur të duarve,
të kandesh me fonemat e mallit
e të drithërohesh me zanoret e kandjes,
tekta trupin ta përshkojnë
bashkëtingëlloret dridhëse
dhe të lëngëtat tek rrëshqasin
mbi lëkurën tënde të shndritshme.*

*Kështu i mblodhëm me të shpejtë
Gjithë mjetet që na dhuroi gjuha:
fonema, morfema, pjesë ligjërata
dhe përfunduam së bashku në një fjali dëshirore.
Në fund ndezëm fishekzjarre pasthirrmash.*

Gjithë fjalët e gjuhës festonin rreth nesh.



PRANVERA S'ËSHT ME SHKUE

Kur yll i jetës me u fikë deshi
Ti lule, lule e paemër, si prej Zoti erdhe
Dhe një shteg drite ende udhë me ba, e çele.

Erdhe,
Dhe këta dy sy, si prej loti të tharë,
Lumë që udhëton qiellit, sot i ke bërë.

Oh, lumë ,
Lumë që ngjall brigje që prej moti,
Në pluhur yjor janë shndërruar
Dhe me za e bimësi sërish i mbush.

Erdhe, si një za i ëmbël mjellme
Kur jep shpirt, sot erdhe.

Ti, ti që fundin e një udhëtimi
Në një botë prej hiresh të lashta
E këndimi, përsëri e ktheve.

Të falem, shumë të falem, Ty lule,
Që nga Pemë e Jetës sot erdhe,
Rrugë prej drite ende me ba me mue.

Oh, erdhe ,
Erdhe e tha: pranvera s'është me shkue
Po me shkruie e vetëm me shkruie.

(Prill 2024, 4 vjet pas daljes nga spitali)

ZANI

Tri rrëfime për një emër dikur
Erdhen e morën za, si prej deliri,
Në një hapësirë krejt të mbyllur.

Oh, za,
Za që si nga qiejt ra në një fushë
Dhe ngarendi ashtu gojë më gojë
Derisa koha i dha një ndëshkim.

E tash,
Tash kah fundi i një udhëtimi
E di, ai za i largët për ty në vogëli
Qenka bërë psherëtimë.

E, ndoshta,
Gjithë ç'është e bukur në këtë botë
Vjen një ditë e bëhet psherëtimë.

Prill 2025

.

PËR NJË LULE TË PAEMËR

Kur unë vij e due me hy
Ti gjithnjë ik nga ky kafaz
Drejt një hapësire të pafund.

Ik, si vetëtimë ik,
Dhe, tërë një botë pastaj vërtitet,
Rreth teje vërvitet pambarim..

Ti, ti je e vetme, vetmitare,
Ndërron botë, qiej, yje dhe sërish
Të paprekur të ruan një Zot i Mirë.

Ti, lule e paemër, apo ndoshta,
Dritë e parë, e lashtë, ndezuri,
Nganjëherë sikur vjen prej botëve
Që kurrë s'i kanë parë këta dy sy.

Ti vjen kur unë mbyll çdo portë,
Vjen, dhe sërish ik nga kjo botë,
Sepse një Zot jo dorëlibër e ka bërë
Aq shpejt e aq të papërkryer.

Po unë, unë as me ik nuk mundem,
Se, s'jam tjetër veçse një rastësi kohe,
Një rrëfim i mbyllur në një urnë.

Ndaj të lutem, shumë të lutem,
Munde frikën dhe eja edhe një herë
Me hy në këtë botë vdekatare
E me lënë pak afsh përjetësie.



DEMË TOPALLI

Një urdhër i lashtë

poezi

Ti, lule e paemër, dritë e parë,
Ndezuri, apo ndoshta, asgjë tjetër,
Veçse përfytyrim i një ëndrre të lashtë,
Që gjakon po s'mund të rrëfejë asnjëri.

Mars 2007

NJË URDHËR I LASHTË

Është një derë që çdo ditë çelet e mbyllet
Në çastin e njëjtë, pa asnjë trokëllimë.

Është hapi i parë, çasti i parë, gjithnjë i parë
Nëpër një rrugë të shkurt me pesa lakesa
Deri te një pikë e ngrirë, në Elidë.

Gjithnjë e parë është hyrja në këtë botë,
Sepse të tjerat koha tashmë i ka marrë,
I ka marrë e pluhur yjor i ka bërë.

Po, krejt çfarë ka mbetur nga kjo rrugë
S'është gjë tjetër pos një urdhër hyjnor
Me shkruie e me shkue.

Oh, një urdhër i lashtë sa bota,
I lashtë e, ndoshta dhe mizor.

Dhjetor 2005

TUNDIMI I PARË

Një fjalë, një tundim,
Pastaj një mijë tundime
Të ndryra brenda fjalësh.

Ky ka qenë tundimi yt i parë
Nëpër të cilin fijet e kohës
Një Zot mugëtire endur i ka.

Pastaj dorën e vet të fshehur
Mbi gjithëçka tënden, e ka vënë.

E ka vënë
Dhe me një terrin të pafund nate
Hapësirën fort të ngushtë, ta ka zënë.

Ke dalë,
Si nga ajo shpellë e Platonit
Pas një mijë vjetësh ke dalë.

Ke dalë,
Po ndoshta ajo errësirë
Sytë, sytë që dinë me pa,
Përgjithmonë, nuk t'i ka marrë.

Gusht 2001

DHEMBJA IME E PARË

Ke dalë nga gjeografi e lashtë sa bota
Një mijë përmytje palë-palë deri në qiell
Që Fisin përgjithmonë ta mbulojë harrimi.

Zbrita nëpër të gjitha greminat e tua
Një mijë ishin, Fisi im.

Shfletova të tërin librin e botës
Vetëm ti qenke mister i mistereve
Që gjithmonë rilind nga hiri yt i gjallë

Oh, si të dalë nga dhembja ime e parë
E ta sjellë këtu atë Haber të Mirë
Gëzimin e madh të Fisit.

Janar 1988

E KREMTE E MBARË

Do të bartësh vetmi mali
Sëmundje kohësh lemeri
Deri tek e Kremte e Mbarë.

Nëpër përralla mashtrimi
Helm gjarpri do të pish
Deri tek e Kremte e Mbarë.

Oh, Fisi im, e di,
Krejt do të lehin kundër teje
Derisa të han gjithë thesarin tënd
Deri tek e Kremte e Mbarë.

1982

KËSHTU ISHTE MOT E ZEMAN

Një mijë herë ke për të vdekur
Deri tek e Kremte e Mbarë
Se kështu ishte mot e zeman.

Geografi e re në hartën e vjetër
Dije, do të jetë plot zaptije
Se kështu ishte mot e zeman.

Lulja nuk çel në ujin e zi
Dalë nga ajo çizme mbreti
Se kështu ishte mot e zeman.

Po kur thërret zë i lashtë Dovleti
Dil, se kështu ishte mot e zeman.

Korrik 1988

ZGJIMI IM NË KËTË VJESHTË


Një ditë që perëndoi dhe e la
Një ëndërr të ndryrë përjetë
Është zgjimi im në këtë vjeshtë.

Krijesa më e bukur e një nate
Që kurrë s' munda ta ktheja në dritë
Është zgjimi im në këtë vjeshtë.

Spitali i bardhë dhe i ftohtë
Ku sa e sa herë shtrihem si kufomë
Është zgjimi im në këtë vjeshtë.

Ky qytet, këto lëvizje, një mister
Pëgjithmonë i pazbuluar
Janë zgjimi im në këtë vjeshtë.

Tetor 1969



Karikaturë nga Arben Mexsi

JAM AKUZUAR SE MERREM SHUMË ME TË SHKUARËN

jam akuzuar se merrem shumë me të shkuarën
sikur ta kisha krijuar unë
sikur ta kisha skalitur unë
me duart e mia. por s'bëra asgjë.
e shkuara më priste
kur erdha në jetë
një foshnjë e tmerrshme pa emër
nëna ime me lëkurë të acaruar
që kruhej
e ngjeshi atë në gjoks
dhe i vuri emrin
histori.
ajo është bërë më njerëzore tani
mëson gjuhët çdo ditë
duke sjellë nëpër mend fytyrat, emrat, datat.
dhe kur të jetë gati për të udhëtuar vetë
pa ndihmën e askujt, mbani vesh,
ajo do ta bëjë.

ATO KOHË TË MIRA

babai ka paguar qiranë
dhe nëpunësi i sigurimeve ka shkuar
dhe dritat janë ndezur përsëri
xhaxhai ka goditur me grusht
për një dollar, pa u menduar
ç>kohë të mira ishin ato
ç>kohë të mira
ç>kohë!

nëna e ka bërë bukën vetë
gjyshi ka hyrë në shtëpi
dhe të gjithë janë dehur
dhe kanë kërcyer në kuzhinë
dhe kanë kërcyer në kuzhinë
ç>kohë të mira ishin ato
ç>kohë të mira
ç>kohë!

fëmijë, mos i harroni
ato kohë të mira
ato kohë!

ADAMI MENDON

ajo
vjedhur nga kocka ime
është diçka e çuditshme
që më bën të kthehem
dëshpërimisht brenda vetes
të lidh brinjën me argjilën
të bëhem i plotë përsëri

është një ngut e një mund i vështirë
ulërij
dhe përmes gojës sime
del një emër
ky krijim është kaq i egër
sa më mirë të lind sërish

POEZI PËR BEBEN QË HUMBA

ishte koha kur thuaje e leshova trupin tend
poshte
per t'iu bashkuar ujërave që rridhnin fund-
honeve të qytetit
për të vërshuar me ujërat e zeza në det
çfarë dija unë për ujërat që kthehen përsëri
çfarë dija unë për mbytjen
apo për çastin kur je duke u mbytur?
mund të kishe lindur në dimër
në vitin kur na ishte ndërprerë gazi
kur s'kishim makinë
mund të kishim ecur një copë rrugë bashkë
mbi kodrën genecy nën erërat e kanadasë
mund të kisha lënë të bije në duart e një të
huaji
veç po të kisha këtu do t'i thoja këto
dhe disa gjëra të tjera, sigurisht

dhe nëse ndonjëherë jam më pak se një mal
për vëllezërit dhe motrat e tua që kanë
mbetur gjallë
lumenjtë le të më mbulojnë kokën
deti le të më marrë mes rrjedhave që vijnë
nga qyteti
le të më quajnë gjithmonë të huaj njerëzit
me ngjyrë
për shkakun tënd që s'gëzove dot një emër.

Lucille Clifton
brenda meje është
një vajzë

Përktheu nga origjinali
Roland Gjoza



TRËNDAFILI I XHORXHIAS

kur të shoh
mbështjellë si një thes me mbeturina
ulur, rrethuar nga duhma
e lëkurëve të kalbura të patateve
apo kur të shoh
me këpucët e atit tënd plak
me gishtin e vogël të prerë
që të ka dalë jashtë
ulur atje, duke pritur
ç>mund të pjellë mendja jote
për ushqimet e javës që vjen
unë them kur të shoh
çantën e lagur ngjyrë kafe të një gruaje
që dikur ishte vajza më e bukur e xhorxhias
dhe të gjithë e thërrisnin trëndafili i xhorx-
hias
unë ngrihem në këmbë
përmes shkatërrimit tënd
unë ngrihem në këmbë

KËRKUESI I VIZIONEVE

çfarë do të thotë
të shohësh njerëz duke ecur
shenjuar me ngjyrën e vdekjes,
të dëgjosh nga goja e tyre
rrokje kaq të tmerrshme?
janë ata shpirtë
të shpresës sonë
apo fantazma të zbehta të së ardhmes sonë?
kush beson në rrugën e kuqe
a nuk do të eci në të përgjithmonë?
kush beson
se popujt e akujve do të jetojnë
ndërsa ne kemi vdekur me kohë?

HOMAZH PËR KOFSHËT E MIA

këto kofshë janë kofshë të mëdha
ato duan vend për të lëvizur
sa andej- kënde
ato nuk duan të dobësohen
për t'u futur kollaj
në dyer të ngushta. Këto kofshë
janë kofshë të lira
këto kofshë nuk duan t'i bëhen barrë askujt
këto kofshë kurrë nuk u skllavëruan
ato shkuan ku ua donte qejfi
ato bënë çfarë t'u shkrepej
këto kofshë janë kofshë të mëdha
këto kofshë janë kofshë magjike
dhe ua kam bërë të qartë
çfarë përgjigje t'i japin një burri
si ta sjellin atë rrotull si fugë.

BRENDA MEJE ËSHTË NJË VAJZË

brenda meje është një vajzë
e egër si një ujkonjë
nuk largohet nga këto kocka
të një gruaje të moshuar.
ajo është një pemë e gjelbër në një pyll me
shkarpa
ajo është një vajzë greke e një poeteje që ka
zënë shtratin.
ajo ka pritur me durim si një murgeshë
ardhjen e dytë
kur mund të shpërthente në flokët gri
një lulëzim i ri.
dhe dashnorët e saj do të korrin e vjelin
trumzë dhe mjalhtë
dhe pyjet do të bëhen të egër përsëri
me mrekullinë e mallkuar të saj.

NUK DO TË FESTOSH ME MUA?

nuk do të festosh me mua?
për atë që kam arritur
në këtë jetë? nuk kam patur asnjë model.
e lindur në babiloni
femër, por jo e bardhë si ty.
ç>mund të isha përveç vetes sime?
e shpika
në këtë urë këtu
midis yjeve shkëlqimtarë dhe baltës që nxin
njëra dorë më shtrëngon fort
tjetra ty të fton; eja të festosh këtë ditë të
gëzuar
me mua përgjithmonë.
dikush ka dashur të më vrasë
por ka dështuar.

POEZI PËR MITRËN TIME

mitra ime
e duruara
si një çorape
brenda teje kanë rrëshqitur
fëmijët e mi të gjallë dhe të vdekur
tani
ata i kanë prerë lidhjet me ty
çorapja nuk duhet
jam vajzë e vjetër
pa ty
mitër
gjurma ime e gjakut
kuzhina ime me estrogen
çanta ime e zezë e dëshirës
ku mund të shkoj
zbathur
pa ty
ku mund të shkosh
ti
pa mua?

AJO DUHET TË MË KUPTOJË

gjak dhe shkatërrim
gjak dhe shkatërrim, ajo gjëja e qulltë
bie nga kafazi dhe lëshon britmën e parë
në dritë, të dyja ulërijnë
kafsha dhe kafazi. shufrat prej hekuri janë të
hapura, të shqyera
gjithçka është e zbrazët, ajo e krijon veten
sërish
jashtë mishit, jashtë fjalorëve
ajo gjithmonë zbrazet dhe kaq është e gjitha
e njejta plagë, i njëjti gjak, i njëjti shkatër-
rim.

MISISIPI DERRDHET NË GJI

dhe gjiri hyn në det dhe kështu ndodh
asnjë prej tyre nuk sjell të njëjtën gjë
ata që dje mbanin perjetësisht mbi shpinë
valë e suvalë me shkulme buëmtare
nesër do të kthehen e do të shkojnë përpara.
është qarkullimi i madh
i lëngjeve të tokës, si gjak
perëndie, kështu dhe ky lumë ku e shkuara
është në vërshim gjithmonë. të gjithë ujërat
kanë të njëjtin ujë që bën rrethrotullimin
e vet.
dhe çdo ditë dikush qëndron në buzë të
humnerës
me shikimin zhytur në kohë
duke pëshpëritur gabimisht;
vetëm këtu. vetëm tani.

TËRBIMI

(mamasë)

kjo s'duhet harruar
ajo qëndron pranë
stufës.
qymyri
shkëlqen si rubin
dora e saj po qan
dora e saj shtrëngon
një tufë letrash
me poezi
ajo i flak në stufë
ato digjen
bizhu mbi bizhu
sytë e saj janë kafshë
çdo fije floku
...

Pamfletet e Tolstoit janë pjesa më pak e njohur e veprës së tij dhe sulmi ndaj Shekspirit* nuk është një i lehtë me të cilin përballesh, sidomos kur e kemi në variantin e përkthyer në anglisht. Prandaj, ndoshta është e dobishme të bëj një përmbledhje të pamfletit përpara se të përpiqem ta shqyrtoj.

Tolstoi fillon duke thënë se gjatë gjithë jetës Shekspiri ka ngjallur tek ai “një ndjenjë të papërballueshme neverie dhe bezdi”. I vetëdijshëm se mendimi i përgjithshëm i botës së qytetëruar është kundër, ai ka bërë përpjekje të pareshtura për t’i njohur sa më mirë veprat e Shekspirit, duke i lexuar dhe rilexuar në rusisht, anglisht dhe gjermanisht; por “Përjetova në mënyrë të pandryshueshme të njëjtat ndjenja; neveri, monotoni dhe çoroditje”. “Tani, në moshën shtatëdhjetë e pesë vjeçare, i kam rilexuar edhe një herë të gjitha veprat e Shekspirit, duke përfshirë edhe dramat historike, dhe kam ndërje me forcë edhe më të madhe, të njëjtat ndjenja, por kësaj herë jo atë të çoroditjes, por bindjen e palëkundur se lavdia e padiskutueshme e një gjeniu të madh që ka fituar Shekspiri dhe që i detyron shkrimtarët e kohës sonë ta shkërbejnë (imitojnë), ndërsa lexuesit dhe spektatorët të zbulojnë tek ai merita që nuk ekzistojnë, duke shtrembëruar kësisoj kuptimin e tyre estetik dhe etik, është një e keqe e madhe, ashtu siç është çdo e pavërtetë.

Shekspiri, shton Tolstoi, jo vetëm që thjesht s’është gjeni, por ai s’është as “një autor mesatar”, dhe për të dëshmuar këtë ai analizon me sy kritik “Mbreti Lir”, dramë e cila, siç është në gjendje të tregojë ai me citate nga Hezlit,¹ Brandis² dhe të tjerë është vlerësuar në mënyrë të tepruar dhe mund të merret si shembull i veprës më të mirë të Shekspirit.

Tolstoi më pas bën një lloj paraqitjeje të subjektit të dramës “Mbreti Lir”, duke e parë në çdo hap si marrëzi, fjalëshumë, të panatyrshme, të pakuptueshme, me stil të fryrë, të rëndomtë, të mërziqshëm dhe me plot ngjarje të pabesueshme, “përcartje të tërbuara”, “shaka pa kripë” anakronizma, vogëlsira, pjesë të turpshme, me konvencione të konsumuara të skenës dhe gabime të tjera morale dhe estetike. Sido që të jetë puna, Liri është plagjiaturë e një drame më të hershme dhe shumë më të mirë, e “Mbreti Leir”, vepër e një autorit të panjohur, të cilën Shekspiri e vodhi dhe më pas e shkatërroi. Ia vlen të citojmë një paragraf si shembull që shembullzon (ilustron) mënyrën me të cilën Tolstoi i qaset vepës. Akti III, Skena 2 (në të cilën Liri, Kenti dhe Loloja janë bashkë gjatë shtrëngatës) përmbledhet kështu: Liri ecën nëpër yrt dhe thotë fjalë që synojnë të shprehin dëshpërimin e tij: ai dëshiron që erërat të tërbohohen dhe të fryjnë aq fort sa (erërat) të çajnë bulcitë dhe rrëketë e shiut të përmytin gjithçka, që rrufetë t’ia shkrumbojnë thinjat, dhe shkrepetimat ta bëjnë pluhur botën dhe të prishin të gjitha farat “nga e cila lind kjo njerëzi mosmirënjohëse”! Loloja vazhdon të thotë fjalë akoma më të pakuptimta. Hyn Kenti: Liri thotë se gjatë kësaj shtrëngate të gjithë katilët do të zbulohen dhe dënohen. Kenti, të cilin Liri ende s’e njeh, përpiket ta bindë të gjejë mbrojtje nga shtrëngata në një kasolle. Në këtë pikë Loloja shqipton një profeci që s’ka fare lidhje me situatën dhe të gjithë largohen.

Verdikti përfundimtar i Tolstoit për *Lirin* është se asnjë vëzhgues i pahipnotizuar, nëse një vëzhgues i tillë do të ekzistonte, nuk do të mund ta lexonte deri në fund me ndonjë ndjesi tjetër përve “mospëlqimit dhe bezdisë”. Dhe patjetër e njëjta gjë është e vërtetë për të gjitha dramat e tjera të lavdëruara të Shekspirit, për të mos përmendur përrallat e pakuptimta të dramatizuara, “Perikliu”, “Nata e dymbëdhjetë”, “Shtrëngata”, “Simbelini”, Troili dhe Kresida”.

Duke u marrë me *Lirin* Tolstoi, harton një aktakuzë më të përgjithshme kundër Shekspirit. Ai zbulon se Shekspiri është deri diku i aftë në aspektin teknik, gjë që e ka pjesërisht zanafillën tek të qenët aktor, por po t’i heqësh këtë nuk ka asnjë vlerë. Ai s’ka fuqi ta portretizojë personazhin ose të bëjë që fjalët dhe veprimet të burojnë natyrshëm nga situatat, gjuha e tij është njëtrajtësisht e fryrë dhe qesharake, ai vë vazhdimisht mendimet e veta të rastësishme në gojën e çdo personazhi që del se është i dobishëm, shfaq një “mungesë të plotë të ndjenjës estetike”, dhe fjalët e tij “s’kanë asgjë të përbashkët me artin dhe poezinë”.


1 William Hazlitt (1778 - 1830) eseist, dramaturg dhe kritik letrar, piktor, dhe filozof anglez, një nga kritikët dhe eseistët më të mëdhenj në historinë e gjuhës angleze. (Shënim i përkthyesit).

2 Georg Brandes (1842 - 1927) kritik dhe studiues danez që ndikoi shumë në letërsinë skandinave dhe evropiane nga vitet 1870 deri në fund të shekullit të 20-të. (Shënim i përkthyesit).

Mbreti Lir, Tolstoi dhe loloja

Nga George Orwell

Përktheu nga origjinali Granit Zela



“Shekspiri mund të ketë qenë çdo gjë që ju pëlqen”, - përfundon Tolstoi, “por s’ka qenë artist”. Për më tepër, mendimet s’i ka origjinale apo interesante, dhe prirja e tij është “nga më të ulëtat dhe më të pamoralshmet”. Çuditërisht, Tolstoi nuk e mbështet këtë gjykim të fundit në pjesë të veprës së Shekspirit, por në pohimet e dy kritikëve, Xhërvajnësit³ dhe Brandesit. Sipas Xhërvajnësit (ose në çdo rast leximi që i bën Tolstoit atij) “Shekspiri të mëson...se njeriu mund të jetë *tepër i mirë*”, ndërsa sipas Brandesit “parimi themelor i Shekspirit... është se qëllimi justifikon mjetet”. Tolstoi shton për hesap të vet se Shekspiri ishte një patriot i tipit më të keq, por përveç kësaj ai mendon se Xhërvënajsi dhe Brandesi kanë dhënë një përshkrim të vërtetë dhe mjaft të përpiktë të Shekspirit për jetën. Tolstoi më pas ripërmbledh në disa paragrafë teorinë e tij për artin që ai e ka shprehur më hollësisht diku tjetër. E thënë shkurt, sipas saj kërkohet që tema e një vepre të jetë dinjitoze, të shtjellohet me sinqeritet dhe mjeshtëri të mirë. Një vepër e madhe artistike duhet të trajtojë një temë që është “e rëndësishme për jetën e njerëzimit”, duhet të shprehë diçka që autori e ndjen sinqerisht dhe duhet të përdorë metoda të tilla teknike që krijojnë efektin e dëshiruar. Ndërsa Shekspiri është i zhvlerësuar në këtë pikëpamje, i shkujdesur në aspektin e mjeshtërisë dhe i paafët për të qenë i sinqertë

3 Georg Gervinus (1805-1871) historian letrar dhe politik gjerman, autor i “Komentarwve tw Shekspirit” (1863). (Shënim i përkthyesit).

goftë edhe për një çast të vetëm, ai padyshim është i dënuar.

Por këtu lind një pyetje e vështirë. Nëse Shekspiri është krejt ashtu si na ka treguar Tolstoi, si arriti të bëhet kaq shumë i admiruar? Me sa duket, përgjigja mund të gjendet vetëm në një lloj hipnoze masive, ose “sugjestionim epidemik”. E gjithë bota e qytetëruar është mashtruar në njëfarë mënyre duke e menduar Shekspirin shkrimtar të mirë, dhe madje edhe demonstrimi më i qartë për të kundërtën s’bën përshtypje, sepse s’kemi të bëjmë me një mendim të arsyetuar, por me diçka të ngjashme me besimin fetar. Gjatë historisë, thotë Tolstoi, ka pasur një seri të pafund “sugjestionimesh epidemike” të tilla, për shembull, kryqëzatat, kërkimi i gurit filozofal, mania për rritjen e tulipanëve që dikur përfshiu Holandën, e kështu me radhë. Si shembull bashkëkohor, ai citon, në mënyrë të domethënëse, çështjen Dreyfus,⁴ rast në të cilin e gjithë bota u përfshi nga një histeri e dhunshme, pa asnjë arsye konkrete. Ka edhe çmenduri të papritura jetëshkurtëra për teoritë e reja politike

4 Alfred Dreyfus (1859 – 1935) oficer i artilerisë franceze me prejardhje hebreje, gjyqi dhe dënimi i të cilit në 1894 me akuzën e tradhtisë ndaj Francës në shërbim të Gjermanisë u bë një nga dramat politike më polarizuese në historinë moderne franceze. Shkrimtari i shquar Emil Zola i shkroi në janar të vitit 1898 një letër të hapur presidentit të Francës kundër histerisë ndaj Dreyfus-it, sidomos ngaqë kishte prejardhje hebreje. Pas një odiseade disa vjeçare, çështja rigjykohet, dhe Dreyfus shpallet i pafajshëm. (Shënim i përkthyesit).



dhe filozofike, ose për këtë apo atë shkrimtar, artist apo shkencëtar, për shembull, Darvini, i cili (në 1903) “po fillon të harrohet”. Dhe në disa raste një idhull popullor krejt i pavlerë mund të mbetet i parapëlqyer për shumë shekuj, sepse “ndodh që çmenduri të tilla, të lindura si pasojë e arsyeve të veçanta që përkrahen rastësisht ngulitjen e tyre, përkoinë në një shkallë të tillë me pikëpamjet e jetës së përhapur në shoqëri, e sidomos në rrethet letrare, sa ato mbahen gjallë për një kohë të gjatë”. Dramat e Shekspirit kanë vazhduar të admirohen për një kohë të gjatë, sepse “ato përkonin me kuadrin mendor jofetar dhe imoral të shtresave të larta të kohës së tij dhe tonës”.

Për sa i përket mënyrës se si *filloi* fama e Shekspirit, Tolstoi e shpjegon me faktin se ishte “sajuar” nga profesorët gjermanë në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. Reputacioni i tij “e ka origjinën në Gjermani dhe prej andej u përhap në Angli”. Gjermanët zgjodhën ta lartësojnë Shekspirin sepse në një kohë kur s’kishte asnjë dramë gjermane për të cilën ia vlente të flitej dhe letërsia klasike franceze kishte filluar të dukej e ftohtë dhe artificiale, ata u mahnitën nga “zhvillimi i zgjuar i skenave” të Shekspirit dhe gjetën po kështu tek ai një shprehje të mirë të qëndrimit të tyre ndaj jetës. Gëte e shpalli Shekspirin poet të madh, të gjithë kritikët e tjerë u dyndën pas tij si një tufë papagajsh dhe ky pasioni i madha ka zgjatur që prej atëherë. Si pasojë kemi zhvlerësimin e mëtejshëm të dramës, dhe Tolstoi tregon kujdes të përfshijë dramat e tij kur dënon skenën bashkëkohore, dhe një çoroditje të mëtejshme të pikëpamjes morale mbizotëruese. Nga kjo rezulton se “glorifikimi i rremë i Shekspirit” është një e keqe e rëndësishme, të cilën Tolstoi e ndjen si detyrë ta luftojë.

Ky, pra, është thelbi i pamfletit të Tolstoit. Ndjesia e parë që të krijohet është se duke e përshkruar Shekspirin si një shkrimtar të keq, ai po thotë diçka që është në mënyrë krejt të dukshme e pavërtetë. Por kjo s’është fare e vërtetë. Në realitet s’ka asnjë lloj prove apo argumenti me të cilin mund të tregohet se Shekspiri ose ndonjë shkrimtar tjetër është “i mirë”. As nuk ka ndonjë mënyrë për të provuar përfundimisht se, për shembull, Uoruiik Diping⁵ është shkrimtar “i keq”. Në fund të fundit, s’ka asnjë test të meritës letrare përveç mbijetesës, e cila në vetvete është thjesht tregues për mendimin e shumicës. Teoritë artistike si ajo e Tolstoit janë krejt të pavlefshme, sepse jo vetëm që fillojnë me hamendësime arbitrare, por varen nga terma të paqarta (“e sinqertë”, “e rëndësishme” e kështu me radhë) të cilat mund të interpretohen si t’i zgjedhësh ti. Në këtë këndvështrim, s’ke si t’i përgjigjesh sulmit të Tolstoit. Pyetja interesante është: pse ia doli atëherë? Por duhet vënë re sidoqoftë se ai përdor shumë argumente të dobëta ose të pandershme. Disa prej tyre ia vlen të vihen në dukje, jo sepse zhvlerësojnë akuzën e tij kryesore, por sepse janë, si të thuash, provë e dashaligjësishë.

Si fillim, analiza që ai i bën “Mbretit Lir” nuk është “e paanshme”, siç mëton (pretendon) dy herë. Përkundrazi, është shprehje e vazhdueshme keqinterpretimi. Është e qartë se kur je duke përmbledhur “Mbretin Lir” për të mirën e dikujt që s’e ka lexuar, nuk je vërtet i paanshëm nëse paraqet një ligjërim të rëndësishëm (fjalimin e Lirit kur Kordelia ka vdekur në krahët e tij) në këtë mënyrë: “Përsëri fillojnë përcartjet e tmerrshme të Lirit, prej të cilave njeriu ndihet i turpëruar, ashtu si për shakatë e pasuksesshme”. Dhe në shumë e shumë raste Tolstoi i ndryshon ose ngjyros pak fragmentet që kritikon, gjithmonë në mënyrë që ta bëjë subjektin të duket pak më i ndërlikuar dhe

5 George Warwick Deeping- tregimtar dhe romancier, romani më i njohur i të cilit ishte “Sorrell dhe i biri”. (Shënim i përkthyesit).

i pamundur, ose gjuhën pak më të fryrë. Për shembull, na thuhet se Liri: “nuk ka nevojë apo motiv për abdikim”, megjithëse arsyeja për abdikimin e tij (që është plak dhe dëshiron të tërhiqet nga punët e shtetit) është treguar qartë në skenën e parë. Shihet se edhe në fragmentin që citova më parë, Tolstoi e ka keqkuptuar me dashje një frazë dhe ka ndryshuar pak kuptimin e një tjetri, duke e bërë të pakuptimtë një vërejtje që është e arsyeshme në kontekstin e vet. Asnjë nga këto keqlexime nuk është shumë e rëndë në vetvete, por efekti i tyre në rritje është ekzagjerimi i mosvijimësisë psikologjike të dramës. Përsëri, Tolstoi s’është në gjendje të shpjegojë pse dramat e Shekspirit botoheshin ende, dhe pse viheshin ende në skenë, dyqind vjet pas vdekjes (*para* se të fillonte “sugjestionimi epidemik”), dhe e gjithë fabula e tij për përhapjen e famës së Shekspirit është hamendësim i shoqëruar me shtrembërimë të plota. Dhe përsëri, akuzat e ndryshme kundërshtojnë njëra-tjetrën: për shembull, Shekspiri është thjesht argëtues, dhe “jo i rëndësishëm”, por nga ana tjetër ai vazhdimisht i vendos mendimet e veta në gojën e personazheve të tij.

Në tërësi, është e vështirë të mendosh se kritikat e Tolstoit janë bërë më sinqeritet. Në çdo rast, është e pamundur që ta kishte besuar plotësisht tezën kryesore, të ketë besuar se për një shekull ose më shumë e gjithë bota e qytetëruar ishte mashtruar nga një gënjeshtër e madhe dhe e prekshme, të cilën vetëm ai ishte në gjendje shquante. Sigurisht që mospëlqimi i tij ndaj Shekspirit është mëse i vërtetë, por arsyet për këtë mund të jenë të ndryshme, ose pjesërisht të ndryshme, nga ato që pohon; dhe kjo është arsyeja pse ngjall kërkshëri pamfleti i tij.

Në këtë pikë je i detyruar të fillosh të hamendësosh. Megjithatë, ekziston një tregues i mundshëm, ose të paktën është një pyetje e cila mund të na thotë se pse. Pyetja është: pse Tolstoi, kur kishte tridhjetë ose më shumë drama për të zgjedhur, zgjodhi “Mbreti Lir” si objek të veçantë sulmi? E vërtetë, “Mbreti Lir”, është kaq e njohur dhe është vlerësuar aq shumë sa me të drejtë mund të merret si përfaqësuese e veprës më të mirë të Shekspirit; megjithatë, për qëllimin e një analize armiqësore, Tolstoi ndoshta zgjodhi dramën që nuk e pëlqente më shumë. A s’është e mundur që të ketë pasur një armiqësi të veçantë pikërisht ndaj kësaj drame, sepse në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme ai e dinte ngjashmërinë midis historisë së Lirit dhe historisë së tij? Por është më mirë t’i qasemi kësaj të dhëne nga drejtimi i kundërt - domethënë, duke shqyrtuar vetë dramën “Mbreti Lir” dhe cilësitë e saj që Tolstoi nuk i përmend.

Një nga gjërat e para që lexuesi anglez vuri re në pamfletin e Tolstoit është se ai gati s’e analizon fare Shekspirin si poet. Shekspiri shihet si dramaturg, dhe nëse popullariteti i tij nuk është i rremë, mendohet se është i tillë për shkak të mashtrimeve të artit skenik që u japin mundësi të mira aktorëve të zgjuar. Tani, për sa i përket vendeve anglishtfolëse, kjo s’është e vërtetë. Disa nga dramat që vlerësohen më së shumti nga dashamirësit e Shekspirit (për shembull, “Timoni i Athinës”) interpretohen rrallë ose asnjëherë, ndërsa disa nga më të vënat në skenë, si “Ëndrra e një nate vere”, janë më pak të admiruarat. Ata që tregojnë interes më shumë për Shekspirin e vlerësojnë në radhë të parë për përdorimin e gjuhës, “muzikën e fjalëve” të cilën edhe Bernard Shou (Bernard Shaë), një tjetër kritik armiqësor, e pranon se është “magjepsëse”.

Tolstoi e shpërfill këtë dhe duket se s’e kupton që një poezi mund të ketë vlerë të veçantë për ata që flasin gjuhën në të cilën është shkruar. Megjithatë, edhe nëse dikush e vendos veten në vendin e Tolstoit dhe përpiqet të mendojë për Shekspirin si një poet të huaj, është sidoqoftë e qartë se ka diçka që Tolstoi ka lënë jashtë shqyrtimit të tij kritik. Poezia, me sa duket, *nuk është* vetëm çështje tingulli, shoqërizimesh idesh, dhe e pavlerë jashtë grupit të vet gjuhësor: përndryshe, si ka mundësi që disa poezi, përfshirë poezitë e shkruara në gjuhë të vdekura, të arrijnë të kalojnë me sukses kufijtë e vendit të tyre? Është e qartë se një lirikë si: “Nesër është dita e Shën Valentinit” s’mund të përkthehej në mënyrë të kënaqshme, por në veprën kryesore të Shekspirit ka diçka të përshkrueshme si poezia që mund të ndahet nga fjalët. Tolstoi ka të drejtë kur thotë se “Lir” s’është një dramë shumë e mirë, si dramë. Është e zgjatur, me shumë personazhe dhe nënsubjekte. Një vajzë e ligë do të kishte mjaftuar, dhe Edgari është një personazh i tepërt: me të vërtetë do të ishte ndoshta një dramë më e mirë nëse Glostëri dhe të dy djemtë e tij të hiqeshin.

Megjithatë, diçka, një lloj modeli, ose ndoshta vetëm një atmosferë, i mbijeton ndërlikimeve dhe përmasave. “Lir” mund të imagjinohet si shfaqje kukullash, mimikë, balet, një seri fotografish. Pjesë e poezisë së saj, ndoshta pjesa më thelbësore, është e genëshisme te historia dhe nuk varet nga asnjë grup i caktuar fjalësh, dhe as nga paraqitja e një njeriu prej mishi dhe gjaku. Mbyllni sytë dhe mendoni për *Mbretin Lir*, nëse mundei pa kujtuar asnjë dialog. Çfarë shihni? Ja çfarë shoh unë përherë: një plak madhështor me një mantel të zi, të gjatë, me flokë dhe mjekër të thinjur, dallgëzues, një portret nga vizatimet e Blejkut [Blake] (por edhe mjaft kureshtar, si Tolstoi), që endet nëpër një shtrengat dhe mallkon qiejt, në shoqërinë e një Loloje dhe një të çmenduri. Tani, skena ndryshon dhe plakun, sërish duke mallkuar, sërish duke mos kuptuar asgjë, po mban një vajzë të vdekur në krahë, ndërsa Loloja tërhiqet diku në sfond.


Ky është skeleti i dramës, por edhe këtu Tolstoi dëshiron të heqë pjesën më të madhe të asaj që është thelbësore. Ai kritikon praninë e shtrengatës, si të panevojshme për Lolom, i cili në sytë e tij është thjesht një telash i lodhshëm dhe justifikim për të bërë shaka pa vlerë, dhe për vdekjen e Kordelias, e cila, siç e sheh ai, i heq dramës forcën morale. Sipas Tolstoit, drama e mëparshme, “Mbreti Leir”, të cilën e përshtati Shekspiri, përfundon më natyrshëm dhe përputhet më shumë me kërkesat morale të spektatorit sesa ajo e Shekspirit: domethënë, me Mbretin e Galëve që pushton tokat e burrave të motrave më të mëdha dhe Kordelian, që nuk vritet por e rikthen Lirin në pozitën e mëparshme. Me fjalë të tjera, tragjedia duhet të ishte një komedi, ose ndoshta melodramë. Është e pasigurtë nëse ndjenja e tragjedisë është e pajtueshme me besimin në Zot: në çdo rast, ajo

s’është e pajtueshme me mosbesimin në dinjitetin njerëzor dhe me llojin e “kërkesës morale” e cila ndihet e mashtruar kur virtyti nuk arrin të ngadhnjeh. Një situatë tragjike ekziston pikërisht kur virtyti *nuk* ngadhjnen, por kur ende ke ndjenjën se njeriu është më fisnik se forcat që e shkatërrojnë atë. Ndoshta është më domethënëse që Tolstoi s’sheh asnjë justifikim për praninë e Lolos. Loloja është pjesë e pandashme e dramës. Ai vepron jo vetëm si një lloj kori, e bën më të qartë situatën qendrore duke e komentuar në mënyrë më inteligjente se personazhet e tjerë, por si kontrast me shpërthimet e furishme të Lirit. Shakatë, gjëgjëzat, lojërat me rimë dhe zbulimet e marrëzive të pafundme të Lirit krenar, duke filluar nga tallja e thjeshtë deri te një lloj poezie melankolike, (*“Të gjithë titujt e tjerë që i flake; mbajte vetëm atë me të cilin lindë”*⁶), janë si shfaqja e mendjes së shëndoshë që përshkon dramën, e cila na kujton se diku, kudoqoftë, pavarësisht padrejtësive, mizorive, intrigave, mashtrimeve dhe keqkuptimeve që po ndodhin këtu, jeta po vazhdon si zakonisht. Në padurimin e Tolstoit me Lolon, mund të zbulojmë kalimthi një arsye më të thellë grindjes së tij më të madhe me Shekspirin. Ai kundërshton, me një farë arsyetimi, mungesën e harmonisë te dramat e Shekspirit, detajet e parëndësishme, subjektet e pabesueshme, gjuhën e fryrë. Por ajo që në fund të fundit ndoshta nuk e pëlqen më shumë është një lloj teprie energjie dhe emocioni, një prirje për të marrë kënaqësi nga procesi i vërtetë i jetës se sa thjesht për të shfaqur interes për të. Është gabim ta shohësh Tolstoin vetëm si një moralist që sulmon një artist. Ai kurrë nuk ka thënë se arti, si i tillë, është i keq apo i pakuptimtë, as se virtuoiziteti teknik është i parëndësishëm. Por qëllimi i tij kryesor, në vitet e mëvonshme, ishte të ngushtonte gamën e vetëdijes njerëzore. Interesat e njeriut, pikat e lidhjes me botën fizike dhe luftën e përditshme, duhet të jenë sa më të pakta të jetë e mundur dhe jo sa më të shumta. Letërsia duhet të përbëhet nga parabola, të jetë e zhveshur nga detajet dhe pothuajse e pavarur nga gjuha.

Parabolat, pikërisht këtu ndryshon Tolstoi nga puritani mesatar i rëndomtë, duhet të jenë vetë vepra arti, por kënaqësia dhe kureshtja duhet të përjashtohen prej tyre. Shkenca, gjithashtu, duhet të shpëputet nga kureshtja. Çështja e shkençës, thotë ai, s’është të zbulojë se çfarë ndodh, por t’u mësojë njerëzve se si duhet të jetojnë. Kështu edhe me historinë dhe politikën. Shumë probleme (për shembull, rasti Dreyfus) thjesht s’ia vlen të zgjidhen, dhe ai është i gatshëm t’i lërë ato si përfundime të çlirëta. Në të vërtetë e gjithë teoria e tij e “lajthitjeve” ose “sugjestionimeve epidemike”, në të cilën ai bën bashkë gjëra të tilla si kryqëzatat dhe pasioni holandez i rritjes së tulipanëve, tregon gatishmëri për t’i parë shumë veprimtari njerëzore thjesht si nxitime milingonash sa andej-këtej, diçka e pashpjegueshme dhe jo interesante. Është e qartë se ai s’mund të kishte durim me një shkrimtar kaotik, të detajeve, me larmi subjektesh që kalojnë nga një temë në tjerën si Shekspiri. Reagimi i tij është ai i një të moshuari nervoz, i cili po bezdiset nga një fëmijë i zhurmshëm. “Pse kërcen lart e poshtë pa pushim ashtu? Pse nuk mund të rrish i qetë si unë?” Në njëfarë mënyre, plakun ka të drejtë, por halli është se fëmija ndien gjakun që i vërshon në gjynmtyrë, gjë që plakun nuk e ndiën më. Dhe nëse plakun e di për ekzistencën e kësaj ndjenje, kjo thjesht e shton nervozizmin: po të ishte në dorën e tij, fëmijët do t’i bënte pleq. Tolstoi nuk e di, ndoshta, kjo është vetëm çfarë *i shpëton* pa pikasur te Shekspiri, por është i vetëdijshëm se diçka i shpëton pa pikasur, dhe është i vendosur që edhe të tjerët të mos e kë këtë mundësi. Nga natyra ishte arrogant dhe egoist. Edhe pasi ishte në moshë madhore, ai përsëri e godiste shërbëtorin e vet në çaste zemërimi dhe pak më vonë, sipas biografit të tij anglez, Derrick Leon, ai ndjente: “një dëshirë të herë pas hershme që pas provokimit më të vogël të gjuante me shuplakë ata me të cilët s’ishte dakord”. Njeriu s’e shndërron domosdoshmërisht atë lloj temperamenti me anë të konvertimit fetar, dhe në të vërtetë është e qartë se iluzion i të qenit rilindur mund të lejojë që veset e dikujt të lulëzojnë më shumë se kurrë, edhe pse ndoshta në forma më të stërholluar.

Tolstoi ishte i aftë të hiqte dorë nga dhuna fizike dhe të shihte se çfarë nënkupton kjo, por nuk ishte i aftë të tregonte tolerancë apo përlulësi, edhe nëse s’dinte asgjë për veprat e tjera, është e lehtë të

⁶ “Mbreti Lir”, Akti I, Skena IV.



dallosh prirjen e tij drejt tiranizimit shpirtëror vetëm nga ky plamflet.

Megjithatë, Tolstoi nuk po përpiqet thjesht t’u grabisë të tjerëve një kënaqësi që s’e ndan me ta. Këtë patjetër që po e bën, por grindja e tij me Shekspirin shkon më tej. Është grindja mes qëndrimeve fetare dhe humaniste ndaj jetës. Këtu kthehemi te tema qendrore e “Mbretit Lir”, të cilën Tolstoi s’e përmend, megjithëse e parashtron subjektin me disa detaje. “Liri” është një nga të paktat drama të Shekspirit që janë në mënyrë të pagabueshme *rreth* diçkaje. Siç ankohet me të drejtë Tolstoi, janë shkruar shumë gjeputa për Shekspirin si filozof, si psikolog, si “mësues i madh moral” dhe çfarë s’është shkruar. Shekspiri nuk ishte mendimtar sistematik, mendimet e tij më serioze shqiptohen në mënyrë të parëndësishme ose të tërthortë dhe s’e dimë se deri në çfarë mase ka shkruar me një “qëllim” apo edhe sa nga vepra që i atribuohen atij janë shkruar në të vërtetë prej tij. Te “Sonetet” madje s’u referohet asnjëherë dramave si pjesë e arritjeve të tij, megjithëse bën një aludim që duket deri diku i sikletshëm për karrierën si aktor. Është krejtësisht e mundur që ai të shihte të paktën gjysmën e dramave thjesht si vepra të shkruara për para dhe nuk shqetësohej edhe aq për qëllimin ose mundësitë për aq kohë sa mund të sajonte diçka, zakonisht nga lëndë e vjedhur, e cila harmonizohej pak a shumë si një e tërë në skenë. Megjithatë, kjo nuk është e gjithë historia. Si fillim, siç thekson vetë Tolstoi, Shekspiri e ka zakon të vërë në gojën e personazheve reflektime të përgjithshme, të panevojshme. Ky është gabim serioz për një dramaturg, por nuk përputhet me portretin që Tolstoi i bën Shekspirit si një kalemxhi i rëndomtë që s’ka mendime të veta dhe thjesht dëshiron të krijojë efektin më të madh në mënyrën më të lehtë të mundshme. Dhe më shumë se kaq, rreth një duzinë nga dramat e tij, të shkruara në pjesën më të madhe më vonë se viti 1600, kanë pa dyshim një kuptim dhe madje edhe një moral. Ato rrotullohen rreth një teme qendrore e cila në disa raste mund të thuhet me një fjali të vetme. Për shembull, “Makbethi” ka të bëjë me ambicjen, “Otello” ka të bëjë me xhelozinë dhe “Timoni i Athinës” ka të bëjë me paratë. Tema e “Lirit” është heqja dorë nga fron, dhe vetëm nëse do të tregohesh vetë i verbër mund të mos arrish të kuptosh se çfarë thotë Shekspiri.

Liri heq dorë nga fron, por pret që të gjithë të vazhdojnë ta trajtojnë si mbret. Ai nuk e kupton që nëse dorëzon pushtetin, të tjerët do të përfitojnë nga dobësia e tij: dhe sidomos ata që i bëjnë lajka më shumë, pikërisht Regana dhe Gonerila, janë pikërisht ata që do t’i kthehen kundër. Në çastin kur zbulon se s’mund t’i detyrojë më njerëzit t’i binden siç bënte më parë, atë e pushton një zemërim të cilin Tolstoi e përshkruan si “të çuditshëm dhe të panatyrshëm”, por që në fakt është në mënyrë të përsosur pjesë e personazhit të tij. Në kulmin e çmendurisë dhe dëshpërimit, Liri kalon nëpër dy gjendje shpirtërore, të cilat sërish janë krejt të natyrshme në rrethanat e tij, megjithëse në njërën prej tyre ka të ngjarë që të përdoret pjesërisht si zëdhënës për mendimet e vetë Shekspirit. Njëra është gjendja e neverisë në të cilën Liri pendohet, si të thuash, që ka qenë mbret, dhe për herë të parë e kupton kalbësinë e drejtësisë zyrtare dhe moralin vulgar. Gjendja tjetër shpirtërore është ajo e tërbimit të pafuqishëm në të cilën ai kryen hakmarrje imagjinare ndaj atyre që i kanë bërë padrejtësi. *“Të kesh një mijë me pështyma të kuqe djegëse Ejani duke fërshëllyer mbi to!”* dhe: *“Sikur të kishte nga një mijë djaj/Me hej të skuqur e t’u turreshin, /T’i cingërisin mu në zjarr të ferrit...”*⁷ dhe:

*“Ja një kapel’ e bukur: çdhelperi
E hollë luftarake, kur t’i mbath
Kujt e regjimentit me shajak
Dhe kur t’u shkoj dhëndurrëve nga prapa,
Do t’i sulmoj, t’i vras, t’i vras, t’i vras!”*⁸

Vetëm në fund e kupton, si një njeri me gjykim të shëndoshë, se pusheti, hakmarrja dhe fitorja nuk vlejnë kur thotë:

*“Jo, jo, jo, jo, të vemë shpejt në burg...
...Në burg do të shohim se si vijnë e zhuken/Tarafet e lavditë e të mëdhenjve,/Që hipin e zbresin sipas hënës”*⁹

Por në kohën kur e bën këtë zbulim është tepër vonë, sepse vdekja e tij dhe e Kordelias tashmë janë vendosur. Kjo është historia dhe, pavarësisht disa fragmenteve jo elegante në rrefim, është një histori shumë e mirë.

Por a nuk është gjithashtu e ngjashme në mënyrë të çuditshme me historinë e vetë Tolstoit? Në përgjithësi ka një ngjashmëri që vështirë se mund ta shmangësh, sepse ngjarja më mbresëlënëse në jetën e Tolstoit, si në atë të Lirit, ishte një akt i madh i pashkak heqjeje dorë nga bota. Në pleqëri Tolstoi hoqi dorë nga pasuria, titulli, të drejtat e autorit dhe bëri një përpjekje, një përpjekje të sinqertë, megjithëse të pasuksesshme, për të shmangur pozitën e privilegjuar dhe për të jetuar jetën e një fshatari. Por ngjashmëria më e thellë qëndron në faktin se Tolstoi, ashtu si Liri, veproi mbështetur në motive të gabuara dhe nuk arriti të merrte rezultatet që kishte shpresuar. Sipas Tolstoit, qëllimi i çdo njeriu është lumturia dhe lumturia mund të arrihet vetëm duke bërë vullnetin e Zotit. Por të bësh vullnetin e Perëndisë do të thotë të heqësh dorë nga të gjitha kënaqësitë dhe ambiciet tokësore dhe të jetosh vetëm për të tjerët. Prandaj, në fund të fundit, Tolstoi hoqi dorë nga bota me shpresën se kjo do ta bënte atë më të lumtur. Por nëse ka një gjë të sigurt për vitet e tij të mëvonshme, ajo është se ai *nuk* ishte i lumtur. Përkundrazi, gati vajt në zgrip të çmendurisë nga sjellja e njerëzve ndaj tij, të cilët e persekutuan pikërisht *për shkak* të heqjes dorë. Ashtu si Liri, Tolstoi nuk tregojë i përlulur dhe nuk ishte një gjykatës i mirë i karakterit. Kishte çaste të caktuara kur prirje t’u rikthehej qëndrimeve të një aristokrati, pavarësisht petkave të fshatarit, dhe madje kishte dy fëmijë të cilëve u kishte besuar dhe që në fund iu kthyen kundër, megjithëse, natyrisht, në një mënyrë më pak të bujshme sesa Regana

⁷ Akti 3, Skena 6.

⁸ Akti IV, Skena 6.

⁹ Akti V, Skena 3.

dhe Gonerila. Neveria e tij e tepruar ndaj seksualitetit ishte gjithashtu qartësisht e ngjashme me atë të Lirit. Vërejtja e Tolstoit se martesë është “skllavëri, ngopje, neveri” dhe do të thotë të durosh afërsinë e “shëmtisë, pisllekut, erës, plagëve”, përputhet me shpërthimin e njohur të Lirit:


“E sipërmja u përket perëndive
Dhe pjesa e poshtme është krejt e djallit.
Këtu ka qelbësirë, kullufiskë” etj, etj.¹⁰

Dhe megjithëse Tolstoi s’mund ta parashikonte kur shkroi esenë për Shekspirin, as këtë dhe as fundin e jetës së tij, arratisja e tij e papritur dhe e paplanifikuar në vend, i shoqëruar vetëm nga një vajzë besnike, vdekja në shtëpizën e një fshati të çuditshëm, duket se kanë një lloj ngjashmërie të largët me Lirin.

Natyrisht, s’mund të hamendësohet se Tolstoi ishte i vetëdijshëm për këtë ngjashmëri, ose se do ta kishte pranuar nëse do t’i ishte vënë në dukje. Por qëndrimi i tij ndaj dramës duhet të jetë ndikuar nga tema e saj. Heqja dorë nga pushteti, dhënia e tokave të tua të tjerëve, ishte një temë të cilën kishte arsye të ishte fort e ndjeshme për të. Prandaj, ndoshta zemërohej dhe shqetësohej më shumë nga mësimi moral që nxjerr Shekspiri, sesa në rastin e ndonjë drame tjetër, te “Makbethi”, për shembull, dramë që nuk lidhej aq shumë me jetën e tij. Por cili *është* saktësisht morali i “Lirit”? Me sa duket ka dy mësimë morale te kjo histori, njëra e dukshme, tjetra e nënkuptuar. Shekspiri fillon duke hamendësuar se ti bëhesh i pafuqishëm kur nxit një sulm ndaj teje. Kjo s’do të thotë se *të gjithë* do të të kthehen kundër (Kenti dhe Loloja i qëndrojnë Lirit pranë nga fillimi në fund), por me shumë mundësi *dikush* do të të kthehet kundër. Nëse i flak armët, ato do t’i marrë një person më pak i ndershëm. Nëse kthen faqen tjetër, do të marësh një goditje më të fortë se e para. Kjo s’ndodh gjithmonë, por është e pritshme dhe s’ke pse ankohesh nëse ndodh. Goditja e dytë është, si të thuash, pjesë e aktit të kthimit të faqes tjetër. Para së gjithash, pra, ekziston morali vulgar dhe logjikë te Loloja: “Mos hiq dorë nga pushteti, mos hiq dorë nga tokat e tua”. Por ka edhe një moral tjetër. Shekspiri nuk e shqipton kurrë me shumë fjalë dhe s’ka shumë rëndësi nëse ishte plotësisht i vetëdijshëm për këtë. Është pjesë e historisë, të cilën, në fund të fundit, ai e krijoi ose e ndryshoi për t’iu përshtatur qëllimeve të tij. Ajo është: “Hiq dorë nga tokat e tua nëse do, por mos prit që kjo të bëj të lumtur. Ka gjasa të mos bëhesh i lumtur. Nëse jeton për të tjerët, duhet të jetosh për *të tjerët*, dhe të mos e përdorësh këtë si një mjet të tërthortë për të krijuar një përparësi për veten tënde”. Është e qartë se asnjëri nga këto përfundime s’mund të ketë qenë i kënaqshëm për Tolstoin. E para shpreh egoizmin e zakonshëm, nga i cili ai vërtet po përpigjet të shpëtonte. Përfundimi tjetër bëj ndesh me dëshirën e tij për të bërë dy gjëra kundëthënë, domethënë, për të shkatërruar egoizmin e tij dhe duke bërë kështu të fitojë jetën e përjetshme.

Natyrisht, “Mbreti Lir” nuk është një predikim në mbështetje të altruizmit. Ai thjesht vë në dukje pasojat e vënies në praktikë të vetëmohimit për arsye egoiste. Shekspiri kishte një dell materialisti dhe nëse do të ishte detyruar të merrte anë në dramë, ai me siguri do të shfaqte simpati për Lolon. Por të paktën mund ta shihte çështjen në tërësi dhe ta trajtonte në nivelin e tragjedisë. Vesi dënohet, por virtyti nuk shpërblehet. Morali i tragjedive të mëvonshme të Shekspirin nuk është fetar në kuptimin e zakonshëm dhe sigurisht s’është i krishterë. Vetëm dy prej tyre, “Hamleti” dhe “Otello”, me gjasë ndodhin në epokën e krishterë, por edhe në to, përveç veprimeve të fantazmave te “Hamleti”, s’ka asnjë tregues të një “bote tjetër” ku gjithçka duhet të jetë në vendin e vet. Të gjitha këto tragjedi nisin me hamendësimin humanist se jeta, edhe pse e mbushur me pikëllim, ia vlen të jetohet dhe se njeriu është një kafshë fisnike, një bindje që Tolstoi s’e kishte në pleqëri.

Tolstoi nuk ishte shenjtor, por u përpoq shumë të bëhej shenjtor dhe standardet që ai zbatoi në letërsi ishin shpirtërore. Është e rëndësishme të kuptojmë se ndryshimi midis një shenjtori dhe një qenieje të zakonshme njerëzore ka të bëjë me llojin dhe me shkallën e shenjtërisë. Kjo do të thotë se njëra s’duhet të shihet si një formë e papërsosur e tjetrës. Shenjtori, gjithsesi, lloji i shenjtorit të Tolstoit, s’po përpigjet të bëjë një përmirësim në jetën tokësore: ai po përpigjet t’i japë fund dhe të vendosë diçka tjetër në vend të saj. Një shprehje e qartë e kësaj është mëtimi (pretendimi) se përkorja seksuale është “më e lartë” se martesë. Sikur vetëm të reshtnim riprodhimin, luftën, përpjekjet dhe të kënaqurit, thotë Tolstoi, sikur të mund të çliroheshim jo vetëm nga mëkatet tona, por nga çdo gjë tjetër që na lidh me sipërfaqen e tokës, duke përfshirë dashurinë, në kuptimin e zakonshëm të kujdesit më shumë për një qenie njerëzore sesa për një tjetër, atëherë i gjithë ky proces i dhimbshëm do të merrte fund dhe do të vinte Mbretëria e Qiellit. Por një qenie njerëzore normale sdëshiron Mbretërinë e Qiellit, ai dëshiron që jeta në tokë të vazhdojë. Kjo s’ndodh vetëm sepse ai është “i dobët”, “mëkatar” dhe në ankth për një “kohë të mirë”. Shumica e njerëzve e kalojnë jetën me goxha shumë dëfrime, por në përgjithësi jeta është vuajtje, dhe vetëm të rinjtë ose ata që janë shumë budallenj e imagjinojnë ndryshe. Në fund të fundit, është qëndrimi i krishterë ai që është egoist dhe hedonist, pasi qëllimi është të largohemi gjithmonë nga mundimet e dhimbshme të jetës tokësore dhe të gjejmë paqen e përjetshme në një lloj Parajse ose Nirvane. Qëndrimi humanist është mundimet duhen të vazhdojnë dhe se vdekja është çmimi i jetës. *“Njeriu duhet ta durojë vdekjen/Ashtu siç duroi lindjen, / Veçse duhet të jetë i përgatitur”*¹¹ - është një ndjenjë jo e krishterë. Shpesh në dukje ka një armëpushim mes humanistit dhe besimtarit fetar, por në fakt qëndrimet e tyre s’mund të pajtohen: duhet zgjedhur mes kësaj bote dhe botës tjetër. Dhe shumica e madhe e qenieve njerëzore, nëse do ta kuptonin çështjen, do të zgjidhnin këtë botë. Ata e bëjnë këtë zgjedhje kur vazhdojnë të punojnë, të shumohen dhe të vdesin në



vend që të mos i bënë këto me shpresën për të marrë një shpërblim të ri ekzistence diku tjetër.

Nuk dimë shumë për bindjet fetare të Shekspirin dhe nga dëshmitë e shkrimeve të tij do të ishte e vështirë të vërtetohej se ai kishte ndonjë. Por gjithsesi nuk ishte shenjtor dhe as një shenjt i mundshëm: ai ishte një qenie njerëzore dhe në një farë mënyre jo shumë e mirë. Është e qartë, për shembull, se i pëlqente të mbështeste të pasurit dhe të fuqishmit dhe ishte në gjendje t’u bënte lajka në mënyrën më servile. Ai është gjithashtu dukshëm i kujdesshëm, për të mos thënë frikacak, për të mos shprehur opinione që s’janë popullore. Pothuajse asnjëherë nuk vë një vërejtje armiqësore ose skeptike në gojën e një personazhi që mund të identifikohet me të. Në dramat e tij, kritikët e mprehtë shoqërorë, njerëzit që s’mashtrohen nga bindje të gabuara të pranuara, janë bufonë, zuzarë, të çmendur ose persona që shtiren të çmendur ose janë në një gjendje histerie të dhunshme.

“Liri” është një dramë në të cilën kjo prirje është veçanërisht e theksuar. Ajo përmban shumë kritika sociale të nënkuptuara, një tipar që Tolstoi s’e ka vënë re, por të gjitha shqiptohen ose nga Loloja, ose nga Edgari kur ai mëton të jetë i çmendur, ose nga Liri gjatë ndërkohëve të çmendurisë. Në çastin e gjykimit të shëndoshë Liri vështirë se bën ndonjëherë një vërejtje inteligjente. E megjithatë vetë fakti që Shekspirin iu desh të përdorte këto dredhi tregon se sa të larmishme ishin mendimet e tij. Ai mund të mos komentonte thuhajse asgjë, megjithëse për ta bërë këtë vendosi një sërë maskash. Nëse dikush e ka lexuar një herë Shekspirin me vëmendje, s’mund të mos e kaloj një ditë pa e cituar, sepse s’ka shumë tema të një rëndësie madhore që ai të mos i diskutojë ose të paktën t’i përmend aty-këtu, në mënyrën e tij josistematike, por ndriçuese. Edhe gjërat e parëndësishme që mbushin çdo dramë të tij, lojërat e fjalëve dhe gjëegjëzat, listat me emra, copëza *reportazhi* si biseda e korrierëve te “Henri IV”, shakatë e çuditshme, fragmentet e shpëtuara nga balada të harruara, janë thjesht fryt i një force të tepërt jetësore.

Shekspiri nuk ishte filozof apo shkencëtar, por ai kishte kureshtje: ai e donte sipërfaqen e tokës dhe procesin e jetës. Gjë që, duhet përsëritur, nuk është e njëjta gjë si të duash të kalosh mirë dhe të mbetesh gjallë për aq kohë sa të jetë e mundur. Sigurisht, nuk është për shkak të cilësive së mendimit të tij arsyeja pse Shekspiri i ka mbijetuar kohës dhe ai mund të mos mbahej mend as si dramaturg nëse s’do të kishte qenë edhe poet. Burimi kryesor i pushtetit të tij te ne është përmes gjuhës. Se sa thellë ishte magjepsur vetë Shekspiri nga muzika e fjalëve mund të arrijmë në përfundim nga fjalimet e personazhit Pistëll te “Henri V”. Ajo që ai thotë është në pjesën më të madhe e pakuptimtë, por nëse i shqyrtojmë rreshtat e tij veçmas, ato janë vargje madhështore retorike. Siç duket, fragmente marrëzish tingëlluese (“Lërimi ujërat të vërshojnë, dhe dajjtë e urit të ulërijnë”, etj.¹²) po shfaqeshin vetvetiu vazhdimisht në mendjen e Shekspirin dhe duhej shpikur një personazh gjysmë i çmendur për t’i përdorur ato.

Gjuha amtare e Tolstoit nuk ishte anglishtja dhe askush s’mund ta fajësojë pse nuk u prek nga vargjet e Shekspirin, madje, ndoshta, as për refuzimin për të besuar te mjeshtëria që Shekspiri tregonte me fjalët. Por ai do të kishte refuzuar plotësisht edhe nocionin e vlerësimit të poezisë vetëm për tekstin e saj, ta vlerësonte atë, le të themi, si një lloj muzike. Nëse në njëfarë mënyre do t’i ishte vërtetuar se i gjithë shpjegimi i tij për përhapjen e famës së Shekspirin është i gabuar, se brenda botës anglishtfolëse, gjithsesi, popullariteti i Shekspirin është i vërtetë, se thjesht aftësia e tij në vendosjen e një rrokjeje pranë tjetrës i ka dhënë kënaqësi të pamatë anglishtfolësve brez pas brezi, e gjitha kjo s’do të ishte llogaritur si meritë e Shekspirin, por e kundërta. Thjesht do të kishte qenë një provë më shumë e natyrës jofetare dhe tokësore të Shekspirin dhe admiruesve të tij. Tolstoi do të kishte thënë se poezia duhet gjykuar nga kuptimi i saj dhe se tingujt magjepsës thjesht bëjnë që kuptimet e rreme të kalojnë pa u vënë re. Në çdo nivel është e njëjta çështje, kjo botë kundër botës tjetër, dhe sigurisht muzika e fjalëve është diçka që i përket kësaj bote.

Ka patur gjithmonë pezull një lloj dyshimi për karakterin e Tolstoit, ashtu si për karakterin e Gandit. Ai nuk ishte një hipokrit

i rëndomtë, siç shpallin disa se ishte dhe ndoshta do t’i kishte imponuar vetes sakrificë edhe më të mëdha, nëse s’do t’i ndërhynin në çdo hap njerëzit që e rrethonin, veçanërisht e shoqja. Por nga ana tjetër është e rrezikshme të vlerësosh dikë si Tolstoi sipas asaj që thonë dishepujt e tij. Ekziston gjithmonë mundësia, gjasat janë në të vërtetë që ata të mos kenë bërë asgjë tjetër përveçse kanë shkëmbyer një formë egoizmi me një tjetër. Tolstoi hoqi dorë nga pasuria, fama dhe privilegji, hoqi dorë nga dhuna në të gjitha format e saj dhe ishte gati të vuante si pasojë e këtij veprimi, por nuk është aq e lehtë të besohet se ai hodhi poshtë parimin e bindjes me anë të detyrimit, ose të paktën nga *dëshira* për të detyruar të të tjerët të binden. Ka familje në të cilat babai i thotë fëmijës së tij: “Do ta këpus veshin nëse e bën përsëri”, ndërsa nëna, me sytë e mbushur me lot, e merr fëmijën në krahë dhe i murmurin me dashuri. “Tani, i dashur, *a ka dëshirë* mami që të të ndodhë ty kjo?” Dhe kush do të thoshte se metoda e dytë është më pak tirane se e para? Dallimi që me të vërtetë ka rëndësi nuk është midis dhunës dhe jodhunës, por mes të paturit dhe të mos pasurit oreks për pushtet. Ka njerëz që janë të bindur për ligësinë si të ushtrive ashtu edhe të forcave të policisë, por që megjithatë janë shumë më intolerantë dhe inkuizitorë në botëkuptim se njeriu normal që beson se është e nevojshme të përdoret dhuna në rrethana të caktuara. Ata nuk do t’i thonë dikujt tjetër: “Bëje këtë, atë dhe atë tjetër ose do të shkosh në burg”, por, nëse munden, do të hyjnë në trurin e tij dhe do t’i diktojnë mendimet e tij për të edhe në detajet më të vogla. Kredo si pacifizmi dhe anarkizmi, të cilat në sipërfaqe duket se nënkuptojnë një heqje dorë të plotë nga pushteti, në të vërtetë e nxisin më tepër këtë zakon të mendjes. Sepse nëse keni përqafuar një besim që duket se është i çliuar nga pislleku i zakonshëm i politikës - një besim nga i cili ju vetë nuk mund të prisni të keni ndonjë përfitim material - me siguri kjo vërteton se jeni në anën e të drejtës? Dhe sa më shumë të jeni në anën e të drejtës, aq më e natyrshme është që të gjithë të tjerët të detyrohen të mendojnë në të njëjtën mënyrë. Nëse pritët të besojmë atë që ai thotë në pamfletin e tij, atëherë Tolstoi s’ka mundur kurrë të shoh ndonjë meritë te Shekspiri dhe habitej gjithmonë kur shihte se kolegët e tij shkrimtarë, Turgenev, Fet dhe të tjerë, mendonin ndryshe.

Mund të jemi të sigurt se në ditët e tij të mospendimit përfundimi i Tolstoit do të ishte: “Ti e pëlqen Shekspirin, unë jo. E lëmë me kaq”. Më vonë, kur perceptimi se secili ka shijen e tij e braktisi, ai filloi të mendonte për shkrimet e Shekspirin si diçka të rrezikshme për vetë atë. Sa më shumë kënaqësi të merrnin njerëzit nga Shekspiri, aq më pak do ta dëgjonin Tolstoin. Prandaj askush s’duhet *të lejohet* të shijojë Shekspirin, njësoj sikur askush s’duhet të lejohet të pijë alkoool apo duhan. E vërtetë, Tolstoi nuk do t’i pengonte me forcë. Ai s’kërkon që policia të konfiskojë çdo kopje të veprave të Shekspirin. Por do të hedh baltë mbi Shekspirin, nëse mundet. Ai do të përpigjet të hyjë në mendjen e çdo dashnori të veprës së Shekspirin dhe të vrasë kënaqësinë që merr me çdo mashttrim që mund të mendojë, duke përfshirë, siç e kam treguar në përmbledhjen e pamfletit të tij, argumente që janë vetë-kundërthënëse apo që madje ngjallin dyshime të jenë të sinqerta.

Por në fund fare gjëja më e habitshme është se sa pak rëndësi ka kjo. Siç thashë më herët, s’mund t’i *përgjigjesh* pamfletit të Tolstoit, të paktën për pikat kryesore të tij. S’ka asnjë argument me të cilin mund të mbrohet një poezi. Ajo mbrohet duke mbijetuar, ose është e pambrojtur. Dhe nëse ky test është i vlefshëm, mendoj se vendimi në rastin e Shekspirin duhet të jetë “i pafajshëm”. Si çdo shkrimtar tjetër, edhe Shekspiri mund të harrohet herët a vonë, por nuk ka gjasa që ndaj tij të ngrihet kurrë një aktakuzë më e rëndë se kjo. Tolstoi ishte ndoshta letrari më i admiruar i epokës së tij dhe sigurisht që nuk më pak i aftë edhe si pamfletist. Ai përdori të gjitha fuqitë e tij si akuzator ndaj Shekspirin, si të gjitha armët e një luftaniyeje që buçasin njëkohësisht. Dhe me çfarë rezultati? Dyzet vjet më vonë, Shekspiri është ende aty, krejtësisht i paprekur, dhe nga përpjekja për ta shkatërruar atë s’ka mbetur asgjë përveç faqeve të zverdhura të një pamfleti që vështirë se e ka lexuar kush dhe që do të harrohej fare nëse Tolstoi s’do të ishte autori i “Lufta dhe paqja” dhe “Ana Karenina”.

10 Akti IV, Skena 6.

11 Akti V, Skena 2. Të gjitha fragmentet e cituara nga “Mbreti Lir” janë sipas përkthimit të Skënder Luarasit. (Shënim i përkthyesit).

12 Henri IV, Akti 2, Skena 1.

Gjithë qytetërimet kanë pasur një dëshirë të etur të pasqyrojnë realen dhe kjo dëshirë gjerësisht është realizuar nga piktura, që prej prehistorisë deri në erën moderne. Lindja e fotografisë në agimin e shekullit XIX, pothuaj njëkohësisht në Francë dhe në Angli, bëri të mundur riprodhimin e botës reale përmes një procesi teknik.

Shpikja e fotografisë është ngjarja më e rëndësishme kulturore e shekullit XIX, e parë në ansamblin e vlerave etike, psikologjike dhe estetike që ajo prodhoi. Duke qenë kopje e saktë e reales, ajo krijoi një debat të gjatë dhe përmbysi me themel kodet e fushës së arteve.

Por fotografia nuk lindi nga rastësia në një epokë çfarëdo dhe në një truall të zbrazët, madje ajo nuk është vepër e një truri të vetëm. Në fillim të shekullit XIX, mjetet kryesore teknike ishin tashmë të njohura ; *dhoma e zezë* ishte prej kohësh instrument në duart e piktorëve, procesi i nxirjes së kripës së argjendit ishte aplikuar në shumë eksperimente dhe proceset kimike ishin në zhvillim.

Në verën e vitit 1827, Niepse (Nicéphore Niépce, 1765-1833) për herë të parë në historinë e njerëzimit fiksoi imazhet e projektuara në *“dhomën e errët*. Heliografia (*Shkrimi me diell*) kishte lindur, por ende vlerat e përdorimit të saj nuk ishin aplikuar. Ishte Dagerrri (Louis Jacques Mande Daguerre, 1787-1851), i cili arriti të kuptojë përmasat e shpikjes moderne. Me Dagerrin procedura teknike revolucionare emërtohet “dagerreotip” dhe emri i Niepses kalon në *hije*. Dagerreotipet u bënë *“imazhet e para”* të përfutuara pa dorën e artistit që i përgjigjeshin dëshirave dhe nevojave të shoqërisë moderne perëndimore, ku borgjezia financonte dhe kërkonte përfaësimin e reales.

Në pëdurimin akademik të fotografisë të vitit 1839, dijetari Fransua Aragoni (François Arago, 1786-1853) profetizoi shërbimet e mëdha që do të sillte në botë kjo shpikje e re me këtë përfaqësim besnik të reales. Në fakt, me imitimin dhe riprodhimin e reales, fotografia pushtoi me shpejtësi të gjitha vendet, duke filluar nga ata më të industrializuarat. Më 1859, fotografia më në fund u ekspozua në *Sallonin Vjetor të Pikturës dhe Skulpturës*, duke u bërë kështu e barabartë me artet e bukura.

Dagerrri u paraqit si një figurë e mirëseardhur, që po i sillte gjithë njerëzimit lajmin e mirë që aspirohej. Ishte pikërisht kritiku Filip Barti (Philippe Burty) që do të shkruante “[...] nëse mitologjia do të mbretëronte ende, *do të kishim hyjnizuar këtë Promete që grabiti dritën e diellit dhe e bëri të punojë si një skllave e nënshtruar*”.¹

Kush ishte, në fakt, Dagerrri ? A ishte ai që përshpejtoi rënien e Njeriut në narcisizëm apo ai që u dha njerëzve zotërimin e dritës hyjnore, duke u hapur rrugën drejt një progresi. Vetë Dagerrri do të entuziasmohej deri në ekstazë në përjetimin e shpikjes së fotografisë: *“Unë arrita të kapja dritën në ikje dhe e kam burgosur. [...] Unë e kam detyruar diellin të pikturojë imazhet për mua »*.²

Thirrja e Dagerrit nuk ishte adhurim, por një thirrje fitoreje që transformonte rendin e natyrës për të fituar mbi një fuqi mbinjerëzore. Ai ishte përballur me diellin si një forcë natyrore, në një dyluftim, ku në lojë ishte zotërimi i kësaj energjie të dritës. Dhe ai kishte fituar. Ai kishte detyruar jo vetëm diellin të pikturonte imazhet e tij, por ai kishte arritur të ndalonte gjithashtu degradimin e vazhdueshëm të imazheve nga drita diellore.

Nëse Dagerrri ishte një Promete i ri, atëherë fotografia regjistron në një histori teknike që grekët e vjetër e kishin filluar me *grabitjen e zjarrit*. Kjo histori është mëse e njohur dhe nuk pushoi së rishkruari qysh më 3 korrik 1839, ditën kur Aragoni bekoj në dhomën e deputetëve lindjen e fotografisë. Në këtë histori fotografia ishte një proces që i lejonte çdo njeriu të përmbushte detyrat shkencore dhe artistike, duke u ngritur në nivelin e një pune me përmasa titanike për epokën, ku as syri dhe as ndërgjegjja e njeriut nuk e kishin parë asnjëherë më parë.

Lindja e fotografisë ishte si simptoma e një *reformë të re*, por më e zbatueshme se ajo e Luterit, sepse ajo kërkonte këtë herë jo heqjen dorë prej imazhit, por një imazh që lejonte, më në fund, komunikimin e lirë imediat mes njeriut dhe hyjnore.

Heliografia u mundësoi njerëzve shkrimin e diellit mbi pllakën e metalit, duke mos ia besuar këtë mision kastës së mediatorëve, por thjesht një makine. Pikërisht në automatizimin teknik fotografia afirmonte vokacionin e saj universal dhe për të cilin Dagerrri pohonte se nuk kërkonte asnjë njohje speciale. Kjo do të thoshte se çdo njeri mund të kishte një makinë të tillë që mund të transformohej nga ai vetë në *“mediator automatik”* i dritës së universit dhe pa pasur nevojë të një frymëzimi hyjnor.

Më në fund fotografia shënonte fitoren e saj në riprodhimin automatik të botës së tërë. Albumet e para dagerriane dëshmonin për këtë tjetërsim të botës në imazhe. *“Pasqyrat që kujtohen”* të Dagerrit do të mbushnin sallonet e portretistëve dhe secila fotografi do të ishte një akt i ri krijimi që së shpejti do të ndërtonte pak nga pak universin e saj të dukshëm. Artistë të fushave të ndryshme sulmuan

Lindja prometeiane e fotografisë në fokusin e Bodlerit

Nga Xhyher Cani PhD

këtë shpikje të re në rrafshin estetik, moral ose ontologjik. Njëzet vjet pas deklarimit zyrtar të shpikjes së dagerreotipit, Bodleri (Charles Baudelaire, 1821-1867), njëri nga poetët më të mëdhenj të letërsisë franceze, publikoi një kritikë të veçantë, ku ai i bën një proces të rreptë fotografisë, duke i mohuar asaj statusin e veprës së artit, si dhe duke u ngritur kundër *“adhuruesve të diellit”* dhe *“imazhit banal”*.

Në *Sallonin e Artit*, 1859, Bodleri hedh poshtë *shenjtërimin* e fotografisë, veçanërisht raportet e njeriut me imazhin. Sipas Bodlerit, fotografia prodhon pasoja negative, ajo është materialiste dhe e skajshme dhe përshpejton një rënie që Bodleri e lexonte në terma moralë, metafizikë dhe madje teologjikë. Në kontekstin e ardhjes së fotografisë, gjurmët e hyjnore janë fshirë dhe Bodleri shpall kredon e tij: *“Unë besoj që arti nuk mundet të jetë veç riprodhim saktë i natyrës [...] Një Zot hakmarrës ka përmbushur dëshirat e kësaj turme dhe Dagerrri ishte Mesia i tij. [...] Mbasi fotografia na jep gjithë garancitë e dëshirueshme të saktësisë (ata besojnë këtë, të çmendurit), se arti është fotografia [...] Duke u nisur nga ky çast, shoqëria degradon dhe hidhet si një Narcisist i vetëm për të adhuruar imazhin e vet banal mbi meta”*.³

Por nëse Bodleri shikonte te Dagerrri *Mesinë* e një Zoti hakmarrës, që këte dritë diellore ia besonte mbarë njerëzimit, atëherë fotografia regjistron në historinë e teologjisë. Mendimi i Bodlerit është thellësisht teologjik ; ardhja e fotografisë në histori ngjan me një ngjarje që u përket *besimit* dhe *adhurimit* dhe ekzaltton një kult imazhesh, ku *imazhi banal* zëvendëson *pikturën hyjnore*. Kështu fotografia, me shëmbëlltyrën e saj teknike, si dhe me vetadhurimin, privilegjon imitimin, në vend që t'i thërrasë imagjinatës, e shpallur si *mbretëresha e zgjedhjeve në Sallonin* e 1859-ës.

Në të vërtetë, fotografët e parë kanë qenë piktorë të konvertuar. Në Francë, duke u nisur nga viti 1854, Nadari (Felix Tournachon, 1820-1910) bëhet një portretist i famshëm. I gjithë Parisi radhitet në atelienë e tij, nuk mungojnë dhe figurat e artit botëror, si Rikard Vagneri, Zhorzh Sandi, Viktor Hugo, Balzaku, Nervali, Maneja apo Bodleri. Studioja e tij konsiderohej si *panteoni i artistëve dhe shkrimtarëve bashkëkohorë* dhe u bë vendtakimi i gjeniut Bodler me mjeshtrin e madh të portretit, i krijuesit me prodhuesin, vendi ku *Poezia* gjeti *Fotografinë*. Frekuencimi i rregullt në atelienë e Nadarit e bëri Bodlerin një njohës të mirë të proceseve teknike të fotografisë. Por *“poezia dhe progresi janë dy ambicie që urrehen instinktivisht dhe, kur ato takohen në të njëjtën rrugë, duhet që njëra nga të dyja t'i shërbejë tjetrës”*.⁴

Në këtë kontekst, një marrëdhënie e veçantë prej vëllezërish kundërshtarë krijohet në mes Nadarit dhe Bodlerit, në qasjet e tyre për botën artistike dhe shoqërinë. Interpret dhe protagonist i *erës së imazheve*, Bodleri ka afirmuar gjatë gjithë veprës së tij pasionin e tij unik të glorifikimit të kultit të imazheve. Në këtë adhurim të tij, nocioni i portretit ka luajtur një rol themelor dhe ka provuar homogjenitetin e reflektimit estetik dhe praktikës poetike.

Por, megjithë rezervat e shprehura në *Sallonin e 1859-ës*, marrëdhënia e Bodlerit me fotografinë mbetet e diskutueshme. Kështu, fotografitë e realizuara nga Nadari, me portretin e Bodlerit, dëshmojnë për interesin e tij për këtë gjini artistike, edhe pse Bodleri ngjante gjithmonë i rebeluar përballë objektivit. Marrëdhënia e Bodlerit me fotografinë mbetet e dykrahshme, dhe kjo shfaqet qartë në letrën intime që i dërgon nënës së tij nga Brukseli, në dhjetor të vitit 1865:

“Do të doja të kisha portretin tënd. Është një ide që më pushton. Ka një fotograf të shkëlqyer në Havër. Por unë kam frikë që kjo nuk mund të jetë e mundur tani [...] dhe gjithë fotografët, madje të shkëlqyerit, janë me mani qesharake, ata marrin për një imazh të mirë [...] gjithë të metat dhe banalitetet e ftyrës”.⁵

Bodleri formulon kështu estetikën e tij fotografike. Ai



njihte të metat e zakonshme të portreteve. Ai ëndërron për një fotografi të ëmbël të nënës së tij, që largohet nga realizmi i papërpunuar ose kopja e skulpturuar. Sigurisht estetika bodleriane futi në art një kërkesë të perceptimit të botës moderne; ai ngulmon që artisti duhet t'i shtojë vëzhgimit të tij imagjinatën, *mbretëreshën e zgjedhjeve*. *“Është imagjinata ajo që i mëson njeriut kuptimin moral të ngjyrave, të formës, të zërit dhe të aromës, nënvizonte Bodleri. Ajo ka krijuar qysh në fillimin e botës analogjinë dhe metaforën. Ajo prish çdo krijim dhe, me materialet e akumuluar dhe të instaluar, duke ndjekur rregullat në të cilat nuk mund të gjejmë origjinën veçse në thellësinë e shpirtit, ajo krijon një botë të re, ajo prodhon ndjesinë e së resë”*.⁶

Në sytë e poetit, shija eksklusive e së vërtetës është infiltruar në botën e artit nga një lëvizje e dyfishtë reciproke e publikut mbi artistin dhe e artistit mbi publikun, madje edhe para vitit 1839. Fotografia nuk bëri gjë tjetër, veçse shtoi keqkuptimin dhe konfuzionin pranë publikut; kuptojmë këtu *publikun e salloneve*, me të cilin besojmë gabim që është e mundur të asimilohen produktet e industrisë me artin, konfuzion që rritet që prej 1848-ës, me idetë e përhapura nga lëvizja realiste.

Bodleri nuk është vetëm *“poeti i modernitetit”*, por edhe lajmëtari i një reflektimi filozofik mbi artin dhe të bukurën që lejon zhvillimin e vlerave të larta të estetikës dhe që i ikën kurthit të *“vdekjes së artit”*.

Përtej kësaj *pretence* të rreptë, sigurisht radikale në vështrim të artit të epokës, Bodleri nuk ka shkruar më për fotografinë, me përjashtim të ndonjë aluzioni ironik për dagerreotipin, për t'u tallur me piktorët e patalentuar, dhe fragmentit të letrës dërguar nënës së tij, për të provuar se e njihte mirë mjedisin e fotografëve të cilët edhe pse të shkëlqyer, kanë maniera qesharake. Kritika e tij më e ashpër është interpretimi i gabuar që i bëjnë imitimit aristotelian, publiku dhe pjesa e artistëve të *dështuar*. Në këtë kontekst, ideja mbizotëruese bodleriane ishte se *nuk është çështje të imitosh natyrën, ashtu siç është ajo*.

Bodleri e konsideronte fotografinë të zhveshur nga elementet subjektive dhe imagjinare të nevojshme për një vepër arti. Në esenë e tij, Bodleri e klasifikoi fotografinë si *“thjesht gjurmë e realitetit”*.

Sipas Bodlerit, romantizmi nënkuptonte artin modern, ku pasqyrohej intimitja, shpirtërorja, ngjyrat dhe frymëzimi pa kufi, por ndarja e tij me figurat e mëdha të romantizmit lidhet me kultin e natyrës që nuk ishte objekt i shijeve estetike të tij.

Bodleri i mohon fotografisë çfarëdo mundësie letrare apo narrative. Kështu, shton ai, fotografia nuk është veçse një mrekulli e teknikës dhe nuk duhet ngatërruar me artin, por fotografia, ose më mirë progresi, nuk mund të jetë veçse në shërbim të artit. Ne mund ta konsiderojmë këtë kritikë si një akuzë të bërë në adresë të një makine që, megjithë përbuzjen, prodhon vepra të vërteta dhe ruan të dokumentuar gjithë

gjurmët e prodhimeve dhe performancës së shoqërisë. Në kapitullin II të *Sallonit 1859*-ës, Bodleri do të shkruante: “*Industria fotografike ishte streha e të gjithë piktorëve të munguar, shumë keq të përkushtuar ose shumë dembelë për të përfunduar studimet e tyre*”.⁷

Bodleri nuk kritikon fotografinë në vetvete, por progreset e saj të keqzbatuara. Fotografia duhet të mbetet shërbëtorja modeste e shkencave dhe e arteve, duke mos qenë as njëra dhe as tjetra, nënvizon ai. Për Bodlerin, fotografia nuk mundet të jetë veçse një ndihmëse e kujtesës, një udhëzues shënimesh pamore, një asistente në kërkimet shkencore. Fotografia mund të përdoret aty ku kërkohet një saktësi absolute materiale.

Në mbështetje të një arti liberal, subjekt i Bodlerit është një botë e artit me veçori krijuese, e çliruar nga mekanika. Dëshmitar i një epoke të industrializuar, Bodleri lidh krizën që vëren në artin e *Sallonit*, me zhvillimin e një arti të mekanizuar. Bodleri frikësohet nga angazhimi masiv për një industri dhe jo për art, karakteristika e të cilit është përgjigjja e kriterëve të së *bukurës*, e dallueshme nga kriteri i së *vërtetës*. Ai i atribuon të bukurën pikturës, shkrimit, skulpturës, si shprehje të ëndrrës së lumtur, ndërsa fotografinë e konsideronte ekskluzivisht natyraliste dhe jashtë shijeve të tij. Mendimi estetik i Bodlerit nënkupton qartësisht mungesën e harmonisë mes ekspansionit të industrisë dhe të artit krijues. Nocioni i *aparatis* bëhet problematik, statura e poetit lirik është thellësisht në opozitë me teknikën e industrisë.

Qysh prej lindjes së saj, raportet mes fotografisë dhe artit kanë qenë të vështira dhe komplekse. Në Francë, kjo ka vazhduar veçanërisht deri në pragun e shekullit XX, ku shumë shkrimtarë dhe artistë mobilizohen për të afirmuar varësinë e fotografisë nga arti. Interesi dhe njohja e fotografisë si art manifestohet vonë, vetëm në gjysmën e parë të shekullit XX, me ardhjen e surrealizmit. Veçanërisht pas viteve 70 të shekullit XX, fotografia bëhet objekt i teorizimeve dhe legjitimitetit filozofiko-estetik dhe do të ekspozohet në muzetë më të mëdha, duke integruar koleksione prestigjioze. Në këtë mënyrë, fotografia instalohet në trashëgimin e pasur të historisë së artit me të cilin formon një raport të ngushtë dhe krijues. Fotografia ka luajtur një rol domethënës në botën e artit, si kronikane vizuale e evoluimit dinamik të shoqërisë sonë dhe si frymëzuese dhe ushqyese e formave të të shprehurit artistik.

Përtej Atlantikut, në SHBA, nëpërmjet lidërshit të Alfred Stieglitzit, një shkollë e re artistike diferencohet nga ajo europiane, duke afishuar afërsinë e saj estetike me artin modern, e vërtetuar nga prania e veprave të piktorëve modernë në faqet e revistës *Camera Work* dhe mbi muret e galerisë njujorkeze. Në këtë frymë dadaizmi, surrealizmi, konstruktivizmi, futurizmi, vizioni i ri ndikon të shumëfishohen eksperimentet dhe takimet artistike, duke e konsideruar fotografinë si artin e kohës, e cila ka ligjet e veta që përbëjnë vlerat e vërteta me të cilat duhen gjykuar.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe veçanërisht pas viteve 1960 dhe 1970, Valter Benjamini analizoi në dy esetë e tij origjinale, historinë dhe teorinë e fotografisë që u bënë udhërrëfyese dhe objekt i një vëmendjeje të shtuar.

Teoricienët që do angazhohen më pas, si Rosalind Kraussi, Roland Barti, Suzan Sontagu, Denis Roshe, etj, do të zbatojnë me vendosmëri veçantitë e mediumit dhe imazhin fotografik, duke vënë në pah kontributin e historisë, antropologjisë, semiologjisë, psikanalizës, sociologjisë, poezisë, si dhe sensibilitetin personal. Krahas definicionit kuptimplotë “*kjo ka qenë*”, përruar nga Roland Barti, nocioni tregues i “*ikonës*” bëhet një pikë orientimi në përkufizimin e kontureve të fotografisë.

Shekulli XIX u karakterizua nga një vërshim i madh i imazhit në hapësirën ekspozuese, ku fotografia gjithnjë e më shumë është e pranishme si përfaqësuese e një mediumi që lind një gjuhë të re të trupit dhe bëhet një *poemë* lirike e progresit teknik.

Në fund të shekullit XIX, një hop teknik madhor përshpejton masivisht artin fotografik. Nëse deri atëherë arti fotografik ishte i pranishëm vetëm në atelietë e piktorëve, sallat e ekspozitave dhe albumeve të pasura të udhëtimeve, duke nisur nga viti 1888 vihet në dispozicion të publikut të gjerë në sajë të *Kodakut*. Përhapja e imazheve fotografike infiltrohet në gjithë kategoritë shoqërore. Ishte Nadari vetë që paraqiti shpikjen më 7 dhjetor 1888, në *Shoqatën Franceze të Fotografëve*. Përhapja e imazheve fotografikë u lehtësua nga zëvendësimi i pllakave të xhamit me *pelikulat*, si dhe nga shumëfishimi i shkrepjeve fotografike. Përballja e vjetër mes artit dhe fotografisë zvogëlohet akoma më shumë në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur arti konceptual dhe performanca e fotografisë zënë një vend të planit të parë.

Në këtë mënyrë, një *makinë* u bë e aftë të ndalonte kohën në një çast. Ky proces i magjishëm teknik modifikoi thellësisht kohën dhe historinë e gjithësecilit. Në këtë udhëtim historik të fotografisë u pasqyrua diversiteti dhe



Sharl Bodleri, fotografuar nga Feliks Turnashon Nadari

pasuria e vlerave ideore, estetike, emocionale të botës sonë, përmes objektivit të mjeshtërve të mëdhenj, të cilët realizuan vizione unike me shprehësi artistike. Fotografia tashmë ishte kthyer në një art brenda artit.

Referenca

- Philippe Burty, *Exposition de la Société française de photographie*, në *Gazette des Beaux-arts*, vol. 2, mai 1859, faqe 221.
- Charles Chevalier, *Guide du photographe*, Paris, 1854, cituar në Helmut et Alison Gernsheim, *L. M. J. Daguerre. The History of the Diorama and the Daguerreotype* [1956], New York, Dover, 1968, faqe 49.
- Charles Baudelaire, *Le public moderne et la photographie*, në *Salon de 1859, Oeuvres complètes*, éd. Claude Pichois, Paris, Gallimard, 1962, t. II, faqe 616-617.
- Charles Baudelaire, idem.
- Charles Baudelaires, idem. (C, II, 554).
- Charles Baudelaires, *La reine des facultés, Chap. 3 du Salon de 1859*
- Charles Baudelaires, *Le salon....C II*.

Bibliografi e konsultuar

BENJAMIN, Walter. *Petite Histoire de la Photographie*, 1931, në *L'œuvre d'art à l'époque de sa reproductibilité technique*, 1^{ère} version 1935, 2^e version 1936, in *Oeuvres*, Tome II et III, Paris, Gallimard, Folio, 2003.


BENJAMIN, Walter. *Charles Baudelaire, un poète lyrique à l'apogée du capitalisme*, trad. de l'allemand par J. Lacoste, Paris, Payot, 2002.

BOURDIEU, Pierre. *Un art moyen*, Paris, Minuit, 1965.

FRIZOT, MICHEL. *Nouvelle Histoire de la photographie*, Paris, Bordas/A. Biro, 1995.

KRAUSS, ROSALIND. *Stieglitz : Équivalents, Le Photographique. Pour une théorie des écarts*, Paris, Macula, 1990.

ROUILLE, ANDRE. *La Photographie en France. Textes et controverses : une anthologie (1816-1871)*, Paris, Macula, 1989.



ARISTOTELI

Etika nikomakeane

Minerva